

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

VARFËRI DHE ZUHD

Ihjaul Ulumid-din
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i origjinalit:
KITABU'L-FAKR VE'Z-ZUHD
LIBRI 34

Përgatiti dhe përktheu:
Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Lektor:
Shenaj Zeneli

Prishtinë, 2020

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Hamd (Falënderimi) i takon vetëm Allahut. Ai Allah, që gjithçka, edhe kokrrat e grurit e madhërojnë, dhe që gjithçka, edhe hijet i bëjnë sexhde, e malet rrafshohen dhe shtrihen për tokë nga madhështia e Tij; Atë e falënderoj. Ai Allah, që e krijoi njeriun prej baltës së terur¹, e më pas ia dha formën më të bukur, e kompletoi. Me dritën e udhëzimit, Ai e mbrojti zemrën e tij nga besimet e kota. I lejoj të trokasë në derën e hizmetit mëngjes dhe mbrëmje, dhe ia dhuroi mundësitë e ibadetit. Më pas, robit të singertë i shtoi dritë (nur) në syrin e zemrës (basiret), e në saje të kësaj robi është i mbrojtur nga shirku në ibadetin e tij; nga ndriçimi i këtij nuri ai nuk mendon dhe nuk sheh asgjë tjetër përveç madhështisë së Allahut. Nga ky nur, robit në vetvete iu shfaq një bukuri dhe përsosmëri e tillë sa gjithçka që kishte parë para kësaj i erdhi e shëmtuar. Gjithçka që e largonte nga shikimi i vazhdueshëm i kësaj përsosurie ishte e rëndë për të. Iu shfaq edhe dynjaja, në formën e një gruaje të bukur, që ecë me mburrje e krenari.

¹ shih ajetin 26, 28, 33, sure 15 (Hixhr) dhe ajeti 14, sure 55 (Rahman), shih ajetin 11, sure 37 (Safat).

Iu shfaq edhe e brendshmja e saj, një plakë e shëmtuar, me fytyrë të rrudhur e pa dhëmbë, brumë i gatuar me baltën e poshtërsisë, e krijuar për ndëshkim, e mbuluar për të fshehur fëlliqësitë e mashtrimit dhe dinakërisë. Me të gjitha forcat i shpërndau litarët e saj nëpër rrugët kah njerëzit lëvizin, e bën gjah në ta me hile e mashtrim. Nuk mjaftohet vetëm me mashtrim por ua prenë rrugën, i lidhë me zinxhirë e i hedhë në pranga. I mundon duke i futur në telashe e probleme. Prandaj kur arifëve ju zbulohen (keshf) shëmtitë e fshehta e të dukshme të dynjasë, ata bëhen zahidë, i marrin mëri dynjallëkut dhe duke e mallkuar largohen prej saj, braktisin lavdërimin për bollëkun në pasuri dhe fëmijë dhe i drejtohen Allahut me tërë fuqinë dhe qeniet e tyre.

Salat e selam mbi sejjidin tonë, Muhammedin, s.a.v.s., sejjid i të gjithë peygamberëve, a.s., si edhe ehli-bejtit, dhe as'habëve të tij.

Pas kësaj dije se, dynjallëku është armik i Allahut Teala. Armik që, me mashtrimet e veta i devijoi nga rruga e drejtë të devijuarit, me kurthe i pengoi ata të ngatërruarit. Dashuria ndaj kësaj bote është burim i të gjitha gjynaheve dhe të këqijave, ndërsa urrejtja ndaj dynjallëkut është themel i nënshtimit dhe i veprave me të cilat robi i afrohet Allahut Teala.

Lidhur me përshkrimin e dynjasë dhe qortimin e dashurisë ndaj kësaj bote, kemi thënë mjaft në *Librin për përbuzjen e dynjasë* (Kitabu Zemmi'd-Dunja), në vëllimin Muhlikat, për gjërat që shkatërrojnë. Këtu do të flasim për faziletin e përbuzjes së kësaj bote dhe për braktisjen e kësaj bote me zemër (*zuhd*), meqenëse ky është themel i shpëtimit. Shpëtimi arrihet vetëm përmes këputjes së të gjitha lidhjeve me këtë botë dhe me largim prej saj. E ndërprerja e këtyre lidhjeve arrihet me largimin e dynjallëkut nga robi, që quhet *varfëri* (*fakr*), dhe me largimin e robit nga dynjallëku, që quhet *zuhd*. Edhe fakiri edhe zahidi i kanë gradat e veta në arritjen e lumturisë.

Ne tash do të flasim për hakikatin e varfërisë dhe zuhdit, gradat e tyre, llojet, kushtet dhe rregullat e tyre. Për varfërinë do të flasim në pjesën e parë të kësaj libre, e për zuhdin në pjesën e dytë. Fillojmë pra, me *fakr*.

Kapitulli i parë

PËR VARFËRINË

Do të shpjegojmë realitetin e varfërisë (*fakr*) dhe vlerat e gjendjes së fukarasë (*fakir*). Do të shpjegojmë faziletin e veçantë të fukarasë, vlerën e të varfërit në krahasim me të pasurin, edebin e varfërisë, mënyrat e sjelljes ndaj dhuratave që pranohen. Më pas do të shpjegojmë ndalesën e lypjes, përpos kur është i detyruar, do të përshkruajmë të pasurin nga i cili është e ndaluar të kërkohet, e më pas do të shpjegojmë edhe gjendjet shpirtërore të atyre që kërkojnë diçka. Allahu Teala udhëzon drejt të Vërtetës, me mirësinë dhe fisnikërinë e Tij.

HAKIKATI I VARFËRISË DHE GJENDJET E TË VARFËRIT

Dije se, varfëri është mungesa e diçkaje për të cilën ka nevojë. Mungesa e asaj për të cilën nuk ka nevojë, nuk quhet *varfëri*. Nëse ajo për çfarë ka nevojë, është diçka që ekziston e që mund të merret, atëherë ai që ka nevojë për këtë nuk është *fukara*.

Nëse e kupton këtë, nuk do të dyshosh se të gjitha krijesat janë të varfra, sepse çdo krijesë ka nevojë të vazhdueshme për ekzistencën e vet, e kjo ekzistencë, në vazhdimësi, përfitohet vetëm nga mirësia e Allahut Teala.

Nëse ka qenie e cila për të ekzistuar vet nuk ka nevojë për diçka tjetër, ajo ekzistencë quhet Absolutisht i Vetmjaftueshmi (*ganijjul-mutlak*). E ekzistencë e tillë është Një. Gjithçka tjetër përveç Tij, për të ekzistuar, ka nevojë për Atë. E se Ai nuk ka nevojë për asgjë, jep shenjë edhe ajeti:

“Allahu është i pasur (s’ka nevojë për asgjë), ndërsa ju jeni të varfër (jeni nevojtarë për gjithçka).”

47-Muhammed: 38

Varfëria që e përshkruam është varfëria absolute. E qëllimi ynë këtu nuk është të tregojmë për varfërinë absolute, por të shpjegojmë nevojën për pasuri. Përndryshe, nëse marrim parasysh nevojat e ndryshme të njerëzve, ato nuk mbarojnë kurrë. Prandaj themi: nëse dikush ka nevojë për ndonjë pasuri që nuk e posedon, ai quhet *i varfër* në raport me atë pasuri, dhe në këtë varfëri mund të mendohet për pesë gjendje të këtij personi. Le t'i ndajmë këto pesë gjendje nga njëra-tjetra për ta paraqitur rëndësinë e secilës, veç e veç:

Gjendja e parë

e varfërisë së personit shihet në atë se, nëse i jepet pasuri, ai do të ndjente përbuzje dhe shqetësim, prandaj ikë, duke u frikësuar nga e keqja të cilën pasuria e sjellë me vete dhe nga angazhimi i vet me atë pasuri. Kjo është gjendja më e lartë dhe quhet *zuhd*, e personi në atë gjendje quhet *zahid*.

Gjendja e dytë

është kur personi nuk dëshiron pasuri, e kur i arrin pasuria, as nuk gëzohet e as nuk e përbuzë, e kjo është '*riza*' (kënaqësi) dhe pronari quhet '*razi*' (i kënaqur).

Gjendja e tretë

është kur personit, posedimi i pasurisë i është më e dashur se skamja, sepse pasuria e tërheqë, por nuk është tëreqje aq e fortë sa ta detyrojë ta kërkojë pasuri. Por nëse i dhurohet hallall, do ta pranojë e do të gëzohet. Personi në këtë gjendje quhet '*kani*' (i mjaftuar), sepse është i kënaqur me atë që ka, ani pse ndjen një dëshirë të dobët për pasuri, por nuk ngarend pas saj.

Gjendja e katërt

është kur nuk kërkon pasuri, por kjo për arsye se nuk ka mundësi. Përndryshe, pasuria e tërheq, dhe po të jetë në gjendje të lëshohej pas saj, edhe po t'i ishte kjo mundim, do të nisej, e do të preokupohej me kërkimin e pasurisë. Personi në këtë gjendje quhet *haris* (i pangopur).

Gjendja e pestë

është kur personi ndjenë nevojë për një pasuri që nuk e ka, siç është nevoja të cilën i urituri ndjenë për ushqim, ose ai që është lakuriq për rroba. Personi në këtë gjendje quhet *muztar* (i detyruar). Prirja e tij për kërkim të pasurisë herë është më e fortë e herë më e dobët, por rrallë që privohet nga ajo.

Këto janë pesë gjendjet e të varfërit, e më e larta është *zuhd* (të braktisurit e kësaj bote me zemër). E kur zahidi shprehë varfëri edhe në sende si ushqimi e veshmbathja, atëherë kjo gjendje bëhet grada më e lartë e zuhdit, siç do ta sqarojmë më vonë, inshallah.

Përpos këtyre pesë, ekziston edhe një gjendje; kur për personin është plotësisht e njëjtë, posedoi pasuri apo jo. Nëse fiton pasuri, kjo nuk e gëzon, por as nuk e shqetëson, e edhe nëse e humbet pasurinë, ndihet njëjtë.

Gjendja e tij është si gjendja e Ajshe r.anha, kur iu dhuruan njëqind mijë derhemë; i mori, dhe të njëjtën ditë i shpërndau të gjitha. Shërbëtorja i tha:

- *Të na kishe blerë mish, bile për një derhem nga këto që i ndave, e të kemi sonte për iftar*; e Ajshe r.anha, tha:

- *Po të më thojë, do ta bleja.*

Personin që është në këtë gjendje nuk e mundon pasuria; edhe sikur e gjithë dynjaja me gjerësinë e saj të ishte në pronësinë e tij – kjo nuk ka ndonjë vlerë në sytë e tij, sepse ai e sheh këtë pasuri si pronë të Allahut, jo të tij. Ai nuk bën dallim se a është pasuria në duart e tij apo të tjetrit. Personin në këtë gjendje është më e drejtë ta quajmë *mustagni* (i ngopur), sepse për të është njëjtë se a është i pasur apo i varfër.

Që ta kuptojmë këtë emërtim (*mustagni*), do të tregojmë dallimin në mes të emërtimit *Ganijjul-mutlak*² për Allahun Teala, dhe emërtimit të njëjtë për robin që ka pasuri të bollshme e që nuk ka nevojë për askënd. Robi që ka pasuri bollshme dhe lehtësohet me të, është i varfër në kuptimin që ka nevojë për ta mbajtur atë pasuri. Pasuria e tij është në kuptim të posedimit të asaj pasurie në pronësi të vet, e jo në vazhdimësinë e asaj pasurie. Prandaj ai është *i varfër*, ani pse ka pasuri. Por, personi që ne e quajmë '*mustagni*', ai - edhe kur e mbanë pasurinë në dorë edhe kur i dal nga dora, është krejt njëjtë për të. Ai nuk ka nevojë për askë, ai është i pasur. Atë nuk e shqetëson skamja e të ketë nevojë për pasuri, por nuk e shqetëson as humbja e pasurisë, që të ndjejë nevojë ta mbajë.

² i Pasuri. Ai i Cili nuk ka nevojë për asgjë në Qenien e Tij, as në cilësitë e Tij e as në veprimet e Tij.

Këto janë cilësi të atyre që janë afër Allahut sepse afërsia e njeriut me Allahun nuk është në hapësirë, e as kohë, por është afërsi me cilësi. Edhe ky person tregon në gjithçka që është *gani* (i pasur) - nuk ka nevojë për asgjë, mirëpo ne nuk i themi pronarit të kësaj gjendje *gani*, por i themi *mustagni*, e *Gani* mbetet vetëm si emërtim për *Ganijj-Mutlak* – (Absolut i Pasur, i Pavarur), për Allahun Teala. E robi për të cilin po flasim është i pavarur nga pasuria, e posedoi apo jo, por nuk është i pavarur edhe nga të tjerat pos pasurisë; nuk është i pavarur nga udhëzimi i vazhdueshëm i Allahut, me të cilin Ai ia zbukuron zemrën. Zemra i është e lidhur me një fije të hollë për dashurinë ndaj pasurisë, por ai që synon të jetë i pavarur, çlirohet nga kjo. Allahu Teala është Ai që e ka lidhur për robëri, prandaj robi është në nevojë të vazhdueshme që Allahu edhe ta çlirojë nga kjo. Zemra ngurron në mes të robërisë dhe lirisë, sepse zemra rrotullohet në mes të dy gishtave të fuqisë së Rahmanit. Prandaj, edhe pse ky person e ka arritë këtë gjendje, ai nuk quhet *gani* (absolut i pasur, i pavarur), përpos si metaforë.

Dije, *zuhd* është një gradë e përkryer e të singertëve (*ebrar*), por për poseduesit e gjendjes që e përshkruam, të cilëve ju thuhet '*mukarreb*' (të afërt), për ta zuhdi është mangësi.

Është thënë se veprat e mira të të singjertëve (*ebrar*) mund të jenë vepra të këqija për mukarrebunët. Sepse, ai që përbuzë këtë dynja, megjithatë është i angazhuar në të, njëjtë si është i angazhuar ai që e pëlqen dynjallëkun. Angazhimi me çfarëdo tjetër përveç Allahut është një perde mes teje dhe Allahut, sepse mes teje dhe Atij nuk ka largësi (*bu'd*). Largesia (distanca), është vetëm perde, sepse Allahu Teala nuk ndodhet në ndonjë vend fizik (*mekan*). **Allahu Teala është më afër teje se damari në qafën tënde** (50-Kaf: 16).

Angazhimi yt edhe me veten tënde dhe me epshin tënd është angazhim me diçka tjetër pos Tij. Prandaj, një person i angazhuar me dashurinë e nefsit, ai nuk angazhohet me Allahun Teala. Por, edhe angazhimi me përbuzjen e nefsit gjithashtu paraqet mos-angazhim me Allahun. Gjithçka përpos Allahut Teala është sikur një vëzhgues të jetë prezent në takimin e të dashuruarit (*ashik*) me të dashurën (*ma'shuk*), dhe ashiku për një çast e kthen fytyrën kah vëzhguesi, ndjen përbuzje ndaj tij dhe i vjen keq që ai është prezent, por kjo nënkupton që zemrën e ka vetëm pjesërisht të angazhuar me të dashurën e tij, prandaj u largua nga kënaqësia e shikimit të fytyrës së dashur.

Po të ishte ashiku vërtetë i thelluar në dashuri (*ashk*), do të ishte i pavëmendshëm ndaj gjithçka tjetër përpos të dashurës e nuk do të brengosej për asgjë tjetër.

Ashtu si shikimi me simpati në dikë tjetër pos të dashurës, e në prani të saj, që paraqet një lloj shirku në ashk (*shirk fil-ashk*) dhe mangësi në dashuri, edhe shikimi me përbuzje në dikë tjetër në prani të personit të dashur paraqet shirk në ashk dhe mangësi në të. Megjithatë, njëra ka më pak mangësi se tjetra. Përsosuria është në moskthimin e kokës kah asgjë dhe askush përpos të dashurit, as nga urrejtja, as nga dashuria për tjetrin. Siç nuk mund të jenë në zemër dy dashuri në të njëjtën kohë, ashtu nuk mund të jenë bashkë as përbuzja dhe dashuria.

Ai që angazhohet në përbuzje ndaj dynjallëkut është i pavëmendshëm (*gafil*) ndaj Allahut Teala njëjtë sikur ai që preokupohet me dashurinë ndaj dynjasë, me atë që ky i dyti është i pavëmendshëm, por me pavëmendje ka bërë edhe hapin në rrugën e largimit nga Allahu Teala. Ky i pari, është i pavëmendshëm, por ecë në rrugën e afrimit me Allahun Teala, sepse është shpresa që ajo pavëmendje t'i ndërrohet me *mushahede* dhe të arrijë përkryrje. Përbuzja ndaj kësaj bote është mjet për të arritur Allahut Teala.

Kështu, ai që e do këtë botë dhe ai që e përbuzë, janë sikur dy persona që takohen në një konak gjatë rrugës së haxhit dhe që janë të angazhuar me devetë e tyre. Por njëri drejtohet kah Qabeja, e tjetri në drejtim të kundërt, e Qabeja është e fshehur nga që të dytë, sepse që të dy janë të angazhuar me diçka tjetër përveç Qabes.

Por, gjendja e atij që lëvizë në drejtim të Qabesë është më e mirë se gjendja e atij që lëvizë në drejtim të kundërt, sepse ky që lëvizë në drejtim të Qabesë mund edhe të arrijë atje. Megjithëkëtë, gjendja e tij nuk është e lavdëruar krahasuar me personin që tashmë gjendet në Qabe, sepse ai që as nuk është larguar nga Qabeja nuk ka nevojë për deve dhe kujdesin ndaj saj për të arritur në Qabe.

Kështu duhet ta kuptosh që përbuzja e dynjallëkut është vërtetë e domosdoshme, bile ta kuptosh që kjo botë është pengesë në rrugën drejt Allahut Teala, dhe që te Allahu nuk mund të arrihet, pos me largim të kësaj pengese. Prandaj Sulejman Darani ka thënë: *“Ai që braktis dynjallëkun dhe me këtë është i kënaqur, ai ka nxituar të arrijë rehatinë.”*

Detyrë e atij që braktis dynjallëkun është që menjëherë të drejtohet në ahiret dhe të punojë për atje. Domethënë, hyrja në rrugën e ahiretit vjen pas gjendjes së zehrit. Edhe hyrja në rrugën e haxhit vjen vetëm pasi të hiqni gjërat që mund ta pengojnë këtë rrugë. Përfundimi nga shpjegimet që i bëmë deri më tani mund të përmbledhet kështu: nëse me zehd qëllimi është mosdashja e dynjallëkut, pa marrë parasysh a posedon diçka prej saj a jo, kjo është gradë e mukarrebunëve, dhe është në maja të përkryerjes.

Kjo gjendje është përkryerje në krahasim me gjendjen *riza*, *kani* dhe *haris*, por është e mangët në krahasim me gjendjen *mustagni* që e përshkruam më lartë. Përkryerja e vërtetë është kur pasuria dhe uji të janë të njëjta; sasia e madhe e ujit afër teje nuk të pengon nëse je në breg të detit, e as që të brengosë sasia e vogël, përpos në nevojë të domosdoshme, me atë që nevoja për pasuri ekziston, siç ekziston edhe nevoja për ujë, prandaj mos e preokupo zemrën as me ikje nga uji, as me përbuzje të sasisë së madhe të tij, por thuaj vetes: *do të pi ujë aq sa më duhet, tepricën do t'ia jap nevojtarëve.*

Pra, edhe pasuria duhet të jetë e njëjtë si uji. Sepse buka dhe uji janë të njëjtë për nga nevoja. Ndryshimi është se njëra është e bollshme e tjetra e pakët. E kur të njohësh Allahun Teala dhe fuqishëm i përmbahesh rregullit të Tij, të Cilit i është nënshtruar gjithçka, do ta kuptosh se të ti do të vijë aq ushqim sa të është i nevojshëm, sa të jesh gjallë, dhe që do të vijë tek ti aq ujë sa të është i nevojshëm, për çka, inshallah, do të flasim në *Librin për tevekkul*.

Ahmed ibn Hivari i ka treguar Sylejman Daranit se Malik ibn Dinar i tha Mugires:

- *Shko në shtëpi e merre ibrikun që ma dhurove; sepse shejtani po më pëshpëritë që e kanë vjedhur; e Ebu Sulejmani i tha:*

- Kjo vjen nga dobësia e zemrës së sufisë. Ai brengoset për dynjallëkun që e posedon. Përbuzja e posedimit të ibrikut e ka bërë të angazhohet me të. Po të ishte në gradën e përkryrjes, për të nuk do të kishte rëndësi a është ibriku në shtëpi apo jo, a e kanë vjedhë a jo.

Eshtë e mundur që ti të pyesësh: *përse pejgamberët dhe evliatë iknin prej pasurisë, bile e kanë përbuzë?*; e unë do të përgjigjem: Ikja e tyre nga pasuria është si ikja nga uji, në kuptimin që ata nuk pinin më shumë se sa që kishin nevojë dhe nuk mbanin më shumë ujë në enët e tyre. Ata edhe nga pasuria morën vetëm aq sa kishin nevojë dhe e braktisën tepricën. Ata zemrat i kishin të angazhuara me dashuri. Në kthimin nga Bahrejni, Resulallahut s.a.v.s, pastaj Ebu Bekrit r.a., dhe më pas Omerit r.a., ju paraqitën thesaret e dynjasë. Ata i pranuan dhe i vendosën ku e kanë vendin, por nuk ikën prej tyre. Sepse për ta ishte njëjtë pasuria apo uji, ari apo guri.

Transmetimet për njerëzit që frikësoheshin se pasuria i mashtron e i lidhin zemrat për të, që do t'i shtyente në pasim të dëshirave, kjo është gjendja e personave të dobët, prandaj ikja nga pasuria për njerëzit e tillë është një përkryerje dhe kjo vlen për shumicën e njerëzve. Sepse shumica e njerëzve janë të dobët, përveç pejgamberëve dhe evliave.

Ata që arritën gradën e përkryerjes zbritën në grada më të ulta për t'u bërë shembull për të tjerët që nuk mundën të ngriten aq lartë, sepse njerëzit e zakonshëm i marrin si shembull të përkryerit, dhe nëse i shohin ata të ikin nga pasuria, edhe të tjerët do të përpiqeshin të ikin, e do të rrezikoheshin. Kjo është sikur gjahtari i gjarprit që, kur është bashkë me fëmijët, ikë nga gjarpri. Kjo ikje nuk është pse ai frikësohet, por sepse fëmijët, të cilët e shohin atë duke kapur gjarprin, mund të mendojnë: *“edhe ne mund ta kapim gjarpin!”*, e të rrezikohen, sepse fëmijët tentojnë të imitojnë, prandaj ai zbrit në nivelin e tyre për t'i mbrojtur ata nga helmimi i gjarprit. Zbritja në nivelin e më të dobët është domosdoshmëri e pejgamberëve, evliave dhe dijetarëve.

Pra, ka pesë grada në këtë çështje. Grada më e lartë është *“i pavaruri”* (*mustagni*), më pas gjendja e zahidit, pastaj të kënaqurit (*riza*), mjaftueshmëria (*kana'at'*) dhe pangopësia (*haris*). Sa i përket atij që ka nevojë urgjente, edhe ai ndonjëherë mund të paramendohet në gjendje të zuhdit, kënaqësisë dhe mjaftueshmërisë. Edhe grada e kësaj ndryshon sipas ndryshimit të gjendjeve. Këtyre pesë personave ju thuhet *fakir* (i varfër). Por, kur bëhet fjalë për *mustagni* (të pavarurin), ai quhet i varfër në kuptimin se ai është i varur nga rahmeti i Allahut në gjithçka.

Emërtimi ‘i varfër’ për këtë person është sikur t'i jepet emri 'al-*abd*' (rob) personit që e njeh veten si rob dhe deklaron se është rob. Sepse më mirë është ta quash 'al-*abd*' një person të tillë sesa këtë emërtim t'ia japësh atyre që janë të pavëmendshëm (*gafil*). Pra, shprehja *fakr* është shumëkuptimëshe, dhe përfshin dy kuptimet e përmendura.

Nëse e ke të qartë shumëkuptimin e kësaj shprehje, atëherë do ta dish se fjalët e Resulallahut, s.a.v.s.:

“Strehohem tek Ti nga varfëria”³

dhe:

“Varfëria, gati u bë pabesim (*kufr*)”⁴,

edhe nuk janë të kundërta me hadithin ku thuhet:

“Më bëj të jetoj si fukara dhe më vdis si fukara.”⁵

Po e kupton se nuk ka asnjë kontradiktë mes haditheve. Sepse strehimi i tij tek Allahu është varfëria e atyre që janë në vështirësi. E ka bërë të qartë në dua që ai e pranon se është i varfër, i vetëdijshëm për pavlerën e vet dhe që Allahu Teala i nevojitet secilit rob në dynja.

³ Hadithi është përmendur në *Librin për dhikrin dhe duatë*.

⁴ Hadithi është përmendur në kapitullin për qortimin e varësisë.

⁵ Tirmidhi, nga Enesi r.a., që e quan *hasen*, dhe Ibn Maxhe dhe Hakim, që e quan sahih, nga Ebu Seid. Është përmendur më herët.

FAZILETI I VARFËRISË

Ajetet në këtë temë

“(Ajo pasuri) U takon muhaxhirëve të varfër, të cilët u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe prej pasurisë së tyre...”

59-Hashr: 8

“(Jepni) për të varfërit që janë të angazhuar në rrugën e Allahut dhe nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar).” 2-Bekare: 273

Fillimisht shprehet lavdërimi, e më pas ata quhen të varfër, dhe kjo përmes përshkrimit të emigrimit (hixhret) të tyre dhe angazhimit. Kjo shprehë qartë faziletin e varfërisë.

Hadithet në këtë temë

Hadithe që i referohen faziletit të varfërisë ka më shumë se që mund të përmenden. Abdullah ibn Omer tregon se Resulallahu, s.a.v.s., i pyeti as’habët e vet:

- ***Cili nga njerëzit është më i mirë?***, e ata u përgjigjën:
- ***Ai që fiton pasuri, e më pas i respekton obligimet që i ka për vete, dhe obligimet ndaj Allahut Teala.***
- ***Ky është njeri i mirë, por nuk është më i miri.***

- *O i dërguari i Allahut! Pra, kush është më i miri i njerësve?*; pyetën as’habët, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- ***Fakiri (i varfri) që jep në rrugë të Allahut nga ajo që fiton me mundim.***⁶

Resulallahu, s.a.v.s., i tha Bilallit, r.a.:

“Takoje Allahun si fukara, jo si pasanik.”⁷

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Allahu e do fukaranë e ndershëm, që ka familje të madhe.”⁸

Në një transmetim të njohur thuhet:

“Fukaratë e ummetit tim do të hynë në xhennet pesqind vite para pasanikëve të ummetit tim”⁹,

e në një version tjetër të këtij hadithi:

“...katërdhjetë dimra”¹⁰,

do të thotë, katërdhjetë vite, e mendohet në përparësinë e fukarasë lakmitar ndaj pasanikut lakmitar.

⁶ Ebu Mensur Dejlemi në ‘Musned-i Firdevs’ në formë të shkurtuar si hadith *merfu*.

⁷ Hakimi nga Bilalli, r.a., Taberani nga Ebu Seid.

⁸ Ibn Maxhe nga Imran ibn Husajn.

⁹ Tirmidhi nga Ebu Hurejre.

¹⁰ Muslimi nga Abdullah ibn Amr. Hadithin e shënon edhe Tirmidhi nga Xhabiri dhe Enesi r.a..

Domethënë, një i varfër lakmitar do të hyjë në xhenet katërdhjetë vite para të pasurit lakmitar. E në hadithin e parë qëllimi është të përparësia e fukarasë zahid ndaj pasanikut që e do pasurinë. Fukaraja zahid do të hyjë në xhenet pesqind vite para të pasurit që e do pasurinë.

Këto që i thamë ta mundësojnë ty që ta kuptosh dallimin mes fukarave në grada të ndryshme. Fukaraja lakmitar del të jetë njëzet e pesë gradë më poshtë se fukaraja zahid, sepse aq është dallimi mes numrave katërdhjetë dhe pesqind. Mos mendo se vlerësimi i Resulallahut, s.a.v.s., është i rastësishëm. Kurrresi! Hazreti Muhammedi, s.a.v.s., e ka folur vetëm të vërtetën, jo sipas tekeve të veta, por vetëm sipas shpalljes që i arrinte. E njëjta vlen edhe për fjalët e tij:

“Ëndrra e vërtetë është një pjesë nga katërdhjetë e gjashtë pjesët e nubuvvetit.”¹¹

Kjo është padyshim një shprehje e së vërtetës. Por, të tjerët mund ta interpretojnë këtë proporcion vetëm për afërsisht, sepse askush përveç Resulallahut, s.a.v.s., nuk e di hakikatin e kësaj proporcioni. Nubuvveti është ajo me çka pejgamberët dallojnë prej të tjerëve. E ky dallim i tyre i ka disa veçori:

¹¹ Buhari nga Ebu Seid, e sikur Muslimi edhe nga Ebu Hurejre, Ubade ibn Samit dhe Enesi, r.a..

Veçoria e parë; ai e di të vërtetën për Qenien dhe cilësitë e Allahut, të vërtetën për melekët dhe ahiretin. Njohuria e tij nuk është si njohuria e të tjerëve. Njohuria e tij është më e gjerë, më e shumtë, është njohje e saktë dhe përmes keshfit.

Veçoria e dytë; pejgamberit i është dhënë muxhize. Muxhize është shenjë e vërtetësisë së pejgamberllëkut.

Veçoria e tretë; pejgamberi e ka cilësinë e shikimit të veçantë që me të i sheh melekët, si personi me shikim të shëndoshë që ka cilësi përmes së cilës dallon prej të verbrit dhe mund të shohë.

Veçoria e katërt; pejgamberi ka cilësi të veçantë përmes së cilës mund të shikojë, zgjuar ose në gjumë, në *Levh-i Mahfuz*, dhe e kupton çfarë do të ndodhë në të ardhmen.

Dihet mirë që këto cilësi të përsosura gjenden te pejgamberët, dhe ato ndahen në shumë pjesë. Ne mund t'i ndajmë secilën prej tyre në dyzet, pesëdhjetë, ose gjashtëdhjetë pjesë, dhe me një ndarje më të hollë, mund ta ndajmë edhe në katërdhjetë e gjashtë pjesë, kështu që mund të jetë një pjesë prej katërdhjetë e gjashtë pjesëve të një ëndrrë të vërtetë (*nubuvvet*). Por për ne është e pamundur që të përcaktojmë mënyrën e saktë të ndarjes.

Ne mund të flasim vetëm për afërsisht, dhe nuk e dimë sigurt se a ka menduar Resulallahu s.a.v.s., pikërisht në këtë ndarje apo jo. Ne i dimë vetëm cilësitë që gjenden te pejgamberët me të cilat plotësohet pejgamberllëku dhe ndarjet mes tyre. Kjo nuk mund të jetë një udhëzues në përcaktimin e shkakut të kësaj ndarje.

Si kjo, ne gjithashtu kuptuam se të varfrit kanë grada të ndryshme. E tash, pse, për shembull, i varfri lakmitar gjendet në 2/6 pjesë të gradës së të varfrit zahid, prandaj i varfri zahid ka katërdhjetë vjet përparësi të hyrjes në xhennet, e na është treguar lidhur me përparësinë prej pesqind vitesh – e këtë njeriu, përpos Pejgamberit, a.s., nuk mund ta dijë. Ne mund të supozojmë, megjithatë asgjë nuk është e sigurt. Por t'i kthehemi transmetimeve; Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Më të mirët e këtij ummeti janë të varfrit. E të parët që do të vendosen në xhennet janë të dobët e tyre.”¹²,

“I kam dy mjeshtri, kush i do ato më do edhe mua, e kush i urren ato më urren edhe mua; e ato janë varfëria dhe xhihadi.”¹³

Transmetohet se Xhebraili, a.s., erdhi te Resulallahu, s.a.v.s., e i tha:

¹² Nuk është gjetur burimi i transmetimit.

¹³ Nuk është gjetur burimi i transmetimit.

- O Muhammed, Allahu Teala po të dërgon selam, e po të pyet: “A dëshiron që këto male t’i shndërroj në ar për ty, e të jetë me ty kudo që ti të shkosh?” Resulallahu, s.a.v.s., heshti një kohë, pastaj u përgjigj:

- O Xhebrail, dynjaja është shtëpi e atij që nuk ka shtëpi, është pasuri e atij që nuk ka pasuri, dhe atë e merr i pamendi. Në këtë, Xhebraili, a.s., i tha:

- O Muhammed, Allahu të bëri të thuash të vërtetën dhe të jesh qëndrueshëm në drejtësi”¹⁴

Sipas transmetimit, Isa, a.s., rrugës kaloi pranë një personi që po flinte i mbështjellur me xhyben e vet. Isa, a.s., e zgjoi e i tha:

- O gjumash, zgjohu e përmende Allahun Teala.

- Çfarë do nga unë?; i tha personi - **Unë dynjanë ia kam lënë atyre që ju takon.** Atëherë, Isa, a.s., i tha:

- Vazhdo pra në gjumë, miku im i dashur.

Musa, a.s., kaloi pranë dikujt që po flinte në tokë. Ishte mbështjellë me xhybe, nën kokë kishte një qerpiç e fytyrën dhe mjekrën në dhé. Musa, a.s., tha:

- O Rabbi im, ky rob i Yti paska humbur në dynja dhe paska mbetur i privuar nga dynjallëku! Atëherë Allahu Teala i shpalli:

¹⁴ Ky transmetim i përfshin dy hadithe; Tirmidhi nga Ebu Umame dhe Ahmedi nga Ajshe, r.a.,

- O Musa, a nuk e di ti që kur Unë e kthej Fytyrën Time kah rob i Im, e privoj atë rob plotësisht nga dynjallëku?!

Skillavi i liruar nga Resulallahu s.a.v.s., Ebu Rafi, tregon:

- Na erdhi një mysafir, e Resulallahu a.s., më tha:

- Shko te filan çifuti, tregoi që më ka ardhë mysafiri dhe le të japë pak miell veresi deri në muajin Rexhep.

Çifuti tha se nuk jep veresi pa marrë hipotekë. Kur i tregova Resulallahut a.s., ai tha:

- Vallahi, unë jam emin (i besueshëm), në qiell dhe në tokë. Po të më jepte veresie do ta paguaja ditën e përcaktuar. Merr këtë mburojë, jepja hipotekë e merre miellin.¹⁵

Kur shkova, Resulallahut, s.a.v.s., iu shpall ajeti:

‘Dhe mos ia ngul sytë bukurisë së kësaj jete me të cilën i bëmë të kënaqen disa prej tyre (mosbesimtarë)’ (20-Ta Ha: 131).¹⁶

Ajeti është ngushëllim dhe udhëzim Resulallahut, s.a.v.s., për braktisje të dynjallëkut. E Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Më e bukur është varfëria e besimtarit se sa e bardha në ballin e kalit dhe rripi i qëndisur në të.”¹⁷

¹⁵ Is’hak b. Rahuje në **‘Musned’**, Haraiti në **‘Mekarimul-Ahlak’** dhe Ibn Merduje në **‘Tefsir’**.

¹⁶ Taberani, me zinxhir të dobët (*daif*)

¹⁷ Taberani nga Sheddad ibn Evs.

“Kushdo prej juve që zgjohet në mëngjes i shëndetshëm është i sigurt për nderin dhe jetën, e nëse edhe e ka ushqimin e asaj dite, sikur t’i jetë dhuruar e gjithë dynjaja me krejt pasuritë e saj.”¹⁸

Ka’b Ahbar ka thënë: *“Allahu Teala i tha Musasë, a.s.:*

- O Musa, kur sheh që varfëria po vjen drejt teje, thuaj: ‘Mirë se vjen, o tipar dallues i njerëzve të mirë!’

Ata-i Horasani ka treguar: *“Njëri prej pejgamberëve, a.s., po kalonte pranë një bregu deti, dhe e pa një peshkatar. Peshkatari tha “bismilah” (në Emër të Allahut) dhe e hodhi rrjetin, por nuk zuri asgjë. Kaloi pranë një peshkatari tjetër, i cili tha: “bismi’sh-shejtan” (në emër të shejtanit), e hodhi rrjetin dhe, aq shumë peshk zuri sa u lodh duke i mbledhur. Pejgamberi a.s., u habit dhe pyeti:*

- O Rabbi im, çfarë është kjo? Unë e di që gjithçka është në dorën Tënde!

Atëherë, Allahu Teala ju tha melekëve:

- Zbulojani këtij pejgamberit Tim vendin e këtyre dy personave; e kur ky pejgamberi e pa çfarë vendi Allahu Teala i ka bërë gati peshkatarit të parë, dhe çfarë poshtërime të dytit, tha:

- Unë jam i kënaqur me Ty, Rabbi im!

¹⁸ Taberani

E peygamberi jonë, Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“M’u tregua xhenneti, dhe e pashë se banorët e tij ishin shumica të varfër. M’u tregua edhe xhehenemi, dhe e pashë se banorët e tij ishin më së shumti të pasurit dhe gratë...”,

e në versionin tjetër vazhdon: **“...dhe pyeta:**

- E ku janë të pasurit?, e m’u tha:

- Ata i ka lënë pas mendjemadhësia;

e në një tjetër version:

“...banorët e xhehenemit ishin shumica gra, dhe pyeta:

- Çfarë ishte gjendja e tyre; e m’u dha përgjigje:

- I patën hutuar stolitë me ar dhe aromat e këndshme.”¹⁹

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Dhurata e besimtarit në këtë botë është varfëria”²⁰,

e në version tjetër thuhet:

“Peygamberi i fundit që do të hyjë në xhennet është Sylejmani, djali i Daudit, alejhimes-selam, sepse ka qenë mbret. Ndërsa i fundit nga as’habët e mi që do të hyjë në xhennet është Abdullah ibn Avf, sepse ka qenë i pasur”,
dhe prapë, në version tjetër:

¹⁹ Është përmendur te *Edebi i martesës*, version më i zgjeruar.

²⁰ Muhammed ibn Hafif Shirazi në *Shereful-fakr*, dhe Ebu Mensur Dejlemi në ‘Musned-i Firdevs’ nga Muadh ibn Xhebel, r.a., Ebu Mensur shënon edhe versionin nga Ibn Omeri, r.a.

“E pashë (Abdullah ibn Avf) duke hyrë në xhennet këmbadoras.”²¹

Isa, a.s., ka thënë: *“Pasaniku do të hyjë në xhennet me vështirësi”*, e në një lajm nga Ehli Bejti, tregohet se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur Allahu e do një rob, Ai e sprovon me bela, e kur dashuria arrin në pikën e fundit, nuk i lë asgjë, as familje, as pasuri.”²²; dhe me një lajm tjetër:

“Kur sheh që varfëria po vjen drejt teje, thuaj: ‘Mirë se vjen, o tipar dallues i njerëzve të mirë!’; e kur sheh se pasuria po afrohet, thuaj: ‘O gjynah, që dënimi të është shpejtuar’.”²³

Musa, a.s., pyeti:

- O Rabbi im, cilët nga robët Tu i do, që edhe unë t’i dua ata, për rizanë Tënde?,

e Allahu Teala u përgjigj:

- ***Secili fukara, secili fukara.***

Me siguri u përsërit dy herë që të përforcohet edhe më shumë, e ndoshta edhe të theksohet se sa telashe e madhe është varfëria.

²¹ Tashmë është përmendur.

²² Taberani nga Ebu Utbe Havlani.

²³ Ebu Mansur në *‘Musned-i Firdevs’* nga Ebu Derda.

Isa, a.s., ka thënë: *"E dua varfërinë, nuk më pëlqen bollëku"*, e ndjehej i lavdëruar kur e thërrisnin *fukara*. Isa a.s., më së shumti gëzohej kur e quanin: *"O i varfër!"*

Elita dhe pasanikët e arabëve, e në mesin e tyre ishin Akrb b. Habis et-Temimi, Ujejne b. Hasn el-Fezari, Abbas b. Mirdas es-Sulemi e të tjerë, i thanë Muhammedit, a.s.:

- Cakto një ditë për ne, një për ta, që kur ata të vijjnë, ne të mos vijmë, e kur të vijmë ne, të mos vinë ata. Ne nuk mund të jemi bashkë. Ata bartin rroba të leshta edhe në të nxehtit më të madh, dhe ju vjen era djersë!

Qëllim kishin të varfrit si Bilalli, Selmani, Suhejb, Ebu Dherr, Habbab ibn Erta, Ammar ibn Jasir, Ebu Hurejre dhe as'habët suffa. Resulallahu, s.a.v.s., ua pranoi kërkesën, dhe ju tha se nuk do t'i ulë bashkë. Atëherë zbriti ajeti:

"Rri me ata që e lusin Rabbin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (razinë) e Tij, dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre (pra, prej fukarave) e të kërkossh bukurinë e kësaj bote, (pasurinë), dhe mos dëgjo atë, zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë e, që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprimet e veta.

Dhe thuaj: "E vërteta është nga Rabbi juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë."

18-Kehf: 28, 29

Ibn Ummi Mektum kërkoi leje të hyjë te Resulallahu, s.a.v.s., e aty ishte prezent njëri nga elita e Kurejshëve. Resulallahut, s.a.v.s., kjo nuk i pëlqeu. Në këtë, Allahu Teala i shpalli:

“Ai (Muhammedi a.s.) vrenjti fytyrën dhe u kthye.

Ngase atij i erdhi i verbri.

E ku mund ta dish ti, ndoshta ai do të pastrohet.

Apo do të këshillohet dhe këshilla do t'i bëjë dobi!”

(80-Abese: 5, 6)

Transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Në ditën e Gjykimit një rob sjellet para Allahut Teala. Ashtu siç një njeri në botë i kërkon falje një tjetrit, Allahu i kërkon falje këtij njeriu dhe thotë:

- Pasha forcën e madhëstinë Time, nuk të largova nga dynjallëku për të turpëruar, por për shkak të nderimeve dhe pozitive që i kam përgatitur për ty...

Dil prej atij rreshti dhe shiko; nëse gjen njerëz që të kanë ushqyer ose veshë, për rizanë Time, merre atë për dore, është i yti.

Atë ditë në vendin e mahsherit njerëzit do të zhyten në djersë. Personi hyjn ndër radhët e tyre me urdhër të Allahut. Gjen njerëz që janë kujdesur për të, i merr për dore e i dërgon në xhennet.²⁴

²⁴ Tirmidhi nga Ajshe, r.a..

Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- **Njoftohuni mirë me të varfrit dhe ndihmoni ata. Sepse ata kanë një mbarësi.**

- *Çfarë mbarësie është ajo, o Resulallah?, pyetën as'habët, e Resulallahu, s.a.v.s., u përgjigj:*

- **Në ditën e Gjykimit, do t'ju thuhet: *Kërkojeni atë që ju ka ushqyer edhe me një kafshatë, atë që ju ka dhënë ujë edhe me një gllënjë, dhe atë që ju ka veshur me rroba. Kapeni për dore dhe vazhdoni me të në xhennet.***²⁵

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Hyra në xhennet, e dëgjova dikë të lëvizë para meje. Shikova, ishte Bilali. Shikova shtresën më të lartë të xhennetit, pashë atje fukaratë nga ummeti im me fëmijët e tyre. Shikova shtresën e poshtme të xhennetit dhe pashë atje vetëm disa pasanikë dhe gra. Pyeta:

- ***O Rabb çfarë është gjendja e tyre?*; e m'u përgjigj:**

- ***Grave ju bënë dëm dy të kuqërremta, ari e mëndafshi, e pasanikët ishin të zënë me pasuri të madhe.***

I kërкова as'habët e mi, por nuk e pashë Abdullah ibn Avf. Më pas ai erdhi te unë duke qarë. E pyeta:

- ***Çfarë të ndau nga unë?*, e ai m'u përgjigj:**

- ***O Resulallah, pasha Allahun, arrita tek ti vetëm kur m'u zbardhën flokët, e mendova se nuk do të t'shoh.***

- ***E pse?*, e pyeta, e ai m'u përgjigj:**

²⁵ Esh- Shejh në 'Kitabu's – Sevab' nga Eneri, r.a.

- Dhashë llogari për pasurinë time.”²⁶

Abdurrahman ibn Avf ishte as’hab i Resulallahut, s.a.v.s. që nga fillimi, është njëri prej dhjetë as’habëve të cilëve ende sa ishin gjallë, ju është premtuar xhenneti, dhe njëri prej të pasurve për të cilët Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: **"Por, përjashtohen ata që shpërndajnë/jepen pasurin (nga pasuria) e tyre për ba/mirësi."**, e megjithatë, pasuria e dëmtoi deri në këtë gjendje.

Resulallahu, s.a.v.s., shkoi te një njeri i varfër dhe pa se ai nuk posedonte asgjë, e i tha:

- Nëse nuri i këtij t’ju ndahej të gjithë njerëzve në tokë, do të ishte e mjaftueshme për ta.²⁷

Resulallahu, s.a.v.s., pyeti:

- A t’ju njoftoj për mbretërit e xhennetit?, e as’habët e nderuar u përgjigjën:

- Po, o i Dërguari i Allahut!; e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- Secili i dobët, i përbuzur, i pluhërosur, i shprishur, me rroba të vjetra, për të cilin askush nuk mërëzitet, - nëse i këtilli e lutë Allahun për diçka, lutja i pranohet.²⁸

²⁶ Taberani, nga Ebu Umame, me zinxhir të dobët (*daif*). Tregimi për Bilallin, r.a., shënohet në *Sahih* të Buharit, me zinxhir të gjatë të transmetuesve.

²⁷ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Dherr.

²⁸ Buhari e Muslim nga Haris ibn Vehb..

Imran ibn Husajn ka treguar: “Kisha pozitë e respekt te Resulallahu, s.a.v.s., e një ditë më tha:

- **O Imran, ti je njeri që e duam dhe ke respektin tonë. Eja nëse dëshiron, të vizitojmë vajzën time Fatimen.**

Unë iu përgjigja:

- Po, o Resulallah, ti që më je më i dashur se nëna e babai. Ai u ngrit, u ngrita edhe unë, dhe erdhëm te dyert e Fatimesë, r.anha. Resulallahu, s.a.v.s., trokiti në derë, e tha:

- **Esselamu alejkum! A mund të hyj?**,

e Fatimeja, r.anha, u përgjigj:

- Hyr, o i dërguar i Allahut. Resulallahu, s.a.v.s., pyeti:

- **A mund të hyjë edhe dikush që është me mua?**,

e Fatimeja, r.anha, pyeti:

- E kush është me ty, o i dërguar i Allahut?

- **Është Imrani;** u përgjigj Resulallahu, s.a.v.s., e Fatimeja, r.anha, tha:

- Pasha Atë që ty të ka dërguar me të vërtetën si pejgamber, në vete kam vetëm mantelin.

- **Mbështille kështu e ashtu, dhe i tregoi me dorë.** Fatimeja, r.anha, tha:

- E fsheha trupin, po çfarë të bëj me kokën?, e Resulallahu, s.a.v.s., ia hodhi shallin e vet, e i tha:

- **Mbështille këtë rreth kokës.**

Atëherë Fatimeja, r.anha, dha leje për hyrje, e Resulallahu, s.a.v.s., hyri e tha:

- **Esselamu alejkum, bija ime. Si je?**

- *Pasha Allahun, u zgjova nga gjumi, e po ndjej dhimje, dhe vetëm sa po më shtohet. Nuk kam çfarë për të ngrënë, e edhe uria më ka lodhë. Resulallahu, s.a.v.s., qau, e tha:*

- *Mos vajto, bija ime. Pasha Allahun, as unë nuk kam shijuar asgjë ka tri ditë, e jam më i zgjedhur te Allahu se ti. Po të kërkoja nga Rabbi im, do të më ushqente, por i kam dhënë përparësi ahiretit ndaj dynjallëkut.*

Pastaj e përkëdheli në krahëror, e i tha:

- *Gëzohu, pasha Allahun, ti je e para (sejjida) grua në xhennet. Fatimeja e pyeti:*

- *E ku është Asija, gruaja e faraonit, dhe Merjem, e bija e Imranit?, e Resulallahu, s.a.v.s., u përgjigj:*

- *Asija është e para nga gratë e kohës së vet. Merjemi është e para nga gratë e kohës së vet, e ti je e para nga gratë e kohës tënde. Jeni në shtëpi nga xhevahirët, ku nuk ka shqetësim, as zhurmë, as sëmundje, e më pas i tha:*

- *Të jesh e kënaqur me djalin e xhaxhasë tënd. Pasha Allahun, je martuar për të parin (sejjid) edhe të kësaj bote edhe të botës tjetër.”²⁹*

Alia, r.a., transmeton se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur njerëzit i urrejnë të varfrit e tyre, i kushtohen ndërtimeve dhe jepen pas pasurisë, Allahu u jep katër telashe: kohë të pamjaftueshme, zullum të sundimtarit, tradhti të gjyqtarit, epërsi të armikut.”³⁰

²⁹ Tashmë është përmendur.

³⁰ Ebu Mensur Dejlemi. Ka një transmetues të panjohur, prandaj është i papranuar (*munkur*).

Nga transmetimet e gjeneratave të para të myslimanëve, në këtë çështje, Ebu Derda ka thënë: *“Ai që i ka dy dërhëmë do të ketë llogari dhe ndëshkim më të rëndë se sa ai që ka vetëm një dërhëm.”*

Omeri, r.a., ia dërgoi Seid ibn Amirit njëmijë dinarë, e ky u kthye në shtëpi i dëshpëruar, e gruaja e pyeti:

- *Mos ka ndodhë diçka?* Amiri tha:

- *Edhe më keq! Ma sjell atë fustanin tënd të vjetër; dhe duke e ndarë fustanin në copa, bëri qese e i vendosi dinarët aty. Pastaj u ngrit dhe fali namaz e qau deri në mëngjes, e atëherë tha:*

- *E kam dëgjuar Resulallahun, s.a.v.s., duke thënë:*

“Të varfrit e ummetit tim do të hynë në xhennet pesqind vjet para të pasurve. Ndonjë prej të pasurve bile do të futet në grupin e fukarave, por do ta kapin për dore e do ta nxjerrin prej aty”, dhe i shpërndau të gjitha ato para.

Ebu Hurejre ka thënë: *“Tre do të hyjnë në xhennet pa dhënie të llogarisë: ai që dëshiron t’i lajë rrobat e veta por nuk ka çfarë tjetër të veshë, ai që nuk mund të vendos dy tenxhere në të njëjtin zjarr dhe ai që kërkon të pijë e nuk e pyesin ‘prej cilën enë e dëshiron’.”*

Tregohet se një i varfër erdhi te Imam Sevri, e ky i tha:

- *Eja më afër! Po të ishe i pasur, nuk do të afroja!*

Në mexhlisiet e Sevrisë, të pasurit dëshironin të ishin të varfër, sepse, të varfrit Sevriu i merrte afër vetes, e të pasurit uleshin më larg.

El-Muemmil b. Ismail el-Besri ka thënë: *“Askund nuk kam parë pasanikë më modestë, e as fukara më krenarë, se sa në mexhlisiet e Sufjan Sevrisë.*

Një i mençur ka thënë: *“Sa meskinë janë bijtë e Ademit, a.s.! Po ta kishin frikë xhehenemin siç e kanë frikë varfërinë, do të shpëtonin. Po ta dëshironin xhennetin siç e dëshirojnë dynjallëkun, do të kishin sukses. Po ta kishin në fshehtësi frikë Allahun Teala siç i frikësohen ashiqare krijesave të Tij, do të ishin të lumtur, në të dy botët.”*

Ibn Abbas ka thënë: *“I mallkuar qoftë ai që i shpreh nderim pasurisë dhe e përçmon varfërinë.”*

Llukmani, a.s., i tha djalit të vet: *“Askënd mos e përbuz për shkak të rrobave të vjetra; Sepse Rabbi yt e i tij është Një.”*

Jahja ibn Muadh ka thënë: *“T’i duash të varfrit është nga ahlaku i pejgamberit. Zgjedhja e maxhlisit të tyre është shenjë e të mirëve (salih), e ikja nga shoqërimi me ta është shenjë e dyfytirësisë.”*

Në librat e zbritura më parë, Allahu Teala i shpalli njërit prej të dërguarve të Tij:

- *Ruaju që të mos përbuzi Unë, e të mos kesh më vlerë të Unë, e të mos lëshoj plotësisht dynjallëkut.*

Ajshe, r.anha, i shpërndau njëmijë dinarë për një ditë. Muavi ibn Amir e të tjerë ia dhuruan prapë asaj, sepse fustanin e kishte të gjithin të arnuar. Shërbëtorja i tha:

- Të na kishe blerë mish, bile për një derhem nga këto që i ndave, e të kemi sonte për iftar. Ajshe, r.anha, që ishte duke agjëruar, i tha:

- Po të më thojë, do ta bleja.

E Resulallahu, s.a.v.s., Ajshen, r.anha, e kishte porositur:

“Nëse dëshiron të arrish tek unë, jeto jetë të varfër, mos u shoqëro me gratë e të pasurve, e rrobat mos i hudh deri sa ta arnosh të gjithën.”³¹

Një person ia solli Ibrahim ibn Ed’hemit në shtëpi dhjetë mijë derhemë, e ibn Ed’hem refuzoi t’i marrë, por ky këmbënguli, e atëherë, ibn Ed’hem i tha:

- A dëshiron të më fshihet emri nga libra e të varfërve për këto dhjetë mijë derhemë? Kurrë nuk do të pranoj!

Allahu e mëshiroftë.

³¹ Tirmidhi, që e cilëson të pazakontë (*garib*) dhe Hakimi, që e cilëson si hadith të besueshëm (*sahih*).

VLERA E LARTË (FAZILET) E FUKARASË

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Myzhde për personin i cili është i udhëzuar në fenë e islamit, që ka furnizim të mjaftushëm dhe është i kënaqur me këtë”³²,

si edhe:

“O grupi i fukarave, nëse jeni nga zemra të kënaqur me caktimin e Allahut, do të merrni shpërblimin e varfërisë tuaj. Në të kundërtën, jo.”³³

Personi i përmendur në hadithin e parë është ai që është i kënaqur me pak, (*kana’at*) e në të dytin, ai që është i kënaqur (*razi*) me përcaktimin e Allahut. E dikush edhe mund të kuptojë nga ky hadith se fukaraja lakmitar (*el-haris*), nuk ka shpërblim. Mirëpo, kur merret parasysh vlera e varfërisë që përshkruhet në transmetime tjera kuptohet se edhe nëse fukaraja është lakmitar, ai prapë do të marrë shpërblim. Ne do të tregojmë të vërtetën në lidhje me këtë çështje më vonë. Pakënaqësia që mendohet këtu mund të jetë pakënaqësia që Allahu Teala e krijoi atë fukara. Sa ka fukara lakmitarë që duan të jenë të pasur, por nuk i zemërohen caktimit të Allahut. Pikërisht kjo pakënaqësi ndaj caktimit të Allahut, e shkatërron sevapin e varfërisë.

³² Shënon Muslimi, dhe tashmë është përmendur.

³³ Ebu Mensur Dejlemi në ‘Musned-i Firdevs’ nga Ebu Hurejre.

Omer ibn Hattab, r.a., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Gjithçka e ka një çelës, e çelës i xhennetit është dashuria ndaj të varfrit (dhe të mjerët), për shkak të durimit të tyre. Në ditën e kiametit ata do të bisedojnë me Allahun Teala.”³⁴

Alia, r.a., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Robi më i dashur për Allahun Teala është fukaraja i kënaqur me riskun e vet dhe i kënaqur me caktimin e Allahut.”³⁵

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“O Allahu im, jep risk për familjen e Muhammedit aq sa të jetë i mjaftueshëm”³⁶,

si edhe:

“Qoftë i varfër apo i pasur, secili, në ditën e Gjykimit do të dëshirojë të thotë: *'sikur të më ishte dhënë aq risk sa do të më mjaftonte.'*”³⁷

³⁴ Darekutni, në ‘Garaib’ Ebu Bekr ibn Lal në ‘Mekarimul-ahlak’, Ibn Asijj në ‘el-Kamil’, dhe Ibn Hibban në ‘Dhu’afa’ nga Ibn Omeri, r.a..

³⁵ Hadithi me këtë përmbajtje nuk është gjetur, e i ngjashëm, nga Ibn Maxhe, tashmë është përmendur.

³⁶ Buhari dhe Muslim nga Ebu Hurejre.

³⁷ Ibn Maxhe, nga Enesi, r.a., e tashmë është përmendur.

Allahu Teala i shpalli Davudit Alejhisselam:

- ***Më kërko në zemra të thyera.***

- *Cilët janë ata?*, pyeti Davudi, a.s., e Allahu Teala tha:

- ***Fukaratë e singertë.***

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: **“Kur i varfri është i kënaqur (*razi*) me gjendjen e vet, nuk ka më të virtytshëm se ai.”**³⁸

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Në ditën e Gjykimit, Allahu Teala do të thotë:

- ***Ku janë robët e Mi të pastër (halis)?; e melekët do të pyesin:***

- ***Kush janë ata, o Rabbi ynë?; e Allahu Teala thotë:***

-***Myslimanët e varfër, që ishin të kënaqur me dhuratat e Mia, të kënaqur me përcaktimin (kader) Tim. Dërgoni në xhennet. Ata do të dërgohen në xhennet, do të hanë e do të pinë, e njerëzit e tjerë ende do të jenë të shqetësuar, duke dhënë llogari.”***³⁹

Ky shpërblim është për ata që janë të pajtuar me varfërinë (*kana’at*) dhe të kënaqur (*razi*) me përcaktimin. Inshallah, ne do të shpjegojmë vlerën e lartë (*fazilet*) të tyre në pjesën e dytë të librit.

³⁸ Nuk është gjetur hadith me këtë përmbajtje.

³⁹ Ebu Mensur Dejlemi në ‘Musned-i Firdevs’

Ka shumë transmetime nga as'habët dhe taibinët për riza dhe *kana'at*. Dhe është e njohur se e kundërta e mjaftueshmërisë (*kana'at*) është lakmia.

Omeri, r.a., ka thënë:

"Tahmahqarllëku është varfëri, ndërsa ngopja shpirtërore është pasuri. Ai që nuk e ka syrin në pasurinë e të tjerëve, që është i kënaqur me riskun e vet, do të jetë i pavarur prej tyre."

Ebu Mesud, r.a., ka thënë:

*"Nuk ka ditë e që një melek të mos thërrasë nën Arsh:
- O bijtë e Ademit, ajo pak me të cilën jeni të kënaqur,
është më e mirë se sa ajo shumë e që ju dërgon në teprim."*

Ebu Derda r.a., ka thënë:

"Nuk ka njeri pa mangësi në mendje. Sepse, secili gëzohet kur përfiton diçka nga dynjallëku, por që nata e dita pandërprerë i marrin pjesë të jetës, nuk brengoset. I mjeri ti, o njeri! Çfarë dobie ka shtimi i pasurisë kur jeta vjen duke t'u shkurtuar!"

E pyetën një të mençur:

- Çka është pasuria?; e ai u përgjigj:
- Kërkesa për pak dhe kënaqësia me atë që të mjafton.

Ibrahim ibn Ed'hem kishte shumë pallate në Horosan. Një ditë doli nga pallati, e në bahçe pa një person që kishte një somun në dorë dhe e hante. Kur e hëngri, ra në gjumë. Ibrahim i tha njërit prej shërbëtorëve:

- *Ma sillni këtë person tek unë kur të zgjohet!*

Kur personi u zgjua, shërbëtori e solli para Ibrahimit, e ky e pyeti:

- *O njeri, a kishe uri që e hëngre atë somun?* Personi pohoi, e Ibrahim prapë pyeti:

- *A fjetë mirë?* Ky prapë pohoi e Ibrahim tha në vete:

- *Çfarë të bëj unë me dynjallëkun?* Njeriu kënaqet edhe me kaq!

Një person kaloi pranë Amir ibn Abdulkajs, që po hante qepë me kripë, dhe e pyeti:

- *O Amir, a me kaq je i kënaqur në dynjallëk?*, e Amiri, r.a., ia tha:

- *A të tregoj kush është i kënaqur me më pak se kaq?*

- *Më trego;* tha personi, e Amiri, i tha:

- *Ai që e harron ahiretin e është i kënaqur me dynjallëk.*

Muhammed ibn Vasi merrte bukë, e lagte me ujë dhe e hante me kripë, duke thënë: *"Kush është i kënaqur me kaq në dynja, ai nuk ka nevojë për askënd."*

Hasan Basriu ka thënë: *“Allahu i mallkoftë ata që nuk janë të kënaqur me përcaktimin e Allahut”, e më pas lexoi ajetin:*

“Në qiell është furnizimi juaj dhe ajo që ju premtohet.

Pasha Rabbin e qiellit e të tokës, kjo është një e vërtetë, ashtu siç është e vërtetë se ju flisni.”

51-Dharijat: 22, 23

Ebu Dherr r.a., një ditë ishte ulur me disa njerëz. Kur i erdhi gruaja, i tha:

- *Ti po rri me ta, e, pasha Allahun, në shtëpi nuk kemi as çfarë të hamë e as çfarë të pimë!* Ebu Dherr, r.a., u përgjigj:

- *Përpara nesh është një vend-kalim. Nga aty do të shpëtojë vetëm kush ka peshë të vogël.* Pas këtyre fjalëve, gruaja u kthye mbrapa, e kënaqur me përgjigjen.

Zunnun-i Misri ka thënë: *“Më së afërti mosbesimit është i varfri i padurueshëm.”*

E pyetën një të mençur:

- *Cila është pasuria jote?*, e ky u përgjigj:

“Bukuria në zahir (të jashtmen), modestia në batin (të brendshmen) dhe mosinteresimi për ato që të tjerët i posedojnë.”

Thuhet se Allahu Teala, në një nga librat që u dërgoi pejgamberëve të kaluar, thotë:

“O biri i Ademit, edhe sikur ta posedoje të gjithë dynjallëkun, prej saj do të merrje vetëm aq sa mund të hash. E kur Unë të dhuroj ty aq sa ti ke nevojë, e llogarinë për këtë e drejtoj tek dikush tjetër (pra kur dikush tjetër të ushqen), po të bëj një të mirë.”

Për kënaqjen me pak (*kanna’at*) poeti thotë:
*Karshi Allahut trego përrulje, karshi të tjerëve jo.
Liria prej tyre është madhështi, asgjë mos ju kërko.
Edhe nga familja ti të kesh liri,
Kënaqja me çfarë ke - kjo është pasuri.*

PËRPARËSIA E FUKARASË NDAJ TË PASURIT

Dije se dijetarët janë në mosmarrëveshje për këtë çështje. Xhunejdi Bagdadi, Havvas, dhe shumë të tjerë, kanë thënë se fukarallëku është më me vlerë se pasuria. Ibn Atta ka thënë: *“I pasuri, që është edhe falënderues dhe i drejtë, është më me vlerë se fukaraja i durueshëm.”*

Thuhet se për shkak se ai e kundërshtoi në këtë çështje, Xhunejdi e mallkoi Ibn Attan, e ky përjetoi vuajtje.

Në *Librin për durimin*, ne e shpjeguam kur është më mirë për të qenë i durueshëm e falënderues, dhe e trasuam rrugën për të njohur se kur është cila gjendje ose vepër më e mirë, e kjo mund të shpjegohet vetëm në mënyrë të detajuar. E sikur fukaraja dhe i pasuri të krahasohen në përgjithësi, ai që i ka lexuar hadithet dhe transmetimet nga as'habët dhe taibinët nuk do të ketë dyshim se fukaraja ka përparësi. Por, për këtë çështje duhet shpjegim i hollësishëm. Ne themi se dyshimi mendohet në dy raste:

Rasti i parë është grada mes fukarasë së durueshëm që nuk ka dëshirë për pasuri por është i kënaqur me pak, dhe të pasurit që e jep pasurinë në bamirësi e nuk është lakmitar.

Rasti i dytë është grada mes fukarasë lakmitar dhe pasanikut lakmitar. Përndryshe nuk ka dyshim që pasaniku që e harxhon pasurinë në hajr është më i vlefshëm se fukaraja lakmitar, dhe fukaraja i kënaqur me pak është më i vlefshëm se i pasuri tahmahqar.

Sa i përket të parës, shpesh mendohet se i pasuri është më i vlefshëm se fukaraja. Ndoshta, nëse asnjëri nuk ka dëshirë të flakët për pasuri. Pasaniku është më afër vlerës më të madhe sepse jep sadaka dhe bën vepra të hajrit, e fukaraja këtë nuk mundet. Këtë e ka menduar Ibn Atta.

Por, pasaniku i cili vërtetë kënaqet në pasurinë e tij, goftë edhe me gjëra të lejuara (*mubah*), assesi nuk mund të mendohet si më me vlerë se sa fukaraja që është i kënaqur me pak. Si dëshmi mjafton hadithi i Resulallahut, s.a.v.s., ku thuhet se fukaratë iu ankuan se të pasurit - me vepra të mira, me sadaka, me kryerje të haxhit e me mundësi të shkojnë në xhihad - ua kalojnë këtyre, e Resulallahu, s.a.v.s., ju mësoi fjalë me të cilat lavdërohet Allahu Teala e ju tregoi se me këtë ua kalojnë në pozitë të pasurve. Kur të pasurit dëgjuan, filluan edhe ata t'i lexojnë ato fjalë, e të varfrit shkuan prapë te Resulallahu, s.a.v.s., dhe i treguan. Resulallahu, s.a.v.s., atëherë tha:

“Ajo është mirësi e Allahut, Ai ia jep atë kujt Ai dëshiron.”⁴⁰

Këtë hadith e mori dëshmi edhe ibn Atta kur u pyet, e tha se pasaniku është më me vlerë meqenëse e ka një cilësi të Hakkut. Por, mospajtime ka kur merret parasysh dëshmia e shprehur në pjesën e parë të hadithit, sepse ceket qartë e kundërta e porosisë së fundit - që fukaraja ka më shumë sevap se sa pasaniku, dhe njofton që kjo është **mirësi e Allahut**.

Zejd b. Eslem transmetoi nga Enes b. Malik: *“Fukaratë e dërguan një përfaqësues te Resulallahu, s.a.v.s., e ky tha:*
- Jam përfaqësues i fukarave, i dërguar te ti.

⁴⁰ Shënojnë Buhari dhe Muslim nga Ebu Hurejre.

- Mirë se erdhe, ti e ata që të dërguan, unë ata i dua;
tha Resulallahu, s.a.v.s.. e përfaqësuesi tha:

- Porosia e tyre është: “O Resulallah, (s.a.v.s.) të pasurit na kaluan në mirëbërje, ata e kryejnë haxhin, e ne për këtë nuk kemi mundësi; ata e kryejnë umren, e ne për këtë nuk kemi mundësi; e kur ata sëmuren, të pasurit tjerë ju dërgojnë dhurata të shtrenjta, sepse janë të pasur.”

Atëherë Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- Përcjellju fukarave nga unë se, ai prej jush që është i durueshëm në varfëri, duke llogaritë shpërblimet që do t'i marrë, i ka tri cilësi që i pasuri nuk i ka: Cilësia e parë, në xhennet ka disa pallate në të cilat banorët e xhennetit shikojnë sikur njerëzit në Tokë i shikojnë yjet në qiell. Në ato pallate do të hyjë vetëm peygamberi i varfër, shehidi i varfër, dhe besimtari i varfër. E dyta, fukaratë do të hynë në xhennet para të pasurve për gjysmë dite, e kjo është pesëqind vjet. E treta, kur i pasuri të thotë: “Subhanal-lahi vel-hadmu lil-lahi ve la ilahe illallahu val-lahu ekber (I lavdëruar qoftë Allahu, hamd i takon Allahut, nuk ka zot tjetër pos Allahut, Allahu është Madhështori), e të njëjtën e thotë edhe i varfri, i pasuri kurrë nuk do ta arrijë të varfrin, edhe nëse kësaj ia shton dhjetë mijë derhemë në bamirësi. Njëjtë është me të gjitha veprat e mira.”

Përfaqësuesi u kthye tek fukaratë dhe ju prëcjelli atë që e tha Resulallahu, s.a.v.s., e ata thanë:

- *Ne jemi të kënaqur, jemi të kënaqur.*"⁴¹

Ky hadith e bën të qartë se fjalët: *"ajo është mirësi e Allahut, Ai ia jep atë kujt Ai dëshiron"*, nënkuptojnë sevap më të madh për të varfrit kur bëjnë dhikër.

Në pohimin se i pasuri e ka një cilësi të Hakkut, është përgjigjur një shejh, duke thënë: *"A mendon ti që Allahu Teala është i Pasuri (el-Ganij) me shkaqe dhe pasuri të përkohshme? Ai që e kundërshtoi heshti, por të tjerët në lidhje me këtë hadith kanë thënë: "I Madhi (el- Kebir) është një cilësi i Allahut, prandaj kjo cilësi sigurisht që është më me vlerë se cilësia e përulësisë (et-tevazu). Edhe varfëria është më e mirë, sepse cilësia e robërisë (el-ubudijja) është më me vlerë për robin, sikur edhe frika (el-havf) dhe shpresa (er-rexha), deri sa për cilësinë e Rububijet-it nuk guxon të ketë polemikë."*

Prandaj Allahu Teala thotë, e na ka treguar Resulallahu, s.a.v.s.:

"Madhështia (el-kibrija) është këmisha Ime, e Lartësimi (el-azama) është xhybeja Ime; kush garon me Mua në këtë – do Ta shkatërroj."⁴²

⁴¹ Hadithi në këtë formë nuk është gjetur, por është i njohur versioni që e shënon Ibn Maxhe, nga Ibn Omeri, **"Fukaratë do të hynë në xhennet para të pasurve për gjysmë dite, e kjo është pesqind vjet.**

⁴² Hadithi është përmendur në *Librin për Diturinë*.

Sehl, ka thënë: *“Dashuria për madhështi (el- Kibir) dhe pavdekshmëri (el- Baki) në rububijet është shirk dhe është pretendim në ortakëri me Allahun. Sepse këto janë cilësi të Allahut Teala.”*

Në këtë kuptim, kanë debatuar rreth përparësisë së pasurisë apo varfërisë, E këto janë fjalë të përgjithshme, prandaj kanë interpretime të ndryshme, të cilët edhe e anulojnë njëri-tjetrin. Paqartësitë në këso raste i kemi sqaruar në *Librin për durim (sabr)*, kur thamë se, për diçka që nuk kërkohet për vete por për tjetrin - vlera e kësaj matet me qëllimin e saj. Vetë dynjallëku nuk është i rrezikshëm, por është i rrezikshëm për faktin se njeriut i paraqet pengesë në rrugën e tij drejt Allahut Teala. As varfëria nuk është diçka që kërkohet vetvetiu, por kërkohet për të larguar pengesat dhe mundimet në rrugën drejt Allahut. Ka shumë njerëz të pasur që pasuria e tyre nuk i largoi nga rruga e Allahut Teala, si rasti i Sylejmanit, a.s., Osmanit, r.a., Abdurrahman ibn Avf. Ka shumë njerëz të varfër të cilët angazhohen me fukarallëkun e vet dhe kjo i largon nga qëllimi. Qëllimi më i lartë në botë është dashuria ndaj Allahut Teala dhe afërsia me Të. Kjo ndodh vetëm pasi ta njohim Allahun. Por nuk është e mundur të hysh në rrugën e njohjes e në të njëjtën kohë të angazhohesh me diçka tjetër. Edhe varfëria, njëjtë si pasuria, mund të jetë sebeb për angazhim me diçka tjetër. Por, njeriun e angazhon dashuria e dynjasë, e dashuria për

dynjanë dhe dashuria ndaj Allahut nuk mblidhen bashkë në një zemër. Ai që do diçka, është edhe i angazhuar rreth asaj, pa marrë parasysh a është i ndarë apo bashkë me të. Të pakujdesshmit janë të dashuruar në dynja; ai që nuk e posedon dynjanë angazhohet në kërkim të saj, e ai që e posedon, angazhohet që ta ruajë e të kënaqet në të.

Tani, le të paramendojmë dy persona, një të pasur dhe një të varfër, të cilët nuk kanë asnjë lidhje me dashurinë për pasuri dhe pasuri apo ujë - për ta është njësoj, të dy janë të kënaqur me sasinë e nevojshme. Zaten, posedimi i sasisë së nevojshme është më me vlerë. Sepse kush nuk mund të gjejë aq sa ka nevojë, nuk është në rrugë të njohjes, por në rrugën e vdekjes. E nga këta dy persona, i varfri është më i pëlqyeshëm se sa i pasuri, sepse intriga (*fitne*) e pasurisë është më e rëndë se sa intriga e varfërisë. Durimi (*sabr*) në gjendje të skamjes është më i lehtë se sa durimi në gjendje të bollëkut. Prandaj Alia r.a., ka thënë: *“Edhe pamundësia është një lloj pastërtie.”*

Edhe as’habët kanë thënë: *“U sprovuam me varfëri, por ditëm të jemi të durueshëm. U sprovuam me pasuri, e nuk patëm durim.”* Kjo është natyra e njeriut, në bollëk egërsohet, përpos disa përjashtimeve të rralla individuale, të tillë që në asnjë kohë nuk janë të shumtë.

Por, urdhri i sheriatit është për të gjithë e jo vetëm për individë, e meqenëse pasuria është më tërheqëse për shumicën, sheriatu e qortoi atë, e varfërinë e lavdëroi. Bile, Isa a.s., ka thënë: *“Mos shikoni në pasurinë e banorëve të Tokës. Sepse shkëlqimi i pasurisë së tyre tërheqëse e zbeh dritën e besimit tënd.”*

Një dijetar ka thënë: *“Dashuria për pasuri e zhdukë shijen e imanit”*, e në një hadith thuhet:

“Secili ummet ka një idhull viç që e adhuron. Viçi i këtij ummeti është ari dhe argjendi.”⁴³

Zaten, materiali me të cilin ummeti i Musasë a.s., e bëri viçin dhe e adhuroi si idhull ishte ari dhe argjendi. Pasuria dhe uji, ari dhe gurët janë të njëjtë vetëm për peygamberët dhe për evliatë. Edhe kjo plotësohet pas shumë përpjekjeve dhe me dhuntinë e Allahut. E Resulallahu, s.a.v.s., kur dynjaja iu shfaq me zbukurimet e saj, i tha:

- *Largohu nga unë!*⁴⁴

Alia, r.a., ka thënë: *“O dukat, largohu nga unë, mashtroje dikë tjetër. O argjend, largohu nga unë, kërko dikë tjetër.”* Tha kështu sepse e ndjeu shenjën e mashtrimit, që iu shfaq në vete. Sikur të mos e kishte parë provën e Rabbit të vet, edhe do të ishte mashtruar.

⁴³ Ebu Mansur Dejlemi nga Huzejfe.

⁴⁴ Hakimi, dhe është përmendur edhe më herët.

Kjo është pasuria e vërtetë, sepse Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Nuk është pasuria në shumë mall, pasuri e vërtetë është pasuria e shpirtit.” ⁴⁵

Meqenëse varfëria ka më pak angazhim, është më e dëshirueshme se pasuria, edhe nëse ajo pasuri harxhohet në punë të hajrit. Sepse në përgjithësi, kur njerëzit posedojnë pasuri, ndjejnë afërsi me dynjallëkun, kënaqen me posedimin e pasurisë, kënaqen me rehatinë në dynja që pasuria ju ofron, e nuk mund të ndahen lehtë nga kjo.

Të gjitha këto krijojnë afërsi me këtë dynja. Personi, sa i afrohet dynjallëkut aq largohet nga ahireti. Kur ndërpriten sebetet e afërsisë me dynjallëk, edhe zemra largohet nga dynjallëku.

Kur zemra largohet nga gjithçka tjetër përveç Allahut, sepse beson në Allahun, ajo zemër me siguri i drejtohet Allahut. Një zemër plotësisht e zbrazët nuk mund të paramendohet, e as nuk mundet që në një zemër të jetë edhe Allahu edhe diçka tjetër. Ai që i drejtohet diçkaje tjetër, largohet nga Allahu, dhe ai që i drejtohet Allahut, largohet nga gjithçka tjetër.

⁴⁵ Buhari dhe Musli nga Ebu Hurejre. Tashmë është përmendur.

Pranimi i njërës nënkupton zbrazje nga tjetra, afërsia me njërën nënkupton largim nga tjetra. Këto janë të ndara si lindja me perëndimin. Janë dy anë plotësisht të kundërta. Lëvizja mes tyre nënkupton afrim njërës anë dhe largim nga tjetra. Bile, vet afërsia me njërën anë është, në vetvete, largim nga ana tjetër. Dashuria ndaj dynjallëkut nënkupton përbuzje ndaj Allahut Teala. Prandaj, *arifi* duhet të largohet nga dynjallëku dhe të synojë t'i afrohet Allahut.

Do të thotë se përparësia e fukarasë ose të pasurit varet vetëm nga lidhja e zemrave të tyre me këtë botë. Nëse në këtë janë të njëjtë, të njëjta i kanë edhe gradat shpirtërore. Por, këtu është lehtë që njeriu të rrëshqasë e të gabojë. Sepse shumë herë i pasuri mendon se zemra e tij është larguar nga pasuria, ndërsa dashuria për pasuri i është rrënjësuar thellë në zemër dhe ai as nuk e di. Por, kur e humb pasurinë, e kupton se ashtu është.

Prandaj duhet ta sprovosh veten duke ndarë një pjesë nga pasuria ose në rast se i vjedhet pasuria - nëse atëherë e vëren që zemra i është kthyer kah ajo pasuri, do të thotë që ka qenë i mashtruar. Sa ka të tillë që e shesin robërshën duke menduar se nuk e kanë lidhur zemrën për të, dhe vetëm pas dorëzimit të robërshës, fillon të ndizet zjarri i dashurisë, që ka qenë e fshehtë. Atëherë e kupton që ka qenë i mashtruar, dhe që dashuria ka qenë e fshehur në zemrën e tij si prushi nën hi. Kjo është gjendja e të gjithë të pasurve, përpos peygamberëve dhe evliave.

Për shkak se është e vështirë që nga zemra të hiqet dashuria për pasuri, po kuptohet se varfëria është më e mirë dhe më e dobishme për të gjithë, sepse lidhja dhe dashuria e fukarasë me dynjallëkun është më e dobët, dhe sa më e dobët është lidhja, aq më shume shtohet sevapi i ibadeteve dhe tesbihut. Në tesbih kërkohet afërsia me Allahun, e jo lëvizja e gjuhës. Nëse tesbihi i bërë me gjuhë, nuk ndikon në zemër, ajo afërsi nuk realizohet. Prandaj njëri nga gjenerata e parë (*selefi salihin*), ka thënë: *“Ai që bën ibadet por e kërkon dynjallëkun është si ai që përpigjet ta shuajë zjarrin me një shkop, ose ai që me peshk i pastron duart prej yndyrës.”*

Ebu Sulejman Darani ka thënë: *“Një ofshamë e të varfrit për diçka që nuk mund ta merr është më e vlefshme se ibadeti njëvjeçar i të pasurit.”*

Dahhak r.a., ka thënë: *“Kush hyn në pazar dhe sheh diçka që ia dëshiron shpirti por nuk mund ta marrë, dhe pret shpërblimin e kësaj nga Allahu, kjo gjendje e tij është më e vlefshme sesa se sa të harxhojë njëmijë dinarë në rrugë të Allahut.”*

Një person i tha Bishr b. Harisit:

- *Bëj dua për mua, grua dhe fëmija po më shqetësojnë.*

E Bishr i tha:

- Kur gruaja të thotë: *“Nuk kemi as bukë, as miell”, atëherë ti bëj dua për mua, sepse duaja jote është më e vlefshme se e imja.*

Bishr, gjithashtu, ka thënë: *“Abidi i pasur është si një trëndafil në plehërishte, e abidi fukara është sikur qaforja e arit në qafën një gruaje të bukur.”*

Selefët kanë refuzuar të dëgjojnë dituri nga të pasurit.

Ebu Bekr es-Siddk r.a., ka thënë: *“Allahu im, më dhuro pendim, dhe më dhuro risk aq sa më duhet.”*

Kur një person si Ebu Bekr es-Siddk r.a., i cili arriti majën e përsosurisë, ka frikë nga dynjallëku, si atëherë dyshohet në atë se varfëria është më e mirë? Nga ana tjetër, gjendja më e mirë e të pasurit është që të fitojë pasuri hallall, dhe ta harxhojë në vende të mira. E prapë dhënia e llogarisë në ditën e gjykimit do t'i jetë e gjatë dhe gjatë do të presë, e edhe nëse e kalon llogarinë e diskutueshme, dënohet. Prandaj Abdurrahman ibn Avf do të hyjë më vonë në xhennet, sepse do të jetë i zënë me dhënie të llogarisë. Për këtë arsye, Ebu Derda ka thënë: *“Nuk do të doja ta kem dyqanin afër xhamisë, edhe nëse pesë vektet i faji në xhami, e edhe nëse për çdo ditë i fitoj nga pesëdhjetë dinarë e të gjitha t'i harxhoj në rrugë të Allahut.”* Dikush e pyeti:

- Çfarë ka të keqe në këtë?, e Ebu Derda u përgjigj:
- Vështirësia e dhënies së llogarisë.

Prandaj Sufjani ka thënë: *"Fukaratë preferuan tri gjëra, e edhe të pasurit preferuan tri gjëra. Fukaratë preferuan rehatinë, zemër të qetësuar dhe lehtësinë e llogarisë. Të pasurit preferuan lodhjen, zemër të ngarkuar dhe vështirësinë e llogarisë."*

Ajo që e ka thënë Ibn Atta, se pasuria është një prej cilësive të Hakkut, e që për këtë është më e vlefshme, kjo është e drejtë, por robi duhet të jetë i pasur në atë mënyrë që nuk e intereson as posedinmi as mosposedimi i pasurisë, dhe që këto të dyja i janë të njëjta. Kur njeriu është i pasur, ai do të ketë nevojë për vazhdimësinë e asaj pasurie, e një pasuri e tillë nuk është si pasuria e Allahut, i Cili është i pasur vetvetiu, jo me pasuri që mund të zhduket. Provat e paraqitura kundër Ibn Atta janë se pasuria e Allahut nuk është e përkohshme.

Kjo dëshmi është gjithashtu një provë e shëndetshme kundër një personi të pasur që dëshiron që prona t'i mbetet përgjithmonë. E pohimi se cilësitë e Allahut nuk mund t'i përshkruhen robit – nuk është i vërtetë. Për shembull, dituria (*ilm*) është një prej cilësive të Allahut, dhe është një prej cilësive më të vlefshme për robin. Në fakt, për robin është arritje në shkallën më të lartë të suksesit nëse stoliset me cilësi të Allahut Teala.

E kam dëgjuar një shejh duke thënë: *“Salikut, në rrugë drejt Allahut Teala, para se ta kalojë të gjithë rrugën, nëntëdhjetë e nëntë Emrat (e Bukur) të Allahut i bëhen cilësi të tij, do me thënë, merr hise nga secili Emër i Allahut.*

Cilësia e madhështisë nuk është për robin. Madhështia e atyre që e meritojnë, për shembull e besimtarit ndaj jobesimtarit, dijetarit ndaj injorantit, të nënshtruarit ndaj kryengritësit - është e drejtë, mirëpo, nganjëherë me *madhështi* mendohet në mburrje, mendjemadhësi, lavdërim e pamëshirë, e këto nuk janë cilësi të Allahut Teala.

Cilësi e Allahut është më i larti (*ekber*) se gjithçka tjetër dhe që dihet se është i tillë. Ndërsa Robi është urdhëruar ta kërkojë gradën më të lartë, nëse mund ta arrijë, por që vërtetë ta meritojë, jo me gënjeshtër e mashtrim.

Detyrë e robit është njohja që besimtari është më i lartë se pabesimtari; që i nënshtruari është më i lartë se kryengritësi, dijetari më i lartë se i padituri, njeriu më i lartë se kafsha, bimët e mineralet, dhe që është më afër Allahut Teala se ata. Nëse robi i sheh këto cilësi në vete, cilësia e madhështisë është realizuar për robin, dhe është cilësi e përshtatshme për të. Kjo është edhe virtyt për të. Por ai nuk di këtë. Sepse është i lidhur për frymën e fundit, e nuk e di se çfarë do të ndodhë atëherë.

Prandaj nuk duhet të jetë i bindur se ai është më i lartë se pabesimtari. Sepse ka mundësi që pabesimtari të vdesë me iman (besim), e ai të vdesë në kufër (pabesim). Pasi nuk e di përfundimin, madhështia nuk i përshtatet.

Kur di diçka ashtu siç është, ajo dituri është një përsosmëri për robin, sepse kjo është nga cilësitë e Allahut. Por njohja e gjërave që i sjellin dëm, ajo dituri është mangësi për të. Sepse dituria që dëmton nuk është cilësi e Allahut Teala.

Njohja e çështjeve në të cilat nuk ka dëm për njohësin, kjo është ajo njohje e robit për të cilën mund të thuhet se është një prej cilësive të Allahut Teala dhe është shkalla e fundit e virtytit. Nuk ka kurrfarë dyshimi që kjo është kulmi i vlerave, e që është virtyti i pejgamberëve, evliave dhe dijetarëve.

Do të thotë, nëse për një të pasur edhe posedimi dhe mos-posedimi i pasurisë është i njëjtë, kjo është virtyti tek njeriu nga pikëpamja që *i pasur* është cilësi e Allahut. Por, tek ai që është i pasur vetëm pse posedon pasuri, aty nuk ka kurrfarë virtyti.

Ky është shpjegimi i gjendjes së fukarasë që mjaftohet me pak dhe pasanikut falënderues.

Rasti i dytë është grada mes fukarasë lakmitar dhe pasanikut lakmitar. Le ta shqyrtojmë këtë në një person të vetëm; supozojmë se një person kërkon pasuri. Ai bën përpjekje të madhe për ta fituar, pastaj e humbë, pastaj prapë e gjen.

Tani, a është më e vlefshme gjendja e këtij personi kur e humbi pasurinë apo gjendja e tij kur e gjeti prapë?

Unë do të them: *“varet”*. Nëse është kërkim për pasuri për të plotësuar nevojat e domosdoshme në jetë, e qëllim e ka që me atë pasuri të ndjekë rrugën e fesë, atëherë posedimi i pasurisë është më i vlefshëm. Varfëria e preokupon njeriun, sepse deri sa të sigurojë për jetesë nuk do të mund të mendojë e të bëjë dhikr, përpos aq sa ai preokupim lejon. Ai që posedon aq sa i nevojitet, ai mund të mendojë e të bëjë dhikr. Prandaj Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“O Allahu im, bëje të jetë i mjaftueshëm risku i familjes së Muhammedit.”

Gjithashtu ka thënë:

“Varfëria gati se është mosbesim.”

E nëse kërkimi i pasurisë i tjekalon nevojat, ose qëllimin nuk e ka që me atë pasuri të ndjek rrugën e fesë, atëherë gjendja e varfërisë është më me vlerë.

Sepse edhe ai që ka pasuri edhe ai që nuk ka janë të njëjtë në lakmi dhe në dashuri ndaj pasurisë, dhe të njëjtë në atë që asnjëri prej tyre nuk po e dëshiron pasurinë që me pasuri të ndihmohet në fe; dhe janë të njëjtë në atë që asnjëri prej tyre nuk e kundërshton kryengritjen e vet për shkak të varfërisë ose pasurisë së vet.

Nga ana tjetër, që të dy janë fukara, që të dy janë në nevojë, sepse ai që do të fitonte pasuri do të ndjente afërsi ndaj pasurisë. Dashuria në zemër ndaj pasurisë do t'i forcohej edhe më shumë dhe do të ndjehej rehat me dynjallëk. Për të, në skamje, dynjallëku është si burg nga i cili ky dëshiron të çlirohet. Kur dy persona që kanë jetuar në kushte të njëjta e lëshojnë dynjallëkun, ai që ka qenë më i lidhur për këtë botë do ta ketë, pa dyshim, gjendjen më të vështirë, meqenëse zemrën e vet e ka kthyer kah dynjallëku. Zemra do t'i tjetërsohet nga bota tjetër në atë masë në të cilën është lidhur me këtë botë. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ruhu’l-Kudus (Xhebraili) më fryu në zemër (njohurinë): Dashuro çfarë të duash, në fund do të ndahesh.”⁴⁶

Ky hadith i Resulallahut s.a.v.s., tërheq vëmendjen për secilin se ndarja nga ajo që dashurohet është e vështirë. Prandaj më mirë ta duash Atë nga i cili kurrë nuk do të ndahesh, e ky është Allahu Teala, e mos e duaj atë prej së cilës domosdo do të ndahesh, e kjo është dynjallëku.

⁴⁶ Hadithi tashmë është përmendur.

Sepse kur e dashuron këtë botë, je duke përbuzë takimin me Allahun Teala, prandaj vdekja të është e urryer, si edhe ndarja nga ajo çfarë dashuron, dhe të është e urryer gjithçka që të ndanë nga ajo që ti e dashuron. Për njeriun, ndarja nga diçka është pengesë në atë masë sa ndjen dashuri dhe afërsi ndaj asaj. Prandaj afërsia me dynjallëk e atij që posedon pasuri, dhe që ka mundësi ta posedojë, është më e madhe se afërsia me këtë botë e atij që nuk ka pasuri, edhe nëse atë pasuri edhe ky e dëshiron.

Nga kjo nxjerret përfundimi se varfëria është më e nderhme, më me vlerë dhe më e mirë për të gjithë njerëzit, përpos në dy situata;

Situata e parë është sikur pasuria e Ajshes, r.anha, për të cilën ishte krejt njëjtë se a ka pasuri apo jo; ndoshta pasuria është më dobishme sepse në saje të pasurisë përfiton nga lutjet e të varfërve dhe nevojtarëve.

Situata e dytë është nevoja që tejkalon sasinë e domosdoshëm. Kjo nevojë është diçka e rrezikshme që njeriun e çon në mosbesim. Por, nëse është i qëndrueshëm dhe lufton kundër mosbesimit, nuk bën shumë dëm. Nëse vdes i uritur, gjynahet do të jenë më të pakëta. Prandaj më mirë e ka të vdesë i uritur, pa bërë më shumë gjynah e pa devijuar në kryengritje.

Pra, ky është shpjegimi i detajuar për pasurinë dhe varfërinë.

Tani mbeti të shpjegohet çështja e fukarasë i cili ndjek dynjallëkun me lakmi, nuk mendon për asgjë tjetër përveç dynjallëkut, dhe e pasanikut i cili e ruan pasurinë që e posedon, por nuk është i dhënë pas pasurisë si fukaraja, dhe nëse e humb, nuk ndjen aq dhembje sa fukaraja për shkak të varfërisë së tij. E cili është më i vlefshëm, është e dyshimtë. Më e drejtë është të thuhet se ai që ndjen më shumë dhimbje për pasurinë e humbur është më larg nga Allahu Teala dhe ia që ndjen më pak dhimbje është më afër. E Allahu e di të vërtetën.

EDEBI I FUKARASË NË VARFËRI

Dije se janë disa edepe të cilave duhet t'i përshtatet fukaraja, në të brenshme (batin), të jashme (zahir), në sjellje me njerëzit dhe në veprimet e veta.

Edeb i brendshëm është të mos e përbuzë varfërinë me të cilën Allahu Teala e sprovon. Përndryshe mund edhe të mos i pëlqejë varfëria. Sikur një person që bëhet operacion; nuk i pëlqen operacioni për shkak të dhimbjes, por nuk e përbuzë personin që e operon, bile e falënderon. Kjo është grada më e ultë e edebit, dhe fukaraja është i obligueshëm t'i përshtatet kësaj. Ky është kuptimi i fjalëve të Resulallahut, s.a.v.s.:

“O xhemati fukara, të jeni me zemër të kënaqur prej Allahut që ta merrni sevapin e varfërisë. Përndryshe nuk merrni.”

E gradë edhe më e lartë është që ta preferojë varfërinë, t'i gëzohet asaj, sepse i njeh telashet e pasanikut, dhe t'i mbështetet Allahut. Ta dijë se Allahu do t'ia japë riskun e nevojshëm, si dhe të përbuzë gjithçka që e tejkalon sasinë e mjaftueshme. Alia, r.a., ka thënë: *“Me siguri, Allahu Talala për fukaranë ka disa ndëshkime dhe disa shpërblime. Shenja e fukarallëkut që do të shpërblehet është që fukaraja ta zbukurojë ahlakun e vet, që në fukarallëk t'i jetë i nënshtruar Rabbit të vet, të mos ankohet për gjendjen e*

vet, ta falënderojë Allahun për varfërinë e vet. E shenjë e fukarallëkut që do të ndëshkohet është përkeqësimi i ahlakut të tij në varfëri, kryengritja ndaj Rabbit të vet (duke braktisë ibadetin), ankesat për gjendjen e vet dhe kundërshtimi i caktimit të Allahut.”

Domethënë që nuk lavdërohet gjendja e secilit fukara. I lavdëruar është vetëm ai fukara i cili nuk e kundërshton caktimin e Allahut, që është i kënaqur, që i gëzohet varfërisë dhe është i kënaqur me të. Sepse është thënë: *“Kur i jepet diçka robit nga dynjallëku, i thuhet: “Merre këtë me tri gjëra; me preokupim me të, shqetësim prej saj dhe llogari të gjatë për të.”*

Sa për edebin e jashtëm, duhet të ketë sjellje të ndershme, të mos tregojë skamjen dhe të mos ankohet për varfërinë. Në një hadith thuhet:

“Allahu Teala e do fukaranë e ndershëm, që ka familje.”

Allahu Teala thotë:

“Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin.” 2-Bekare: 273

Sufjan Sevri ka thënë: *“Vepra më e vlefshme është të mos tregohet vështirësia.”*

Një person tjetër ka thënë: *“Fshehja e varfërisë është nga thesaret e mirësisë!”*

Edebi në sjellje me njerëzit duhet të jetë i tillë që të mos tregojë përulje para pasanikut për shkak të pasurisë së tij, por që para tij të jetë krenar. Hazreti Alia r.a., ka thënë: *“Sa e bukur është përulja e pasanikut para të varfrit, me dëshirën për të fituar sevap nga Allahu Teala. E edhe më e bukur se kjo është sjellja e të varfrit me krenari para pasanikut duke u mbështetur në Allahun Teala.”*

Kjo është gradë e lartë. Më ultë se kjo është të mos shoqërohet me pasanikë, të mos ketë dëshirë që të ulet me ta, sepse kjo paraqet një nga fillimet e lakmisë.

Sufjan Sevri ka thënë: *“Kur fukaraja shoqërohet me të pasurit, dije se ai është dyfytirësh. E kur shoqërohet me sundimtarët, dije se është hajdut.”*

Një arif ka thënë: *“Kur fukaraja shoqërohet me të pasurit, i dobësohet lidhja me varfërinë. Kur dëshiron gjendjen e tyre, e humb ndershmërinë. E kur rri mes tyre dhe gjen qetësi, veç ka devijuar.”*

Kurrsesi nuk guxon ta heshtë të drejtën për t'i kënaqë të pasurit, me dëshirë që të përfitojë nga ta.

Edebi i veprimit është të mos i braktisë ibadetet për shkak të varfërisë, dhe të mos braktisë dhurimin, qoftë edhe i një pjese krejt të vogël të pasurisë që ka, sepse ajo është koprraci. Vlera e dhurimit të tij është më e madhe se vlera e dhurimit nga prona e shumtë, siç dhurojnë të pasurit.

Zejd ibn Eslem tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Një dërhëm sadaka është më me vlerë te Allahu Teala se njëqindmijë dërhëmë.”

Një as’hab e pyeti:

- *Si bën kështu, o Resulallah?*;

e u përgjigj:

- *Dikush nga prona e vet ndanë njëqindmijë dërhëmë dhe i jep për sadaka. E tjetri, nga dy dërhëmët e tij - të vetmit që i ka – e ndanë njërin, me kënaqësi. Kështu, ai që e ka dhënë një dërhëm bëhet më me vlerë se ai që i ka dhënë njëqindmijë dërhëmë.*⁴⁷

Njeriu nuk duhet të grumbullojë pasuri, por të mbajë vetëm aq sa ka nevojë e pjesën tjetër ta japë. E grumbullimi i pasurisë i ka tri grada:

⁴⁷ Nesai, nga Ebu Hurejre, si transmetim me zinxhir të pandarë të transmetuesve (*muttesil*). Është përmendur në Librin për zekatin.

Grada e parë është të mbledhë ushqim sa i duhet për 24 orë, e kjo është grada e siddikëve;

Grada e dytë është të mbledhë pasuri aq sa i duhet për katërdhjetë ditë, e më shumë se kaq është vetëm për qejf. Dijetarët këtë periudhë katërdhjetë ditore e kuptojnë në bazë të premtimit të Allahut Teala dhënë Musasë, a.s., dhe konsiderojnë që lejohet të dëshirohet jetë për katërdhjetë ditë. Kjo është grada e të devotshmëve (*muttakin*).

Grada e tretë është grumbullimi i pasurisë aq sa nevojitet për një vit. Kjo është grada më e ulët, grada e të mirëve (*salih*). Kush nuk e mbërrinë as këtë gradë, ka rënë në masën e njerze të rëndomtë (*avama*) dhe ka dalë nga grupi i të zgjedhurve.

Robi i mirë (*salih*), që është në gradë të ulët, është rehat nëse ka furnizim për një vit, robi i zgjedhur (*havas*) është rehat nëse ka furnizim për katërdhjetë ditë, e i zgjedhuri mes të zgjedhurve (*havassu'l-havass*) nëse ka furnizim për 24 orë. Resulallahu, s.a.v.s., ju ndante grave të veta pasuri ashtu që disave ju jepte furnizim për një vit, e disave për katërdhjetë ditë. E furnizimi i Ajshes r.anha ishte për 24 orë.

DETYRA E FUKARASË KUR I DHUROHET DIÇKA, E NUK KA KËRKUAR

Fukaraja duhet të mendojë për tri gjëra kur bëhet fjalë për dhuratën që i ofrohet: për dhuratën, për arsyen e dhuruesit dhe për arsyen e vet – pse po e pranon.

Sa për dhuratën, ai duhet të jetë hallall, që për këtë të mos ketë kurrfarë dyshimi. Po të kishte edhe pak dyshim, fukaraja duhet të ruhet mirë e të mos e pranojë. Në librin për hallallin dhe haramin i kemi shpjeguar gradat e dyshimit.

Arsyeja e dhuruesit është ose për ta gëzuar pranuesin dhe për të përfituar dashurinë e tij, e kjo quhet *'hedije'* (dhuratë), ose është për sevap, e atëherë bëhet fjalë për *sadaka e zekat*, ose është dyfytirësi e vet-lavdërim, ose është për disa qëllime.

E para është dhurata. Nuk ka asgjë të keqe që ajo të pranohet. Pranimi i dhuratës është sunnet i Resulallahut, s.a.v.s.. Por, ai që e pranon dhuratën nuk duhet ta llogarisë veten si borxhli; në aso rasti më mirë është ta refuzojë dhuratën. Nëse e kupton se dhurata që i ofrohet në një pjesë ka erë borxhi, në tjetrën nuk ka, atëherë atë pjesë me erë borxhi e refuzon.

Resulallahut, s.a.v.s., si dhuratë i është dhënë gjalpë, djathë dhe dash. E ka pranuar gjalpën e djathin, por e ka refuzuar dashin.⁴⁸ Resulallahu, s.a.v.s., i pranonte dhuratat nga disa njerëz, e nga të tjerët jo, dhe ka thënë:

“Kam vendos të pranoj dhurata vetëm nga fisi Kurejsh, Sekafi, Ansari dhe Dusi.”⁴⁹

Kështu ka vepruar shumica nga taibinët dhe nuk kanë pranuar dhurata nga gjithkush. Kur Fet’hul Musilit i mbërrijti një bohçe ku kishte pesdhjetë dërhëmë, e ai tha:

“Atta na ka përcjellë se Muhammedi, a.s., ka thënë:

- Kujt i arrin furnizimi, që nuk e ka kërkuar, e ky e refuzon, është sikur ta ketë refuzuar Allahun.”⁵⁰

Më pas e mori bohçen, e morri prej aty një dërhëm, e të tjerat i ktheu.

⁴⁸ Ahmedi, nga Ja’la ibn Murra ku thuhet: *“Ju dhuruan dy deshë, pak gjalpë e djathë, e Resulallahu, s.a.v.s., tha: ‘Merre djathin, gjalpën dhe njërin dash, e tjetrin ktheje’.”* Zinxhiri i hadithit është i mirë (xhejjid). Vekiu thotë se hadithin e përcjellë Murra, nga Ja’la ibn Murra, e ai nga i ati.

⁴⁹ Tirmidhi, nga Ebu Hurejre, dhe thotë që ekziston edhe një zinxhir tjetër i transmetuesve, gjithashtu nga Ebu Hurejre. Transmetuesit e këtij versioni janë posaçërisht të besueshëm (*sikat*).

⁵⁰ Zinxhirin mursel, përmes Atasë. Ahmedi, Evu Ja’la dhe Taberani, me zinxhir të mirë të transmetuesve (*xhejjid*), transmetojnë nga Halid ibn Adijj Xhuheni. Ahmedi dhe Ebu Davd shënojnë hadithin nga Ebu Hurejre. Në Sahihët e Buhariut dhe Muslimit gjendet i shënuar edhe hadithi nga Omeri, r.a..

Edhe Hasan Basriu ka transmetuar të njëjtin hadith, por kur një person ia dhuroi atij një torbë dhe një bohçe nga pëlhura e butë e Horasanit, këtë e refuzoi, duke thënë:

“Kush është ulr këtu me mua, e pranon nga njerëzit diçka të këtillë, do të takohet me Allahun Teala në Ditën e gjykimit pa fitim.”

Kjo tregon se kushtet e pranimi të dhuratës për dijetarin e vaizin janë më të vështira. Megjithatë, Hasan Basri i pranonte dhuratat nga miqtë.

Ibrahim Tejmi, kohë pas kohe kërkonte nga shoki i tij një dërrhem ose dy, e të tjerët i dhuronin edhe nga njëqind dërrhemë, por ato i refuzonte. Njëri prej taibinëve, kur miku i vet i dhuronte diçka, thoshte: *“Le të rrijë me ty, e mendo – nëse pas pranimi në zemrën tënde unë do të jem më i rëndësishëm se para pranimi të saj, më trego, e do ta pranoj. Në të kundërtën, jo.”* Qëllim i kësaj është që miku të jetë i kënaqur me pranimin e dhuratës, e me refuzim, i’a prish qejfin.

Nëse personi e kupton se në dhuratën që i ofrohet ka erë borxhi, marrja e dhuratës është e lejuar (*mubah*). Megjithatë, për fukaratë e sinqertë kjo do të ishte e papëlqyer (*mekruh*).

Bishr Ibn Haris ka thënë: *“Nga askush nuk kam kërkuar asgjë, përpos nga Serijj Sekati. Sepse e dija që ai nuk është i lidhur për dynjallëk dhe kur ka - gëzohet të japë dhe mërzitet nëse diçka i mbetet, prandaj duke kërkuar prej tij, i ndihmoj atij në këtë.”*

Një person nga Horasani erdhi te Xhunejd Bagdadi, i solli dhuratë në pará, dhe e luti që t'i harxhojë në ushqim.

- *Shpërndaju të varfërve;* i tha Xhunejdi, e personi tha:

- *Jo, nuk dua, dua që ti të hash nga kjo;* e Xhunejdi i tha:

- *E sa do të jetoj unë që të mund t'i ha të gjitha këto?*

Personi nga Horasani u përgjigj:

- *Unë nuk dua që paratë t'i harxhoj në uthull e sallatë, por në gjellë me mish dhe ëmbëlsira.* Xhunejdi, atëherë i pranoi paratë nga ai.⁵¹ Personi nga Horasani i tha:

- *Nuk kam takuar në Bagdad person më bujar se ti, e në këtë Xhunejdi r.a., i tha:*

- *Dhuratat mund të pranohen vetëm nga njerëzit si ti.*

Arsyeja e dytë e dhuruesit mund të jetë që qëllim ka vetëm sevapin, e atëherë bëhet fjalë për sadaka ose zekat. Por personi të cilit i jepet zekati duhet të mendojë se a e meriton zekatin. Nëse nuk është i sigurtë, bëhet fjalë për dyshim. Më detajisht për këtë kemi shpjeguar në *Librin për fshehtësitë e zekatit*.

⁵¹ Sepse e njohu sinqeritetin e personit nga Horasani.

Nëse është sadaka të cilën dikush ia jep për shkak të fesë së tij, e ky që pranon ka ndonjë të metë të fshehur, ky duhet ta kontrollojë veten; nëse personi që ia jep këtë sadaka do ta dinte për gjendjen e tij do ta urrente dhe assesi nuk do t'i jepte sadaka, ky e ka të ndaluar (*haram*) ta pranojë atë sadaka.

Gjithashtu, nëse dhuruesi do ta ofronte sadakanë duke menduar se personi të cilit po ia jep sadakanë është ndonjë dijetar (*alim*) ose sejjid, për atë person do të ishte haram i pastër ta pranojë sadakanë, dhe në këtë nuk ka kurrfarë dyshimi.

Arsyeja e tretë e dhuruesit mund të jetë vetëlavdërimi, dyfytërsia dhe reputacioni. Pranuesi duhet të refuzojë qëllim të këtillë të keq dhe të mos e pranojë dhuratën, sepse me pranim e ndihmon atë që jep në qëllimin e tij të keq. Sufjan Sevri refuzonte kur i dhurohej diçka, duke thënë: *“Sikur ta dija se dhuruesi nuk do të lavdërohej me këtë, do ta pranoja.”*

Një person që u qortua sepse refuzoi një bohçe që iu ofrua, tha: *“E refuzova dhuratën e tyre nga mëshira ndaj tyre, dhe për të nxjerrë mësim, sepse ata gjithmonë i përmendin dhuratat dhe kanë dëshirë që kjo të dihet. Në atë mënyrë mbesin edhe pa pasuri edhe pa shpërblimin për dhurimin e saj.”*

E për pranimin e dhuratës për disa qëllime, personi duhet të mendojë: a i nevojitet ajo dhuratë, a i është nevojë e domosdoshme, ose jo. Nëse ajo që i dhurohet me të vërtetë i nevojitet, atëherë nuk ka dyshime në dhuratë dhe është i sigurtë nga pasojat e këqija që i përmendëm kur folëm për dhuruesin. Në atë rast më mirë e ka ta marrë dhuratën. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Ai që dhuron sepse ka me bollëk nuk do të ketë shpërblim më të madh se ai që e pranon atë dhuratë dhe ka nevojë për të.”⁵²

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Kujt i dhurohet diçka e ai nuk e ka kërkuar, as nuk e ka menduar, ajo është një risk që ia dërgon Allahu Teala”⁵³,

e në version tjetër: **“...le të mos e refuzojë.”**

Një nga dijetarët ka thënë: *“Kujt i dhurohet diçka, e ai nuk e pranon, është sikur t’i jetë kërkuar diçka, e ai nuk e jep.”*

Serijus Sekati i ofroi diçka imam Ahmed Hanbelisë, por ai e refuzoi. Serijus Sakati i tha:

- *O Ahmed, ruaju nga pasojat e këqija të refuzimit. Ajo është më e rëndë se pasojat e këqija të pranimit. Ahmedi i tha:*

⁵² Taberani nga Ibn Omeri.

⁵³ Është përmendur më herët.

- *Përsërite atë që më the!*; e Serijjuss Sakati ia përsëriti, e imam Ahmedi tha:

- *Të refuzova sepse tashmë kam furnizim për një muaj. Mbaje atë që është për mua tek ti, e nëse e mbërrij edhe muajin tjetër, atëherë ma dërgon.*

Një dijetar ka thënë: *“Nëse personit vërtetë i duhet dhurata por e refuzon, ai ka ndonjë frikë të arsyeshme; frikësohet se do të sprovohet me të këqijat e lakmisë ose me futje në të dyshimtën.”*

E tash, nëse ajo që i dhurohet dikujt është më shumë se nevoja e tij, ky person ka dy gjendje; është i angazhuar vetëm për veten, ose për shkak të dhembshurisë dhe bujarisë në natyrën e tij mendon për të varfrit dhe angazhohet për ta. Nëse mendon vetëm për veten e tij dhe nëse është udhëtar i ahiretit, pranimi i dhuratës nuk mundet kurrsesi të arsyetohet. Sepse pranimi i asaj për të cilën nuk ka nevojë është nënshtrim dëshirës së egos (nefsit). Çdo vepër që nuk është për Allahun është për shejtanin, ose është në rrugën e shejtanit, e kush luan me zjarr, lehtë ndodhë që në të djeget. Personi si ky mund t'i ketë dy gjendje:

Gjendja e parë është që haptas e pranon dhuratën, e fshehtas ia kthen pronarit ose ua shpërndanë të varfërve. Kjo është grada e të singertëve (*siddikun*).

Për nefsin kjo është e rëndë. Këtë e duron vetëm personi i cili e edukon nefsin duke ia kundërshtuar dëshirat dhe arrin në gradën *nefsi mutmainne* (nefs i qetësuar).

Gjendja e dytë është që ta refuzojë, kurrsesi të mos e marrë dhuratën, që dhuruesi atë t’ia japë dikujt që ka më shumë nevojë, ose edhe e pranon, por ia dorëzon dikujt që ka më shumë nevojë se ai. Të dyja mund t’i bëjë fshehtas ose haptas. Se cila është më e vlefshme, kemi folë në *Librin për të fshehtat e zeqatit*, kur folëm për të varfrin në përgjithësi, prandaj kujt t’i interesojë le të shikojë atje.

Ndërsa refuzimi i Ahmed Hanbelisë që të pranojë dhuratën nga Serijjus Sakati ishte për faktin se Ahmedi atëherë nuk kishte nevojë, sepse kishte furnizim për një muaj. E nuk ishte në disponim që ta marrë dhuratën e më pas t’ia dorëzojë dikujt tjetër, sepse aty ka rrezik. Personi i devotshëm është i kujdesshëm sepse mendon për rreziqet dhe për atë se mos është kjo ndonjë mashtrim i shejtanit. Një person që u tërhoq në Meke për ibadet, ka treguar:

“I kisha disa dërhëmë, i kam ruajtur t’ju jap të varfërve. Atëherë e dëgjova një fukara, i cili sapo përfundoi tavvafin, me zë të ulët tha:

- O Rabb, jam i uritur, siç po e sheh, e i paveshur, siç po e sheh. Çfarë po mendon për këtë gjendje që po e sheh? O Ti i Cili sheh, e të Cilin askush nuk e sheh!;

E shikova atë person, më të vërtetë ishte në gjendje të mjerueshme, gati sa i shihej trupi nga veshja e grisur. Thashë me vete: “Nuk mund të ketë më nevojtar se ky”; dhe ia dhashë paratë. Ai i shikoi paratë, i mori pesë dërhëmë, dhe tha:

- Katër dërhëmë është çmimi i rrobave, e një dërhëm e harxhoj për ushqim tri herë në ditë. Të tjerat s’më duhen; dhe m’i ktheu. Të nesërmen e pashë të njëjtin person, në të njëjtin vend, në të njëjtën orë, e i kishte veshur rrobat e reja. Më lindi një dyshim ndaj tij. Ai u kthye kah unë, më kapi për dore, dhe bëri bashkë me mua tavvafin, shtatë herë. Duke u rrutulluar, këmbët tona u zhytën deri në zog të këmbës në ari, perla dhe diamantë, e të tjerët nuk panë asgjë nga këto. Ky më tha:

- Rabbi im m’i dhuroi këto, por unë nuk i pranova, sepse e di që këto janë fitne dhe sprovë, e unë e marr riskun tim nga duart e njerëzve. Sepse aty ka rahmet dhe bereqet.

Qëllimi ynë këtu është të shpjegojmë se gjithçka që ju vjen më shumë se që keni nevojë, është sprovë për ju. Ndërsa sasia që ju nevojitet, ju vjen si dhembshuri. Tash, mendo dallimin midis dhembshurisë dhe sprovës! Allahu Teala thotë:

“Gjithçka që është mbi tokë, Ne e bëmë stoli të saj, për t’i provuar ata, se cili prej tyre do të jetë më vepërmirë.” 18-Kehf: 7

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“I biri i Ademit ka të drejtë (*hakk*) vetëm në tri raste: në ushqim – që të mund të drejtohet, në rroba – që me to t’i mbulojë pjesët e turpshme (*avret*), dhe në shtëpi – që të mund të strehohet. Për gjithçka përtej kësaj do të jepet llogari.”⁵⁴

Pra, nëse merr vetëm aq sa të duhet, nga këto të trija, do të kesh shpërblim. Për gjithçka përtej kësaj, nëse nuk ke qenë kryengritës ndaj Allahut Teala, duhet të jepet llogari. E nëse ke qenë kryengritës ndaj Allahut, do të jesh i ekspozuar dënimit.

Vendosmëria për t’u larguar nga kënaqësitë e dynjasë duke kundërshtuar dëshirat e nefsit, e me qëllim që t’i afroresh Allahut, është gjithashtu një sprovë. Sepse nëse kënaqen kërkesat e ulëta të nefsit, kështu dobësohet vendosmëria, dhe personi kthehet kah thyerja e premtimit, dhe atëherë nefsi do t’i kthehet zakoneve të vjetra e pastaj do të jetë tepër vështirë që ai të frenohet. Prandaj është i rëndësishëm refuzimi i kënaqësive të kësaj bote. Kjo quhet *zuhd*. Nëse e pranon dhuratën, dhe ju shpërndanë nevojtarëve, kjo është më e pëlqyeshme dhe është qëllimi i zuhdit, por këtë mund ta arrijë vetëm fuqia e të sinqertëve (*siddikun*).

⁵⁴ Tirmidhi, që e konsideron *sahih*, nga Osman ibn Affan, e ku në vend të fjalës *ushqim* thuhet *në kafshatë të bukës dhe ujë*.

Nëse je zemërgjerë, ke pranuar parimin e disa salihëve që të kujdesesh për gjendjen e të varfërve dhe t'i ushqesh, atëherë prano edhe më shumë se që ke nevojë. Sepse nëse është më shumë se nevoja jote, nuk është më shumë se nevoja e të varfërve. Mos e mbaj, shpërndaje menjëherë. Mos vështirëso! Mbajtja e asaj teprice, qoftë edhe një natë, është sprovë dhe telashe, e ndoshta edhe fillon të t'pëlqejë ideja që t'i mbashë për vete, që do të ishte ngatërresë për ty.

Disa njerëz angazhohen në bërje hizmet të varfërve, e këtë e përdorin vetëm si mënyrë për të shtuar pasurinë e vet e për t'u kënaqur në ushqim e pije, e kjo është shkatërrim. Ai që ka qëllim për të ndihmuar të varfrit për shkak të dhembshurisë, ai mund të marrë borxh para për ta, duke iu mbështetë Allahut, e jo zullumqarit. Nëse Allahu i jep risk nga hallali, ky e paguan borxhin. Nëse vdes para se të paguajë, Allahu bëhet ndihmësi i tij. Por kur hyn në një borxh të tillë, është e nevojshme të informohet personi për gjendjen. Nuk guxon t'i gënjejë e t'i mashtrojë huadhënësit me premtime, por duhet t'ua tregojë gjendjen e vet, që ata ta kenë plotësisht të qartë për çfarë ky dëshiron ta marrë atë hua. Atëherë borxhi i personit të këtillë duhet të paguhet nga arka shtetërore (*bejtul-mal*). Allahu Teala thotë:

“...ai që është ngusht nga pasuria, le të japë nga ajo që i ka dhënë Allahu.” 65-Talak: 7

Kuptimi i këti ajeti është që personi të shesë një pjesë të rrobave të veta. Të tjerët thanë se kuptimi i kësaj është: *le të marrë borxh në bazë të reputacionit që ka, sepse Allahu ia ka dhënë atë.*

Dikush ka thënë: *“Allahu Teala ka robë që dhurojnë krejt çka kanë. Dhe Allahu Teala ka robë që dhurojnë përshtatshëm mendimeve të tyre më të bukura për Allahun Teala.”*

Një prej këtyre vdiq, e amanet e kishte lënë që pasuria e tij t’ju ndahet tri grupimeve: të fuqishmëve, të xhymertëve dhe të pasurve. Kanë pyetur se kush janë këta njerëz, e dikush është përgjigjur:

- Të fuqishmit janë ata që i mbështeten Allahut (ehlut-tevekkul). Të xhymertë janë ata që i kanë mendimet më të bukura për Allahun Teala (ehlu husniz-zann billah). E të pasurit janë ata që i këputën të gjitha lidhjet që i kishin, përpos lidhjes me Allahun Teala (ehlul-inkita’i).

Prandaj, sa herë që të shohesh këto kushte, në pasuri a në dhurim, prano. Njeriu duhet ta kuptojë që, kur merr diçka, po e merr prej Allahut Teala, jo prej dhuruesit. Dhuruesi është vetëm një mjet. Ai është i detyruar ta japë, për shkak të besimit, vullnetit dhe arsyeve të tjera që Allahu Teala ia dha. Tregohet se një person e ftoi në gosti

Shekik Belhinë, bashkë me pesëdhjetë shokë. Shtroi sofër të pasur, e kur Shekiku u ul, ju tha shokëve:

- Ky mikpritësi ka thënë: *“Kush nuk e pranon që unë përgatita këtë ushqim për t’ju ushqyer juve, ky ushqim është haram për të. Të gjithë menjëherë u ngritën dhe dolën jashtë, përpos një të riu. Mikpritësi e pyeti Shekikun:*

- Pse e bëtë këtë?; e Shekiku tha:

- Doja të bindem se shokët e mi e kanë kuptuar tevhidin.

Musa, a.s., tha:

- O Rabbi im, po e shoh që riskun tim po ma jep me duart e Izraelitëve. Ata ndonjëherë ma japin riskun tim në mbrëmje, ndonjëherë në mëngjes. Allahu Teala atëherë i shpalli Musasë a.s.:

“Unë kështu veproj me miqtë e mi. Ju jap riskun e tyre me duart e robëve të mi kryengritës, që edhe këta të fitojnë savap.”

Prandaj dhuruesi duhet të kuptohet si dikush përmes të cilit Allahu Teala shërben, që ky të meritojë sevap. Allahun Teala e lusim për udhëzimin më të mirë, me të cilin Ai është i kënaqur!

NDALIMI I LYPJES PA NEVOJË TË DOMOSDOSHME DHE SJELLJET E FUKARASË KUR ËSHTË I OBLIGUAR NË KËTË

Së pari duhet ta dimë këtë: është thënë shumë për lypjen, për ndalimin dhe qortimin e këtij veprimi, por është thënë edhe për lehtësim (*ruhsa*) në këtë, meqenëse Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Edhe nëse vjen lypësi mbi kalë, ai e ka të drejtën (hakk) e vet.”⁵⁵

Në një tjetër hadith thuhet:

“Jepni lypësit, edhe nëse është një copë ashti të zier.”⁵⁶

⁵⁵ Ebu Davudi, nga Husejni, r.a., djalit të Alisë, r.a., dhe në një version tjetër nga vet Alia, r.a.. Në zinxhirin e parë të tij gjendet edhe Ja'la ibn Ebu Jahja, për të cilin Ebu Hatimi thotë se është i panjohur, e Ibn Hibban thotë se është shumë i besueshëm (*sika*). Në zinxhirin e dytë gjendet një shejh (plak), emri i të cilit nuk përmendet. Ebu Davud nuk është deklaruar për besueshmëritë e të dy këtyre transmetimeve. Ibn Salah në veprën *Elumul-hadis* shënon këtë hadith nga imam Ahmed ibn Hanbeli, i cili ka thënë: *“Katër hadithe përmenden nëpër pazare, e nuk kanë bazë. Një prej tyre është: Ai që kërkon e ka të drejtën e vet (hakk), qoftë edhe mbi kalë.”* Prandaj, sipas imam Ahmedit ky transmetim nuk është i besueshëm (*sahih*). Por, hadithi është i shënuar edhe në veprën *Musned* nga Husejni, djali i Alisë, r.a..

⁵⁶ Ebu Davud, Tirmidhiu që e vlerëson të besueshëm (*hasenun-sahih*), dhe Nesai, nga Ummu Bexhid.

Nëse lypja e lëmoshës është haram, ndihma ndaj gjynahqarit nuk do të lejohej. Ndërsa dhënia lypësit është ndihmë për të. Është i qartë shpjegimi se lypja e lëmoshës në esencë është haram. Por, mund të jetë e lejueshme (*mubah*) për shkak të domosdoshmërisë reale ose një nevojë të rëndësishme. Por, nëse ka zgjedhje tjetër, atëherë lypja është haram. Ne thamë se lypja e lëmoshës në esencë është haram, sepse ajo nuk mund të shpëtojë nga tri gjëra që janë haram:

E para është se personi me lypje deklaron ankesën e tij për Allahun. Nëse me lypje shfaqet varfëria dhe lypësi e thekson se Allahu Teala nuk i ka dhënë të mira, kjo është ankesë. Siç e ofendon zotërinë e vet skllavi nëse lypë lëmoshë te dikush tjetër, edhe lypja e njerëzve është një veprim i shëmtuar dhe kryengritje kundër Allahut. Pra, kjo është arsyeja pse lypja është haram dhe pse nuk mund të jetë hallall. Por, siç mund të konsumohet mishi i kafshës së ngordhur kur kjo është e domosdoshme, edhe lypja mund të jetë e lejueshme (*xhaiz*) kur ajo është nevojë të domosdoshme.

E dyta është që lypësi e përulë veten para të tjerëve përpos para Allahut Teala. E besimtari nuk guxon ta përulë veten para tjerëve, përpos para Allahut Teala. Sepse ta shohësh veten përulur karshi Rabb-it tënd në fakt është një madhështi për ty.

Krijesat tjera janë robë, të pafuqishëm si ai, e para tyre guxon të përulet vetëm në nevojë të domosdoshme. Sepse në lypje ka përulje karshi atij prej të cilit lypet.

E treta është se në lypje, në të shumtën e rasteve ka mundim ndaj lypësit. Sepse nganjëherë ai që jep nuk dëshiron të japë me kënaqësi, dhe nëse jep nga turpi ose për vetëlavdërim, është haram, edhe për ata që japin, edhe për atë që merr. Nëse refuzon, frikësohet që do të jetë koprrac, e kjo nuk e rehaton. Nëse jep, pasuria i zvogëlohet; nëse nuk jep, i cenohet nderi. Personi do të vuajë në të dy rastet, e shkaktar është lypësi. Mundimi pa nevojë është haram.

Nëse i ke kuptuar këto tri rreziqe, atëherë i kupton edhe fjalët e Resulallahut, s.a.v.s., kur thotë:

“Lypja paraqet neveri, e një neveri nuk e bën neverinë tjetër të lejuar.”⁵⁷

Siç mund të shihet, Resulallahu, s.a.v.s., këtë e quan *neveri*, e është e ditur se neveria lejohet në vështirësi, siç lejohet, për shembull, që personi të pijë verë, nëse i mbetet ushqim në fyt e nuk mund të gjejë ujë. Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush lyp pasi që ka plotësuar nevojën, ai ia shton vetes numrin e gacave të xhehenemit.”⁵⁸

⁵⁷ Nuk është gjetur burimi.

Në transmetim tjetër thuhet:

“Kush lyp edhe pse ka mjaftueshëm, në ditën e kiametit vjen në vendin e mahsherit pa mish në fytyrë dhe eshtrat e fytyrës së tij prekin njëri-tjetrin duke tringëlluar.”⁵⁹

E në transmetim tjetër thuhet: **“...për shkak të lypjeve të tij, në fytyrë bëhet qelb dhe varrë.”**

Këto transmetime tregojnë qartë se lypja është haram. Kur disa njerëz i dhanë bejat Resulallahut, s.a.v.s., se do ta pranojnë islamin, Resulallahu, s.a.v.s., pasi i kushtëzoi me dëgjueshmëri dhe nënshtrim, (itaat), i këshilloi:

“Dhe mos kërkoni nga njerëzit, asgjë.”⁶⁰

Resulallahu, s.a.v.s., shpesh ka urdhëruar largimin nga lypja, duke thënë:

“Kush kërkon nga ne, ne i japim. Kush është i pavarur prej njerëzve, Allahu do ta bëjë të pasur. E ai që agjë nuk na lypë, ai na është më i dashuri.”⁶¹

⁵⁸ Ebu Davud dhe Ibn Hibban, nga Sehl ibn Hanzali, e që është version më i shkurtë i hadithit që u përmend në *Librin për zeqatin*. Muslimi shënon nga Ebu Hurejre. Bezari dhe Taberani shënojnë nga Mesud ibn Omeri. Në zinxhir të këtij transmetimi gjendet edhe një transmetues i dobët (*lejjin*). Buhari dhe Muslimi e shënojnë nga Ibn Omeri, me zinxhir të mirë (*xhejjid*).

⁵⁹ Muslimi, nga Ibn Mesud.

⁶⁰ Muslimi, nga Avf ibn Malik Eshxhei.

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Bëhu i pavarur prej njerëzve! Ai që lyp pak është më i hairit.” As’habët pyetën:

- *Edhe prej teje kush lyp, o Resulallah?*, e ai u përgjigj:

- ***Edhe prej meje.***⁶²

Omeri, r.a., e dëgjoi një lypës si lypte pas akshamit, e i tha njërit prej njerëzve të vet:

- *Jepi diçka.* Ky i dha, por Omeri r.a., e dëgjoi prapë lypësin.

- *A nuk të thashë t’i dhurosh diçka?*, pyeti, e personi i tregoi se tashmë i ka dhënë. Omeri, r.a., shkoi te lypësi dhe ia pa në dorë një sepet plot bukë, e i tha:

- *Ti nuk je lypës, ti je tregtar!* Ia mori sepetin e ju dha deveve që ishin dhuruar në *bejtul-mal* (arkën shtetërore) si zeqat, atë lypësin e goditi me kërbaç, e i tha:

- *Mos u kthe më!*

Po të mos ishte lypja haram, Omeri, r.a., nuk do ta godiste me kërbaç e as nuk do t’ia merrte sepetin. Ndoshta ndonjë fakih i dobët do ta hedhë poshtë këtë veprim të Omerit, r.a., e të thotë:

⁶¹ Ibn Ebu Dun’ja në veprën *el-Kanaa*, dhe Haris ibn Ebu Usama në veprën *Musned*, nga Ebu Seid el-Hudri. Në zinxhirin e transmetuesve (*sened*) gjendet edhe Hasan ibn Hilal, që askush nuk e përmend. Tranmetuesit tjerë janë shumë të besueshëm (*sikat*).

⁶² Bezari dhe Taberani nga Ibn Abbas, me zinxhir të besueshëm të transmetuesve (*sahih*).

- Sa për goditjen, ajo ka rol edukues dhe në sheriat ka ndëshkim nga udhëheqësi (ta'zim), bën pjesë në të drejtat e udhëheqësit (ta'zir), por marrja e sepetit paraqet konfiskim të pasurisë, e në sheriat nuk ka dënim me konfiskim. Si e pa Omeri r.a., këtë si të lejueshme (xhaiz)?

Ai që pyet kështu nuk e njeh mjaftueshëm drejtësinë e sheriatit (*fikh*). Sigurisht që kushdo nuk mund të jetë si Omeri r.a.. Ata nuk mund të kenë dituri si dituria e tij për fshehtësitë e fesë dhe dituri që janë të dobishme për njerëzit. A mendon ti se Omeri, r.a., nuk e ka ditur se konfiskimi i pasurisë nuk është i lejuar, ose e ka ditë por megjithatë e ka konfiskuar? Ose mendon se ai ndoqi një rrugë tjetër nga rruga që ia tregoi pejgamberi. Hasha, s'është asnjëra nga këto. Në këtë çështje, Omeri r.a., e ka parë se personi lypte edhe pse nuk kishte nevojë. Ndërsa kujt i jepte, i jepte me mendimin se me të vërtetë i duhet. Por, ky lypës ishte gënjeshtar dhe nuk ka guxuar të marrë prej të tjerëve duke i mashtruar ata. Omeri, r.a., e ka pasur të vështirë ta përcaktojë saktë se sa i ka dhënë secili, dhe që secilit t'ia kthejë atë që i takon, sepse nuk i ka njohur se kush janë pronarët e asaj prone. Prandaj atë që e gjeti te lypësi mendoi t'ia japë deveve që i janë dhuruar arkës shtetërore si zeqat, që ajo të përdoret për të mirën e përgjithshme.

Nganjëherë lypësi edhe gënjen kur tregon për nevojën e tij, bile edhe thotë *“unë jam sejjid”* ose *“unë jam pasardhësi i Husejnit r.a.”*, e në fakt, gënjen. Prandaj nuk mund të jetë pronar i asaj çfarë merr, sikur në rastin kur, ndonjë dervish që paraqitet si i mirë për ta marrë diçka, e në fakt është gjynahqar, e po të dinte dhuruesi, nuk do t’i jepte asgjë.

Ne kemi shpjeguar në shumë pjesë të këtij libri se kur dikush merr diçka në këtë mënyrë, nuk bëhet pronar i saj, atë e ka haram dhe e ka obligim që t’ia kthejnë pronarit të vërtetë. Për të gjitha këto duhet të jesh në gjendje të dëshmosh me veprimin e Omerit r.a., i cili e ka parë të vërtetën, e jo si njerëzit injorantë që shohin gabim.

Pasi e ke kuptuar se lypja është e lejuar vetëm kur është e domosdoshme, atëherë dije se një person ka nevojë për diçka ose domosdoshmërisht, ose ka nevojë të rëndësishme, ose një nevojë më pak të rëndësishme, ose nuk ka fare nevojë. Këto janë katër gjendjet.

Nevojë e domosdoshme është, për shembull, kërkesa për bukë nga i urituri që ka frikë nga vdekja ose sëmundja, ose kërkesa e personit të zhveshur për veshje.

Pra, personi është i pafuqishëm për ta fituar atë çfarë kërkon.

Nëse ajo çfarë lypësi e kërkon është hallall dhe nëse me lypje nuk e mundon personin prej te cilit kërkon, atëherë lypja e tij është e lejueshme. E për atë që ka mundësi ta sigurojë atë që i duhet, lypja e tij është haram, përpos nëse është i zënë me dituri, e nuk i mbetet kohë për asgjë tjetër.

Kushdo që shkruan nuk lypë, por fiton me laps. E ai që nuk ka nevojë është personi që lyp diçka, e tashmë ka më shumë se sa kërkon. Lypja e tij është kategorikisht haram. Këto dy pikëpamje të përmendura janë të qarta.

Sa i përket nevojës së rëndësishme; lejohet të lypë një i sëmurë nëse ka nevojë për ilaç, ani pse nuk ka rrezik të vdekjes, ose nëse ka një veshje por nuk është e mjaftueshme kundër të ftohtit të dimrit, ose kur lypë për mjet transporti, edhe pse mund të ecë në këmbë por do t'i jetë shumë e vështirë; në këso raste më mirë është të durojë e të mos lypë. Nëse një person i këtille lypë, ai ka braktisur të mirën. Por nëse nuk gënjen kur lypë, lypja e tij nuk mund të konsiderohet e papëlqyer (*mekruh*). Për shembull nëse thotë: *"Nuk kam këmishë nën xhybe. E duroj të ftohtin, por e kam të vështirë, prandaj po lyp."* Nëse është i sinqertë, shpresohet se ky sinqeritet i bëhet shpagesë (*keffara*) për lypjen.

Sa i përket nevojës më pak të rëndësishme; kjo është kur personi ka një këmishë të shqyer, por që të mos shihet kjo kur del para njerëzve, ai lypë për një këmishë të re, ose kur ka bukë, e lypë edhe mëlmesa, ose kur ka mjaft para për qiranë e gomarit, e lypë para për qiranë e kalit.

Kur lypë për këto qëllime, nëse përzien edhe nevoja tjera duke mashtruar, atëherë lypja e tij është haram. Nëse nuk mashtron, ende e ka një nga tri rreziqet: ankesën në mirësitë e Allahut Teala, poshtërimin dhe shqetësimin e atij prej të cilit kërkon. Nëse nuk e ka asnjë nga këto tri rreziqe, atëherë kërkimi lejohet, por megjithatë mbetet i papëlqyer.

Nëse ti pyet se si është e mundur për ta shpëtuar lypjen nga këto rreziqe, dije se ankesa e tij në Allahun largohet me falënderim Allahut, duke qenë i pavarur prej njerëzve dhe duke mos lypë si një lypës nevojtar, dhe thotë: *“Më mjafton kjo që kam, por nefsia im dëshiron që unë të kem më shumë rroba. Kjo e tejkalon nevojën e vërtetë dhe paraqet dëshirë të panevojshme të nefsit.”* Në këtë mënyrë ai shpëton të ankohet në Allahun.

Sa për poshtërimin, prej kësaj mund të shpëtojë nëse lypë nga babai i vet, nga ndonjë farefis i afërm ose shok i sinqertë, tek të cilët nuk i humbë reputacioni nëse lypë, e as nuk do ta urrejnë që lypë, ose lypë nga njerëz bujarë.

E sa për shqetësimin; mënyra për të mos e shqetësuar personin prej të cilit lypet është që të mos lypë nga një person i caktuar dhe ta tregojë nevojën e tij tërthorazi. Pastaj ai që dëshiron të japë, jep me kënaqësi, e ai që nuk dëshiron, nuk jep. Nëse në mesin e njerëzve ka ndonjë person të respektuar, i cili do të qortohej nëse nuk i jep lypësit, lypja publikisht prej tij është gjithashtu shqetësim, sepse i tilli shpesh jep edhe pa dëshirë, duke u frikësuar nga qortimi në shoqëri. Por, nëse ai që lypë megjithatë këtë e bën direkt, nevojën e tij nuk duhet ta bëjë publike. Do të duhej të flasë me alegori, që t'i lejojë atij nga i cili kërkon që të shtiret se nuk po kupton, nëse ai ashtu dëshiron, nëse nuk shtiret se nuk po kupton, përkundër mundësisë së dhënë, atëherë kjo është për shkak të dëshirës së tij të singertë për të dhuruar, dhe nuk është kurrfarë shqetësimi. Të lypet duhet nga dikush i cili nuk turpërohet ta refuzojë ose të bëhet se nuk po kupton, sepse turpi i atij që lypë paraqet shqetësim për atë nga i cili lypet, siq është shqetësim edhe dikush kur jep për tu lavdëruar, e nuk është lypë prej tij.

Nëse ti pyet: *a është hallall apo e dyshimtë ajo që pranohet, duke e ditur që pesoni që jep po turpërohet nga njerëzit, ose për veten e tij*; dije se kjo është plotësisht haram.

Gjykimi për diçka të këtillë është njëjtë si gjykimi për marrjen e pronës së huaj ose konfiskimin, sepse nuk ka dallim në mes të goditjes me thupër të hollë në shpinë dhe goditjes së brendësisë së zemrës me shkopin e turpit dhe frikës nga qortimi publik. Në zemrat e njerëzve të kuptueshëm goditjet e brendshme janë shqetësim më i madh. Nuk lejohet të arsyetohet duke thënë se në të jashtmen e tij dhuruesi ishte i kënaqur që po dhuron. Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Unë gjykoj në të jashtmen (zahir), Allahu e di se çfarë ka në zemër.”⁶³

Kjo ka të bëjë me gjykimet e gjyqtarëve, sepse ata nuk e dinë të brendshmen. Edhe pse gjuha shumë herë është një interpretues i gënjeshtërës, ata gjykojnë në bazë të asaj që thuhet. Ajo që ne po e theksojmë është në lidhje me gjykimin e Allahut. Allahu është gjykatësi më i drejtë. Tek Allahu nuk ka dallim mes gjuhës dhe zemrës. Edhe nëse myftiu ty të jep fetva në çështje të tilla, ti shiko zemrën tënde. Sepse myftiu, kadiu dhe sulltani, mësojnë të gjykojnë sipas botës së dukshme (*alemush-shehada*). E myfti të zemrës janë dijetarët e ahiretit. Me fetvatë e tyre arrihet shpëtimi nga goditja e shkopit të Sulltanit të ahiretit, njëjtë si me fetvatë e kadisë që arrihet shpëtimi nga goditjet me shkopin e sulltanit në dynja.

⁶³ Hadithi nuk është gjetur.

Prandaj, nëse personi merr diçka që pronari nuk e jep me kënaqësi, te Allahu Teala ajo nuk do të jetë pronë e tij. Ai duhet t'ia kthejë atë pronarit të saj. Nëse ka turp ta kthejë, për të shpëtuar nga përgjegjësia, ai duhet t'ia kompenzojë atë që e ka marrë me një dhuratë të vlerës së njëjtë. Nëse dhuruesi nuk e pranon dhuratën e tij, ky duhet që dhuratën t'ia japë ndonjërit prej pasardhësve të dhuruesit. Nëse mbetet në dorën e tij dhe ky e humbë e nuk e paguan vlerën, te Allahu ai është borxhli ndaj dhuruesit, është përgjegjës për shqetësimin që i bëri, është gjytnaqar që ka përdorë atë që e ka marrë.

Nëse thua: *kjo është e vështirë për t'u kuptuar. Shumë herë lypësi mendon se personi prej të cilit lyp jep me pëlqimin e zemrës. Si mund të shpëtohet nga kjo?; unë them se kjo është arsyeja pse të devotshmit nuk lypnin nga njerëzit. Për shembull Bishr el-Hafi ka pranuar vetëm nga Serijju's-Sekati. Thoshte: "E di që ai jep nga zemra. Unë e ndihmoj atë kur marr prej tij."*

Pra, kjo është arsyeja pse lypja është kaq e rëndësishme të kuptohet dhe pse është kaq rreptësisht e ndaluar. Shqetësimi i dikujt mund të arsyetohet vetëm nëse ai që lypë po përballlet me shkatërrim, e nuk ka zgjedhje tjetër, dhe nuk e njeh askënd që do të mund t'i japë diçka me kënaqësi, ose që lypja të mos i jetë shqetësim atij prej kujt lypë.

Vetëm atëherë i lejohet lypja në këtë mënyrë, siç i lejohet në kushte të tilla të hajë edhe mish derri ose kafshën e ngordhur. Prandaj mos-lypja është rruga e të devotshmëve. Në mesin e atyre që i zotëruan zemrat e veta (*erbabul-kulub*) janë edhe ata që ishin syqelë, e me syrin e zemrës (*besira*) i dalluan gjendjet e ndryshme, prandaj prej disave pranonin dhurata, e prej të tjerëve jo.

Disa pranonin dhurata vetëm nga miqtë e tyre të sinqertë. Të tjerë pranojnë një hise të dhuratës, e jo dhuratën e plotë, siç ka vepruar edhe Resulallahu, s.a.v.s., në lidhje me dashin, gjalpën dhe djathin. E edhe kjo në rastin kur dhurata vet ju vjen, e këta nuk e kërkojnë, sepse kjo tregon dëshirën e sinqertë të dhuruesit. Në raste tjera, dëshira e dhuruesit konsiderohet si lakmi, ose krekosje, ose dëshirë për vetëlavdërim e famë, prandaj këta përmbaheshin nga dhuratat e këtilla.

Sa për lypje nga të tjerët, ata do ta shmangnin këtë plotësisht, përveç në dy raste:

a) në rastin e parë bëhet fjalë për nevojë të domosdoshme. Tre pejgamberë, a.s., kanë kërkuar në situatë të nevojës së domosdoshme: Sulejmani, a.s., Musa, a.s., dhe Hizri, a.s.. Nuk ka aspak dyshim që kanë kërkuar vetëm nga ata për të cilët e kanë ditur se me kënaqësi do të japin.

b) Në rastin e dytë, fjala është për kërkimin nga shokët e singertë dhe vëllezërit. Prej tyre bile merrnin edhe pa i pyetur e pa kërkuar lejen, sepse ata që i mbizotëruan zemrat e veta (*erbabul-kulub*) e dinë se kërkohet kënaqësia e zemrës, e jo fjalët e gjuhës. Ata ishin të bindur se vëllezërit e tyre do të ishin të kënaqur duke u dhënë atyre. Kërkonin nga vëllezërit çfarëdo që ju nevojitej, përshtatshëm mundësive, sa herë që ishin në vështirësi; në të kundërtën, përmbaheshin.

Kufiri i lejueshmërisë së lypjes nga tjetri është që ta dish se ai nga i cili po lypë, sikur të dinte për nevojën tënde, do të jepte vet, edhe nëse ti nuk lypë. Atëherë lypja jote do të jetë një lloj njoftimi për gjendjen tënde. Por nuk do të ishte e dëshirueshme të lypet në mënyra mashtruese, që turpërojnë. Në të njëjtën kohë, ai që lypë nuk do të ketë dyshim që dhuruesi po jep me pëlqimin dhe vetëkënaqësinë e tij. Kjo është e kuptueshme nga situata. E për qfarë gjendje bëhet fjalë, ai që lypë do ta kuptojë duke i krahasuar gjendjet. Pranimi në gjendjen e parë është hallall i pastër, derisa pranimi në gjendjen e dytë padyshim që është haram. Mes këtyre dy gjendjeve ka shumë gjendjet të dyshimta, prandaj, duhet të kërkojë fetva nga zemra e vet. Duhet të braktisë gjendjet që shqetësojnë zemrën, sepse ajo është gjynah. Në këtë drejtim, ai duhet ta braktisë atë që e dyshon dhe të marrë atë që nuk ka dyshim.

Krahasimi i këtyre dy gjendjeve është e lehtë për atë i cili e ka forcuar mendjemprehtësinë e vet, e i ka dobësuar lakminë dhe epshin e vet. Ai që e ka lakminë e fortë, e mendjemprehtësinë e dobët, atij do t'i duket se është ashtu si atij i pëlqen, e nuk do të mund të njohë gjendjen e cila sjellë shqetësim te ai prej të cilit kërkon. Pra, në saje këtyre hollësive nxjerret kuptimi i hadithit:

“Më hallalli që njeriu mund ta hajë, është ajo që vet e fiton.”⁶⁴.

Ndërsa Resulallahut s.a.v.s., i është dhënë emri *xhevami'ul-kelim* (*pronar i fjalimit thelbësor*), që do të thotë se ai shprehte shumë kuptim në pak fjalë. Personi që nuk fiton vet e as nuk ka pasuri të trashëguar nga babai i vet ose nga ndonjë i afërm i tij, do të ushqehet nga duart e njerëzve, dhe nëse i jepet pa lypë - i jepet për shkak fesë së tij. Nëse nuk është fetar siç mendohet, nëse personi që jep nuk do të ishte në gjendje të japë dhe po t'ia njihte fytyrën e tij të brendshme, atëherë atë që e merr e ka haram.

Pyes veten, a thua, personi i cili e siguron ushqimin me lypje, a është i gatshëm të japë me kënaqësi kur lypet prej tij? A ka lypës që mjaftohet kur i jepet vetëm aq sa i duhet?

⁶⁴ Hadithi tashmë është përmendur.

Kur e shqyrton gjendjen e atyre që fitojnë për jetesë duke lypë prej njerëzve, nuk dyshon se shumica e asaj që ata e hanë është haram, dhe e kupton se hallall është fitimi me punë ose ajo që e trashëgon. Padyshim se është paradoks të pretendosh se dikush është i devotshëm e ushqehet duke lypë prej të tjerëve.

E lusim Allahun Teala të mos dëshirojmë asgjë tjetër përpos Atij, që me hallallin e Tij të na ngopë, e të mos ngarendim pas gjërave të cilat Ai i ka vlerësuar si haram, që me mirësinë e Tij të na mbrojë nga gjithçka tjetër pos Tij, me mirësinë dhe bujarinë e Tij, sepse Ai ka fuqi të bëjë çfarëdo që Ai dëshiron.

PASURIA QË E BËN LYPJEN HARAM

Dije se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që lypë, edhe pse ka pasuri të mjaftueshme, ai po kërkon prushin e skuqur të xhehenemit, prandaj kush do le t’i pakësojë, e kush do le t’i shumojë.” Kjo dëshmon qartë se lypja është haram për të pasurin. Por përcaktimi i sasisë së pasurisë është i vështirë. Në këtë çështje ne nuk kemi një kufi të caktuar. Në një hadith është thënë:

“Mjaftohuni me pasurinë prej Allahut ndaj pasurive tjera.” As’habët pyetën:

- *Çka është pasuria e Allahut?*; e Resulallahu, s.a.v.s., u përgjigj:

- ***Dreka për atë ditë, dhe darka për atë natë.***⁶⁵

Në një hadith tjetër thuhet:

“Kush lypë, e ka pasuri të mjaftueshme, në ditën e Kijametit do të vijë i shpërfytyruar.” Kur pyetën:

- *Sa është e mjaftueshme?*, Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- ***Pesëdhjetë derhemë argjend, ose kjo vlerë në ari,*** e në version tjetër thuhet:

“Kush lypë dhe i ka katërdhjetë derhemë, anon kah lypësaria.”⁶⁶

⁶⁵ Hadithi është përmendur në *Librin për zeqatin*, e përcjellë Sehl ibn Hanzali. Ahmedi shënon nga Alia, r.a., me zinxhir të mirë të transmetuesve (*hasen*). Versionin këtu e shënon Ebu Mensur Dejlemi në ‘Musned-i Firdevs’ nga Ebu Hurejre.

⁶⁶ Hadithet janë përmendur në *Librin për zeqatin*.

Meqenëse shuma po ndryshon, e transmetimet janë të drejta, neve na duhet t'i ndajmë ato përshtatshëm gjendjeve të ndryshme me të cilat këto transmetime ndërliiden. Vetëm një përcaktim është i drejtë, e hamendësimi nuk është i lejuar, meqenëse mundësia që t'ia qëllosh të vërtetës me hamendësim është e dobët. Që të mund të përgjigjemi plotësisht në këtë çështje, nuk na mbetet tjetër pos t'i ndajmë gjendjet e njerëzve që janë në nevojë. Prandaj themi se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“I biri i Ademit ka të drejtë (hakk) vetëm në tri raste: në ushqim, që të mund të drejtojë shpinën, në rroba, që të mund të mbulojë pjesët e turpshme të trupit (avret), dhe në shtëpi, që të mund të strehohet. Për gjithçka përtej kësaj do të japë llogari.”

Edhe ne do t'i marrim këto trija si nevojat kryesore, për të shpjeguar llojet e tyre, për të përcaktuar sasinë dhe kohën e tyre. E në kuptim të këtyre janë edhe ndihma udhëtarit i cili nuk ka mundësi të udhëtojë dhe nevojat për shpenzimet e udhëtimit si edhe personi i cili e ka obligim të kujdeset për nevojat e një familje, e edhe fëmijët hynë në këtë vendim, bile përfshirë edhe shpenzimet e kafshëve.

Sa për sasinë, në veshje kjo është veshja që i ka hije besimtarit, e që janë një palë rroba, këmbishë, shami, pantallona dhe këpucë.

Nuk është e nevojshme të ketë edhe nga një palë prej tyre. Sipas kësaj krahaso edhe sendet në shtëpi. E ky është përfundim logjik, sepse edhe e gjithë shtëpia ka vetëm një themel. Njeriu nuk duhet të kërkojë rroba posaqërisht të bukura. Nuk guxon të dëshirojë vila të zbukuruar me bakër e ar, kur mund të jetojë në shtëpi nga çerpiqët, sepse më shumë nuk i duhet. Sa i përket numrit - një komplet, e sa për llojin - të mjaftohet me të zakonshmen.

Sa për ushqimin; edhe kjo është një sasi *mudd*⁶⁷ në ditë. Sipas disave *mudd* është një çerek i njëmijë e dyzet derhemë. Ky është përcaktimi i sheriatit. E lloji është ajo çfarë hahet në atë vend. Nëse është elb, ha elb, nëse është grurë, ha grurë. Njerëzit gjithmonë kërkojnë më shumë, e kjo cilësi duhet plotësisht të ndërprehet. Në disa gjendje ka lehtësime kur edhe mund të kërkohet më shumë.

Nuk ka mosmarrëveshje se lypja për ushqim, veshmbathje dhe vendbanim është hallall. Ka tri situata për të lypur për të ardhmen:

- e para është nevoja për nesër;
- e dyta është nevoja për katërdhjetë ose pesëdhjetë ditë; dhe
- e treta është nevoja vjetore.

⁶⁷ **Mudd**, njësi matëse për sasi, në masë prej dy grushtash, deri në 875 gramë në peshë.

E kush ka siguruar aq sa i nevojitet për vete dhe për familjen e vet për një vit, ai e ka të ndaluar (haram) të lypë, sepse ky është kufiri i fundit i pasurisë.

Pra, përcaktimi prej pesëdhjetë derhemë në hadith është mbi këtë bazë. Sepse, për individin mjaftojnë pesë dinarë ari për nevojat e një viti, nëse është kursimtar. Por, mund të ndodh që kjo nuk mjafton edhe për personin me familje kallaballëk. Nëse e sheh se do t'i duhet më shumë gjatë vitit dhe ka mundësi të lypë, ai njëherë përnjëherë nuk lyp sepse për momentin nuk ka nevojë; e meqenëse ekziston mundësia që të vdes nesër, do të lypte atë që nuk do t'i duhet. Prandaj ushqimi për njëzet e katër orë është i mjaftueshëm për të. Por, nëse nuk do të mund të lyp në të ardhmen dhe nëse nuk njeh dikë që do t'i japë, atëherë i lejohet të lypë, sepse nuk është shumë e pamundur që do ta jetojë edhe një vit, e ky frikësohet se do të jetë në situatë shumë të vështirë për të lypur më vonë. Nëse është një mundësi e dobët që ai nuk do të jetë në gjendje ta lypë në të ardhmen, atëherë lypja e tij sot për shkak të mundësisë së dobët është e papëlqyeshme. Shkalla e papëlqyeshmërisë rritet a zvogëlohet në raport me domosdoshmërinë e nevojës.

E gjitha kjo nuk i nënshtrohet një rregulli, por varet nga mendimi personal i robit dhe është gjendje mes robit dhe Allahut.

Udhëtari i vërtetë i ahiretit këshillohet me zemrën e vet dhe vepron sipas kësaj. Sa më i fortë të jetë imani i tij, sa më i bindur është se do ta arrijë risku i vet në të ardhmen dhe sa më i kënaqur të jetë ai me riskun e vet ditor, grada e tij te Allahu Teala është më e lartë. Është e ditur se Allahu garanton riskun, e frika nga e ardhmja vjen nga besimi i dobët dhe nga vesveset e shejtanit. E Allahu Teala thotë:

“Ju mos iu frikoni atyre! Por frikohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!” 3-Ali Imran: 175, si edhe:

“Shejtani ju frikëson juve me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni mëkate, (si koprraci, etj, e Allahu ju garanton falje (mëkatesh) e begati.” 2-Bekare: 268

Të lypet nga të tjerët është vepër e shëmtuar, e që lejohet në gjendje të nevojës së domosdoshme. Gjendja e atij që, duke lypë mbledh (ushqim, veshje, etj.) për të ardhmen, edhe pse nuk ka nevojë ditore, ose edhe pse nuk ka nevojë as për gjithë vitin, është më e keqe se gjendja e atij që trashëgon pasuri, e nuk harxhon që të ketë për kohë më të gjatë se një vit, e në fakt, sipas fetvasë zahir, të dyja janë të lejueshme. Por në realitet, këto lindin nga dashuria e kësaj bote, nga shpresa për jetë të gjatë dhe nga besimi i dobët në shpërblimin e Allahut Teala. Kjo cilësi përbën rrezikun kryesor. E lusim Allahun Teala të na udhëzojë në rrugë të drejtë, të bukur, me mirësinë e Tij dhe me fisnikërinë e Tij!

GJENDJA E LYPËSIT

Bishri, ka thënë: *Fukaratë janë tri llojesh; Një lloj nuk lypë, e edhe nëse ju jepet pa lypë, ata nuk e pranojnë. Këta janë në shkallën më të lartë të xhenetit (a'la-ji illijin) në mesin e atyre më të afërt Allahut. Një lloj nuk lypë, por ata nuk refuzojnë atë që ju japin pa lypë. Këta janë në xhenetin firdevs, bashkë me ata që prijnë në besim dhe vepra. E një lloj lypë kur kanë vërtetë nevojë, përndryshe jo, dhe këta janë në xhenet bashkë me të singertët.*

U kuptua se të gjithë e kanë qortuar lypjen, sepse edhe kur ekziston nevoja, lypja bëhet sepse për t'u zbehë pozita dhe grada. Kur Ibrahim Ed'hemi u kthye nga Horasani, Shekik Behli e pyeti:

- *Në çfarë gjendje i le fukaratë në mesin e miqve tu?; e Ibrahim, tha:*

- *Kur ju jepet, falënderojnë, kur nuk u jepet, durojnë.* Mendoi t'i lavdërojë që nuk lypin, por Shekik, tha:

- *Edhe qentë e Behlit bëjnë ashtu! Ibrahim pyeti:*

- *E si veprojnë fukaratë te ju, o Ebu Is'hak?; e ai tha:*

- *Këtyre nëse nuk ju jep, të falënderojnë, e nëse ju jep, ata ju japin atyre që kanë më shumë nevojë. Atëherë Ibrahim Ed'hem e uthi Shekik Behlinë në ballë, e i tha:*

- *Të vërtetën e the, o mësues.*

Kjo do të thotë se gjendjet e njerëzve në gradat e kënaqësisë (*rida*), durimit (*sabr*) dhe falënderimit (*shukr*), janë të ndryshme. Udhëtari në rrugën e ahiretit (*saliku tarikul-ahire*) duhet t'i njohë këto gjendje, të njohë ndarjet dhe llojlojshmërinë e gradave të tyre. Nëse nuk i njeh, nuk do të mund të ngritet nga shkalla më e ulët (*esfeli-safilin*) në shkallë më të lartë (*a'la-ji illijjin*).

Njeriu është i krijuar në formën më të bukur (*ahsenu takvim*), e më pas u zbrit në shkallë më të ulët (*esfeli-safilin*). Më pas është urdhëruar që të ngritet në shkallën më të lartë (*a'la-ji illijjin*). Kush nuk e sheh dallimin mes të ultës dhe të lartës, sigurisht që as nuk mund të ngritet. Aq më shumë, ka dyshime edhe për atë i cili e ka kuptuar dallimin, as ai ndonjëherë nuk mund të ngrihet. Nga ata që i zotëruan gjendjet e veta, ka edhe të tillë që lypja e tyre bëhet shkak në ngritjen e shllalës së tyre. Por, duke folë për gjendjen e tyre, duhet pasur në mendje se veprat vlerësohen sipas nijetit. Dikush e pa Is'hak Nurinë si e kishte zgjatë dorën e po kërkonte nga njerëzit, dhe tregon:

"M'u duk punë e madhe kjo; e përçmova. Shkova te Xhunejd Bagdadi, i tregova, e ai më tha:

- Mos të duket punë e madhe kjo; Nuriu lypë prej tyre, për t'ju dhënë atyre. Lypte prej tyre vetëm që ata, duke dhënë, të fitojnë sevap për ahiret. Me këtë sinjalizoi hadithin:

“Dora e atij që jep është lartë.”⁶⁸

Dikush tha: “Dorë e atij që jep në fakt është dora e atij që i pranon paratë, sepse ai jep sevap që ka vlerë më të lartë se paratë që i pranon”; e atëherë Xhunejdi tha:

- Ma jep peshoren; dhe i mati njëqind dërhëmë, e më pas kapi edhe një grusht dërhëmë dhe i lëshoi mbi njëqind dërhëmët e matur, e i mbështolli në bohçe dhe më tha:

- Merri këto e dërgoja Nuriut.

Mendova me vete: “Diçka matet që t’i caktohet vlara. Pse Xhunejdi e përzien vlerën e njohur me atë të panjohur; ai është njeri i dijshtëm!”; por, më erdhi turp ta pyes. U nisa me bohçallëk te Nuriu. Kur mbërrijta, ai më tha:

- Ma jep peshoren; e i mati njëqind dërhëmë, e më tha:

- Ktheja këto dhe thuaj se nga ai nuk pranoj asgjë.

Pjesën e mbetur pas matjes së njëqind dërhëmëve e mori, e unë u habita edhe më shumë. E pyeta për këtë, e ai më tha:

- Xhunejdi është njeri i mençur; ai dëshiron ta kapë litarin nga të dy anët. I ka matë njëqind dërhëmë, për vete, duke dëshiruar sevapin në ahiret. Më pas në këtë ka shtuar edhe një grusht, pa e matë, duke dëshiruar vetëm kënaqësinë e Allahut Teala. Prandaj unë e mora atë që e ka lënë për Allahun Teala dhe e refuzova atë që ai e ka mbajtur për vete.

Ja ktheva pjesën tjetër Xhunejdit, ai filloi të qajë, e tha:

- Mori çka është për të, e na ktheu çka është për neve.

⁶⁸ Muslim, nga Ebu Hurejre

Shiko pastërtinë e zemrave të tyre dhe si veprat e tyre ishte vetëm për Allahun. Bile ata e dinin se çfarë kalon në zemrën e njëri-tjetrit pa folur. Ja, ky është rezultat i ngrënies së hallallit, në saje të zemrës së pastruar nga dashuria e dynajasë, ata i janë drejtuar Allahut me gjithë egzistencën.

Ai që i mohon këto pa e pranuar rrugën e tyre, është injorant, njëjtë si i padijshmi që e mohon se ilaçi pastron zorrët, e as nuk e ka provuar. Në anën tjetër, ai që e mohon këtë pas përvojës e duke qenë i pasuksesshëm, është si personi që e ka pirë ilaçin kundër kapsllëkut por ilaçi nuk i ndikon për shkak të ndonjë problemi tjetër, e ky e mohon se ai ilaç është kundër kapsllëkut. Edhe kjo e dyta është injorancë, megjithëse është më e lehtë në krahasim me të parën.

Mendjehollë (*besiret*) mund të jetë ai që ka hyrë në rrugën e edukimit shpirtëror (*sejr-u suluk*), dhe përjeton atë që kanë përjetuar të parët; ky person është posedues i marifetit dhe ka arritë në *ajn-el jekin*.

Personi që nuk ka hyrë në rrugën e edukimit shpirtëror (*sejr-u suluk*), ose ka hyrë por nuk ka arritur në cak, e megjithatë beson në vërtetësinë e kësaj, dhe e dëshmon këtë. Ky person posedon *ilm-el jekin*, megjithëse nuk ka arritë në *ajn-el jekin*. Edhe *ilm-el-jekin* i ka gradat e veta.

E ata që nuk arrijnë as *an-el jekin* e as *ilm-el jekin*, nuk do t'i takojnë grupit të muminëve, por në Ditën e gjykimit do të ngjallen me grupin e ateistëve mendjemëdhenj. E lusim Allahun Teala të na bëjë nga ata që janë mirë të udhëzuar në dituri të vërtetë (*er-rasihune fil'ilm*).

Kapitulli i dytë

PËR ZUHDIN

Në këtë pjesë do të flasim për hakikatin e zuhdit, dobitë prej tij, gradat e zuhdit, ndarjen, pastaj më në detaje për zuhdin në lidhje me ushqimin, veshjen, banimin, mobiljet (*esas*), mënyrën e të jetuarit, si edhe për shenjat e zuhdit.

HAKIKATI I ZUHDIT

Dije se, zuhd është një gradë e nderuar e udhëtarit shpirtëror (*salikun*) në dynja. Edhe kjo gradë, si edhe gradat tjera, përbëhet nga dituria, gjendja dhe veprimi (*ilm, hal, amel*). Prandaj, siç kanë thënë të gjithë nga gjenerata e parë e ndershme e myslimanëve (*selef*), të gjitha dyert e imanit janë të hapura për besim (*akd*), fjalë dhe vepër. Këto të trija rrutullohen rreth imanit.

Fjala këtu nënkupton gjendjen sepse me fjalë dhe rrëfim shfaqet në zahir gjendja batin, e nuk është menduar në vetë fjalën.

Dituria që shkakton gjendje është si një pemë që jep fryte. Edhe vepra është fryti i kësaj peme. Tani le të përpiqemi të shpjegojmë gjendjen me anë të diturisë dhe veprës.

Synimi ynë me *gjendje (hal)*; është ajo që quhet zuhd. Këtë e definojmë si largim të dëshirës për diçka dhe kthim të dëshirës për diçka tjetër që është më e mirë. Personi heq dorë nga diçka për shkak të mos-dëshirës për të dhe synon diçka tjetër, të cilën e dëshiron. Ndërsa *zuhd* quhet gjendja që lajmërohet në rastin e heqjes dorë nga diçka që megjithatë e dëshiron. *Ragba* (dëshirë) dhe *hubb* (dashuri) janë gjendjet që lajmërohen në raport me arsyen e robit për këtë heqje dorë.

Prandaj, *zuhd* do të thotë se është largim nga diçka dhe drejtim kah diçka më e mirë. Kusht është që ajo prej së cilës largohet të ketë edhe cilësi që ky i dëshiron. Sepse nuk quhet *zahid* ai i cili braktisë diçka që edhe ashtu nuk e dëshiron, si gurë a zallë. *Zahid* është ai që braktisë diçka që vërtetë e dëshiron; si argjendë e dukatë.

Kusht në zuhd gjithashtu është se, ajo që dëshirohet duhet të jetë më e mirë se ajo që braktiset. Shitësi hjekë dorë nga malli i tij vetëm nëse merr diçka më të mirë se malli që tashmë e posedon. Gjendja e tij në raport me mallin e vet është *zuhd*, e gjendja e tij në raport me atë që merr është dëshirë dhe dashuri. Prandaj Allahu Teala thotë:

“Dhe e shitën atë për pak para – për disa grosh; mezi pritën që ta shporrin qafet atë.” (12-Jusuf: 20)

Allahu Teala e cilësoi këtu gjendjen e vëllezërve të Jusufit (a.s.) si *zuhd*. Sepse dëshira e tyre ishte që babai i tyre të mos e shohë Jusufin (a.s.). Kjo për ta ishte më e dashur se Jusufi, (a.s.). Prandaj edhe e shitën, duke e dëshiruar afërsinë e babait të tyre.

Kështu, secili që e shet dynjallëkun që të fitojë ahiretin është zahid ndaj dynjallëkut, por edhe ai që e shet ahiretin e vet për dynjallëk është zahid, por është zahid ndaj ahiretit. Por, emërtimi *zahid* zakonisht u jepet atyre që e braktisin dynjallëkun, sikur termi *ilhad*, që do të thotë *prirje në çdo anë*, e përdoret vetëm për prirje të pathemeltë në pabesim (*batil*). Meqenëse *zuhd* është braktisja e diçkaje të dashur, kjo është e mundur vetëm duke u drejtuar drejt diçkaje edhe më të dashur se kjo. Përndryshe nuk është e mundur të braktiset një gjë e dashur pa gjetur një gjë më të dashur.

Ai që braktisë gjithçka tjetër përveç Allahut, bile braktisë edhe xhenetin, që nuk e do askënd përveç Allahut Teala, ai është zahid, në kuptimin absolut. Edhe ai që braktisë kënaqësitë e dynjallëkut, por nuk i braktisë kënaqësitë e ahiretit; i dëshiron hyritë e xhenetit, pallatet, lumenjtë e pemët atje, edhe ky është zahid, por shkalla e tij është më e ulët në krahasim me të parin. E ai që braktisë një pjesë të dynjallëkut, e pjesët tjera jo; për shembull, braktisë pasurinë por jo edhe ambicien për post, ose braktisë ngrënien shumë por nuk e braktisë zbukurimin dhe stolisjen - i tilli as nuk mund të quhet *zahid absolut*. Pozita e tij në mesin e zahidëve është sikur pozita e atij që pendohet për disa gjynahe në mesin e atyre që janë penduar për të gjitha gjynahet. Siç është i drejtë pendimi i atij që pendohet për disa gjynahe, edhe zuhdi i atij që braktisë disa pjesë të dynjallëkut është i drejtë. Përderisa pendimi (*teube*) nënkupton braktisjen e gjërave të ndaluara, *zuhd* nënkupton braktisjen e gjërave të lejuara (*mubah*) e që janë dëshira të nefsit. Nuk përjashtohet mundësia që personi të braktisë disa prej gjërave të lejuara, siç ka mundësi të braktisë disa gjëra të ndaluara. Personi që kufizohet vetëm në braktisjen e gjërave të ndaluara, nuk është zahid. Shprehja *zuhd* përdoret për braktisjen e gjërave të lejuara (*mubah*) bashkë me të ndaluarat.

Prandaj mund të thuhet se zuhd është braktisja e dynjallëkut për t'iu drejtuar ahiretit, ose braktisje e të dy botëve dhe t'i drejtohet Allahut, e kjo është grada më e lartë

Siç është kusht që, diçka duhet të jetë më e mirë për personin në mënyrë që të jetë e dëshiruar, njëjtë është kusht që personi duhet të posedojë diçka, që të mund ta braktisë atë. Sepse, është e pakuptimtë të thuhet se personi po braktisë diçka që edhe ashtu nuk e posedon. Ndërprerja e dëshirës për diçka shihet në braktisjen e saj. Për këtë arsye, kur dikush e thirri Ibn Mubarekun:

- *O zahid; ai u përgjigj:*

- *Unë nuk jam zahid. Zahid është Omer ibn Abdulazizi. Atij iu ofrua gjithë dynjallëku, por e refuzoi. E unë nuk kam asgjë që mund ta braktis.*

Sa i përket diturisë që shkakton gjendjen e zhudit; kjo është sikur dituria e tregtarit, i cili e di se ajo që merr është më mirë se ajo që jep, prandaj e dëshiron. Nëse nuk e di këtë, natyrisht që tregtari nuk do të heqë dorë nga mallrat e t'i shesë. Kusht është ta dijë se ajo që merr është më e mirë se sa ajo që jep. Njëjtë si ai që di se xhevahiri është më i vlefshëm se bora. Për këtë person është e lehtë që të japë borën e ta merr xhevahirin. Dynjaja është si bora që shkrihet karshi diellit, ndërsa ahireti është si xhevahiri që nuk zhduket, i përhershëm.

E njëjtë është situata me atë që e kupton se ahireti është më i mirë dhe i përhershëm, e dynjaja është e vdekshme. Ai e që posedon këtë njohuri, ai sakrifikon dynjanë për ahiretin dhe për rizanë e Allahut.

Dëshira që ta shesë dynjanë për ahiretin është e lidhur me njohjen e tij të dallimit mes dynjasë dhe ahiretit, e kjo njohje mund të arrijë në atë masë sa të sakrifikojë gjithë pasurinë dhe jetën. Allahu Teala thotë:

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit.”,

e më pas e shpjegon se kjo është shitblerje fitimprurëse:

Andaj, gëzojuni kësaj shitjeje! (9-Tebue: 111)

Mjafton kaq dituri për zuhdin, pra të dihet se ahireti është më i mirë dhe është i përhershëm (*baki*). Këtë e di edhe ai që nuk mund ta braktisë dynjallëkun, por nuk mund ta braktisë ose për shkak të dijes dhe bindjes së pamjaftueshme, ose për shkak që e ka pushtuar epshi dhe është lodër në duart e shejtanit, ose shejtani e mashtron se do të pendohet në të ardhmen, e vdekja i vjen papritur. Atëherë me të mbetet vetëm pendimi pas vdekjes.

Ky ajet tregon pavlefshmërinë e dynjasë:

Thuaju (atyre): “Kënaqësitë e kësaj bote janë të vogla...” (4-Nisa: 77),

e për vlerën e lartë të ahiretit tregon ajeti:

“E dijetarët thanë: Të mjerët ju, shpërblimi i Allahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri vepër të mirë.” (28-Kasas: 80)

Në këtë mënyrë Allahu Tala tërheq vëmendjen se xhevahiri është më i mirë dhe nuk bën të braktiset për diçka më pak të vlefshme. Sa më shumë e njeh vlerën e xhevahirit, aq më shumë largohesh nga gjithçka që vlen më pak. Zuhd nuk mund të mendohet si asgjë tjetër përveçse si zëvendësim me diçka që e do edhe më shumë. Kur një person bëri dua:

Allahu im, ma trego dynjallëkun të tillë si e sheh Ti,
Resulallahu, s.a.v.s., i tha:

“Mos thuaj ashtu, por thuaj: ma trego dynjallëkun të tillë siç ia tregon robëve të Tu të mirë (salihin).”⁶⁹

Kjo sepse Allahu Teala e sheh dynjallëkun në gjithë pavlefshmërinë e tij, çfarë dynjallëku edhe është, prandaj të gjitha krijesat, në raport me Allahun Teala, meritojnë përbuzje. Ndërsa robi këtë botë e sheh me përbuzje në raport me atë që është më e mirë për të.

⁶⁹ Ebu Mensur Dejlemi në ‘Musned-i Firdevs’ në formë më të shkurtë, nga Ebul Kasira.

Për shembull, nëse një person e shet kalin e vet, sepse nuk i pëlqen më - ai edhe më tutje e vlerëson atë kalë më shumë se një insekt, sepse insektet nuk i duhen aspak, ndërsa kali i duhet.

E Allahu është *i Vetmi absolutisht i përsosur*, nuk ka nevojë për asgjë në Qenien e Tij, as në cilësitë e Tij e as në veprimet e Tij. Allahu i sheh të gjithë në të njëjtën shkallë në raport me madhësitinë e Vet (*xhelal*), ndërsa dallimi paraqitet mes krijesave, zahidi dallimin e sheh në raport me veten, jo me të tjerët.

Sa për veprimin që lind nga gjendja e zuhdit, kjo është heqja dorë prej të keqes dhe zgjedhja e asaj që është më e mirë. Siç e dorëzon mallin e shitur në tregti, edhe në zuhd plotësisht largohet nga ajo që e braktisë. Ajo që e braktisë është dynjallëku, të gjitha lidhjet e tij. Nga zemra e nxjerr dashurinë ndaj kësaj bote, e aty e vendos dashurinë e ibadetit. Atë çfarë largon nga zemra e largon edhe nga sytë, duart dhe pjesët e tjera. Sytë, duart dhe pjesët e tjera i angazhon në ibadet. Përndryshe do të ishte si tregtari që e shet mallin e nuk i merr paratë. Një person i tillë mund të gëzohet vetëm kur të kompletohet *shitblerja* e tij, pra kur plotësisht e braktisë dynjallëkun, dhe e përqafton ahiretin. Për këtë shitblerje, atij i jepet myzhde.

Atij që e jep mallin veresije, nëse blerësi është i besueshëm, sigurisht që e mbanë fjalën dhe ia paguan borxhin në afat. Përderisa njeriu e përqafton fort botën, zuhdi i tij nuk është i vërtetë.

Kjo është arsyeja pse Allahu Teala nuk i cilësoi vëllezërit e Jusufit, a.s., si zahidë në çështjen e Benjamin, ani pse thanë:

“Jusufi dhe vëllai i tij janë më të dashur te babai ynë se ne” (12-Jusuf: 8)

Edhe Benjaminin kishin dëshirë ta largonin, sikur Jusufin, a.s., por njëri prej vëllezërve i doli në krah Benjamin, prandaj e braktisë atë dëshirë. Mbajtja e diçkaje në pronësi është shenjë e dëshirës për të, e shenjë e zuhdit është ta braktisë atë; nese e braktisë një pjesë të dynjallëkut por pjesët tjera jo, je zahid vetëm për atë pjesë që e ke braktisë, e jo zahid absolut. Nëse nuk ke pasuri, ty zahid nuk të thuhet, sepse nuk mund të braktisë diçka që nuk e posedon.

Nganjëherë shejtani mund të të mashtrojë duke të thënë: *“Edhe pse nuk posedon asgjë nga dynjaja, ti prapë llogaritesh se e ke braktisë dynjallëkun”*, por ti mos i beso kësaj. Nuk është lehtë të braktisë diçka që posedon.

Shumë njerëz që nuk kanë çka të braktisin mendojnë se nuk do të jenë kryengritës nëse ju jepet rasti. E kur iu vjen rasti, bëjnë çdo të keqe. Nëse mashtrohesh prej shejtanit për gjëra të ndaluara, mos u mashtro prej tij edhe për të lejuarat. Për raste dhe mundësi sprovoje mirë veten, pastaj jep vlerësim, dhe mos harro se do të përballesh me situatë të ndryshme, në çdo moment.

Nefsi është një krijesë që shumë lehtë e thyen marrëveshjen dhe lehtë kthehet te veset e këqija. Shkurtimisht, çfarëdo që të braktisësh, largohu menjëherë prej saj.

Ibn Ebi Lejla i tha Ibn Shubrumit:

- *A e sheh çfarë bën djali i endësit (Ibnul-haik)? Për çfarëdo çështje që unë jap fetva, ai e refuzon!*

E kishte fjalën për Ebu Hanifen, e Ibn Shubrumi i tha:

- *Unë nuk e di a është ai "djali i endësit" a kush është, veç e di se iu ofrua dynjallëku, e ky iku prej tij. E ne e kërkojmë dynjallëkun, ani pse dynjallëku ikë prej nesh.*

Myslimanët në kohën e Resulallahut s.a.v.s., thanë:

- *Ne e duam Rabbin tonë, e po ta kishim dituri si ta fitojmë dashurinë e Tij, do ta bënim menjëherë atë;*

e Allahu Teala shpalli:

“Sikur Ne t’i urdhëronim ata: *“Vritni veten!”* ose *“Shpërnguluni nga atdheu juaj!”*, pak prej tyre do ta bënin.” 4-Nisa: 66

Resulallahu, s.a.v.s., i tha Ibn Mesud:

- *Ti je njëri prej tyre.*

Ibn Mesud ka thënë: *“Nuk e kam ditur se në mesin tonë kishte të tillë që e dojnë dynjallëkun deri sa Allahu Teala shpalli ajetin:*

“Disa nga ju dëshirojnë këtë botë, ndërsa të tjerë nga ju dëshirojnë botën tjetër.” (3-Ali Imran: 152)

Duhet ta dish mirë edhe këtë: bujaria në harxhimin e pasurisë me qëllimin për të përfutur zemrat, nuk është zhud. Të gjitha këto janë veprime të bukura, por nuk llogaritet ibadet.

Zuhd do të thotë të braktisësh dynjallëkun kur e kupton pa-vlerën e tij dhe vlerën e ahiretit. Përndryshe braktisja vetvetiu nuk është *zuhd*, sepse të gjitha format e braktisjes mund të shihen edhe te njerëzit që nuk besojnë në ahiret. Aso braktisje nganjëherë mund të karakterizohet si njerëzillëk, zemërgjerësi dhe moral i mirë, por jo edhe si zuhd. Përfitimi i zemrave të njerëzve është një kënaqësi e përkohshme, më e ëmbël se pasuria.

Siç nuk është zuhd braktisja e pasurisë përmes shitjes, njëjtë nuk është zuhd as braktisja e pasurisë duke dëshiruar reputacion, lavdërim, nder e famë, e as nuk ka zuhd bashkë me vështirësitë e ruajtjes së pasurisë, me gjithë problemet e telashet që kjo i sjell. As braktisja e pasurisë pasi ta shohë si barrë assesi nuk është zuhd. Ndoshta edhe kjo është përmbushje e një dëshire tjetër të nefsit.

Zahid është ai të cilit dynjallëku i vjen pa e kërkuar, pastër, spontanisht, dhe ky është në gjendje që të kënaqet me të e që nderi të mos i përlyhet, emri të mos i turpërohet dhe shpirti të mos i prishet, e megjithatë, ky e braktisë, nga frika se mund të lidhet me të, që do të nënkuptonte se është lidhur me diçka tjetër përpos Allahut Teala dhe se do edhe diçka tjetër, përpos Allahut, prandaj braktisë kënaqësinë e shijimit të dynjallëkut nga dëshira e madhe për të shijuar xhennetin. Ai braktisë kënaqësitë me robërshat dhe me gratë nga dëshira e flaktë për hyritë e mrekullueshme të xhennetit. Braktisë kënaqjen në kopshte duke dëshiruar bahçet dhe pemët e xhennetit. Braktisë zbulimin e stolisjen me stoli të dynjallëkut nga dëshira për stolitë e xhennetit. Ai braktisë kënaqjen në ushqimet e shijshme, duke pritur me padurim frutat e xhennetit, dhe duke u frikësuar të mos i thuhet në ahiret:

“Ju i shfrytëzuat të mirat në jetën e Dunjasë”

46-Ahkaf: 20

Prandaj në gjithçka përparësi i jep asaj që i premtohet në xhennet ndaj asaj që e ka në dynja, Ai e di se çfarë gjendet në ahiret është më e mirë dhe e përhershme, dhe se gjithçka tjetër është e padobishme dhe e përkohshme.

FAZILETI I ZUHDIT

Allahu Teala thotë:

“Ai (Karuni) doli para popullit të vet me stolinë e vet, e ata që kishin synim jetën e kësaj bote thanë: *Ah, të kishim pasur edhe ne si i është dhënë Karunit, vërtet ai është fatbardhë!*”

E ata që ishin të zotët e diturisë thanë: *Të mjerët ju, shpërblimi i Allahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri veprë të mirë, po atë nuk mund ta arrijë kush përveç të durueshmëve!*” 28-Kasas: 79, 80

Allahu Teala këtu zuhdin e ndërlidhi me dijetarët (*ulema'*) dhe zahidët i karakterizoi me dituri (*ilm*), e ky është kulmi i lavdërimit. Allahu Teala gjithashtu thotë:

“Atyre do t’u jepet shpërblim i dyfishtë, për shkak të durimit që kanë treguar” 28-Kasas: 54, e në tefsire thuhet se këtu flitet për durimin e zahidiëve në dynja.

Në një ajet tjetër Allahu Teala thotë:

“Na, çdo gjë që gjendet në Tokë, e kemi bërë stoli për të (njerëzit e Tokës), për të provuar se kush prej tyre është veprues më i mirë.” 18-Kehf: 7,

e në tefsirin e këtij ajeti thuhet: pra, cili nga njerëzit është më zahid me çka zuhdin e bëri ndër veprimet më të mira;

dhe thotë:

“Kush është që dëshiron fitimin e botës tjetër (ahiretit), Ne do t’ia shtojmë fitimin e tij, e kush e dëshiron vetëm fitimin e kësaj bote, Ne ia japim, po në botën tjetër ai nuk ka hise.” 42-Shuara: 20, dhe thotë:

“Mos ia ngul sytë bukurisë së kësaj jete me të cilën i bëmë të kënaqen disa prej tyre (mosbesimtarë), për t’i sprovuar me të, sepse shpërbimi i Rabbit tënd është më i mirë dhe është i përjetshëm.” 20-Ta Ha: 131, dhe:

“Ata që i japin përparësi jetës së kësaj bote ndaj botës tjetër” 14-Ibrahim: 3, me çka i karakterizoi pabesimtarët.

Nga këto ajete kuptohet se besimtari vepron të kundërtën prej pabesimtarit, pra e do ahiretin më shumë se dynjallëkun.

Edhe hadithet që përbuzin dynjanë janë të shumta. Disa prej tyre i kemi përmendur në *Librin ‘Përbuzja e dynjasë’*.

Dashuria për dynjallëk është arsye që sevapet shkatërrojnë. Këtu do të tregojmë për faziletin e përbuzjes së dynjasë, sepse përbuzja e dynjasë është shpëtim. Zaten ky është qëllimi i zuhdit.

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush zgjohet në mëngjes me brenga për dynjallëk, Allahu Teala e vështirëson punën e tij, e shpërndanë pronën e tij, e bën të pangopshëm, e frikëson me varfëri, e nga kjo botë do të marrë vetëm atë që edhe ashtu i është caktuar. E kush zgjohet në mëngjes me brenga për ahiretin, Allahu Teala ia lehtëson punën atij, ia ruan pronën, ia pasuron zemrën, dhe edhe pse ky i largohet dynjallëkut, ajo i drejtohet këtij.”⁷⁰

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Nëse takoni një rob që i është dhënë heshtja dhe zuhdi në dynjallëk, afrojuni atij, sepse ai shpërndanë urtësi.”⁷¹

Allahu Teala thotë:

“... kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhuruar mirësi e madhe.” 2-Bekare: 269

Prandaj thuhet: *“Kush është zahid në dynja për katërdhjetë ditë, Allahu do të bëjë që në zemër t’i mbijnë fidane të urtësisë nga të cilat do t’i flasë gjuha.”*

⁷⁰ Ibn Maxhe nga Zejd ibn Sabit, me zinxhir të mirë të transmetuesve (*xhejjid*), dhe Tirmidhi, nga Enesi, me zinxhir të dobët.

⁷¹ Ibn Maxhe, nga Ebu Hallad.

Njëri prej as'habëve ka treguar: *"E pyetëm Resulallahun (s.a.v.s.), se kush është njeriu më i mirë, e ai na tha:*

- Secili besimtar me zemër të mbrojtur (i mbyllur në vete), me gjuhë të sinqertë. Ne përsëri pyetëm:

- O Resulallah, çka është "zemra e mbrojtur" (mahmumul-kalb)?; e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- Është zemra që ka frikë Allahun, e pastër, në të cilën nuk ka urretje, pasinqeritet, hile dhe lakmi. Prapë pyetëm:

- O Resulallah, e kush do të bëhet i tillë?; e Resulallahu, s.a.v.s., na u përgjigj:

*- Ai që përbuzë dynjallëkun dhe e do ahiretin."*⁷²

Nga kjo kuptohet që ndër njerëzit më të këqinj janë ata që e dojnë dynjallëkun. Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

"Nëse dëshiron që Allahu të të dojë, bëhu zahid në këtë botë."⁷³

Zuhdi është theksuar si shkak i dashurisë, e atë që Allahu Teala e do, ai është në shkallën më të lartë. Prandaj zuhdi në dynja është një nga mekamet (gradat shpirtërore) më të larta. Gjithashtu, nga hadithi kuptohet se ai që e do dynjanë i ekspozohet zemërimit të Allahut. E në transmetimin që e përcjell ehli-bejt, Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

⁷² Ibn Maxhe, me zinxhir të besueshëm (*sahih*) nga Abdullah ibn Amr, e tashmë është përmendur. Këtë version e shënon Haraiti, në veprën *Mekarimul-ahlak*.

⁷³ Ibn Maxhe nga Sehl ibn Sa'd, me zinxhir të dobët të transmetuesve (*daif*).

“Zuhd dhe devotshmëria shëtisin zemrat për çdo natë, nëse takojnë një zemër me imam dhe turpërim, vendosen aty, e nëse nuk gjejnë një zemër të tillë, largohen.”⁷⁴

Kur Harisa e pyeti Resulallahun, s.a.v.s.:

- *A jam unë besimtar i vërtetë (hakiki)?;*

Resulallahu, s.a.v.s., e pyeti:

- ***E çka është hakikati i imanit tënd?***

- *E largova veten nga dynjallëku, për mua gurët dhe ari i botës janë të njëjtë. Sikur të jem edhe në xhennet edhe në xhehenem, dhe sikur të më jetë treguar Arshi i Rabbit tim; tha Harisa, e në këtë, Resulallahu, s.a.v.s., tha:*

- ***Ke arritë njohje, prandaj vazhdo ashtu. Je një rob, zemrën e të cilit Allahu e ka nriçuar me iman.***⁷⁵

Shiko si e paraqiti hakikatin e imanit me tërheqje nga dynjalleku e pastaj këtë e bashkoi me bindjen. Dhe shih si e lavdëroi Resulallahu, s.a.v.s., duke i thënë: ***“je një rob, zemrën e të cilit Allahu e ka nriçuar me iman”***.

E lutën Resulallahun, s.a.v.s., të interpretojë shprehjen “zgjerojë” (*sherh*) nga fjalët e Allahut Teala:

“Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron (jeshreh) zemrën për (të pranuar) Islamin” (6-Enam: 125), e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

⁷⁴ Hadithi nuk është gjetur.

⁷⁵ Bezzari nga Enesi, dhe Taberani nga Haris Malik.

- Kur nuri hyn në zemër, gjoksi i hapet e i zgjerohet.

Dikush pyeti:

- *O Resulallah, a ka kjo ndonjë shenjë?*; e Resulallahu, s.a.v.s., u përgjigj:

- Ka. Largimi nga bota e mashtrimit, drejtimi kah bota e përjetshme, dhe përgaditja për vdekjen para se ajo të vijë.⁷⁶

Pra, kushtoi vëmendje, Resulallahu, s.a.v.s., zuhdin praktikisht e shpjegoi si kusht për islam, e kjo është largimi nga dynjallëku mashtrues.

Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- Vërtetë turpërohuni prej Allahut.

- *Ne turpërohemi*; thanë ata, por Resulallahu, s.a.v.s., ju tha:

- Turpërimi nuk është ashtu. Ndërtoni atë ku nuk do të banoni dhe grumbulloni atë që nuk do ta hani.⁷⁷

Me këtë qartazi mund të konkludohet se një sjellje e tillë pakëson ndjenjën e turpërimit para Allahut Teala.

Erdhën disa njerëz te Resulallahu, s.a.v.s., e thanë:

- *Ne jemi besimtarë*; Resulallahu, s.a.v.s., i pyeti:

- Cila është shenja e besimit tuaj?

⁷⁶ Hakimi, dhe tashmë është përmendur.

⁷⁷ Taberani nga Ummu Veled.

Ata i përmendën durimin në telashe, falënderimin në pasuri, pajtueshmërinë me caktimin e Allahut si edhe të mos gëzohen kur dikë prej armikut e godet ndonjë fatkeqësi. Në këtë, Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- Nëse jeni të tillë, atëherë mos grumbulloni atë që nuk do ta hani, mos ndërtoni atë ku nuk do të banoni, dhe mos bëni gara me atë që do të leni pas jush.⁷⁸

Me këtë, Resulallahu, s.a.v.s., e prezantoi zuhdin si plotësim të besimit të tyre. E Xhabiri ka treguar se Resulallahu, s.a.v.s., po mbante hutbe, dhe tha:

- Kush vjen para Allahut me fjalët: “Nuk ka zot tjetër pos Allahut (La ilahe ilallah), dhe nuk përzien asgjë me ato fjalë, pa dyshim do të dërgohet në xhennet.

Atëherë u ngrit Alia, r.a., dhe i tha:

- Ti që më je më i dashur se nëna dhe babai, o Resulallah, na e shpjego pak këtë “nuk përzien asgjë me ato fjalë”, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- Dashuria ndaj dynjallëkut, kërkimi dhe pasimi i tij. njerëzit i përsërisin fjalët e pejgamberëve, e i bëjnë veprat e zullumqarëve. Prandaj kush vjen me fjalët “Nuk ka zot pos Allahut” dhe nuk përzien asgjë, pa dyshim do të dërgohet në xhennet.⁷⁹

⁷⁸ Hatibi dhe Ibn Asakir nga Xhabiri, r.a.

⁷⁹ Ky version nuk është gjetur, e hadith të ngjashëm shënojnë Tirmidhiu dhe Hakimi, në veprën ‘Nevadir,’ nga Zejd ibn Erkam, me zinxhir të dobët të transmetuesve (daif).

Në një tjetër hadith thuhet:

“Bujaria vjen nga besimi i vërtetë (*jekin*). Ai që ka besim të vërtetë nuk hyn në xhehenem. Koprracia vjen nga dyshimi. Ai që bie në dyshim, nuk hyn në xhenet.”⁸⁰

Resulallahu, s.a.v.s., gjitashtu ka thënë:

“Personi bujar është i afërt Allahut Teala, afër njerëzve dhe afër xhenetit. Koprraci është larg nga Allahu, larg nga njerëzit dhe afër xhehenemit.”⁸¹

Koprracia është fryt i dëshirës për këtë botë e bujaria është fryt i zuhdit, e padyshim që lavdërimi i frytit do të thotë lavdërim i pemës që e jep atë fryt. Ndërsa Ibn Musejeb transmeton nga Ebu Dherr që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që largon fytyrën nga kjo botë, Allahu Teala i vendos urtësi (*hikma*) në zemër, gjuhën e tij e bën të flasë me urtësi, e njofton me sëmundjen e botës dhe ilaçin për këtë, e nxjerr nga dynjaja dhe e dërgon të pastër në katin e dytë të xhenetit (*darus-selam*).”⁸²

Tregohet se Resulallahu, s.a.v.s., me as’habët e vet po kalonte pranë disa deve të mbarësuar. Për arabët, këto deve ishin prona më e dashur dhe më e vlefshme, sepse i

⁸⁰ Autori i **‘Firdevsit’** nga Ebu Derda.

⁸¹ Tirmidhi nga Ebu Hurejre. Tashmë është përmendur.

⁸² Hadithin e shënon Ibn Ebi’d- Dunja në librin e vet *Zemmud-dun’ja*, nga Safvani si hadith *mursal*.

përdornin për transport dhe për qumështin, mishin e qimet e tyre. Për shkak të vlerës që paraqitnin për arabët këto deve, Allahu Teala thotë: **“...kur deve të mbarsë të mbeten pa çoban** (pa kujdes).” (81-Tekvir: 4). Resulallahu e ktheu kokën dhe uli shikimin. Dikush nga as’habët tha:

- *O Resulallah, këto janë prona jonë më e dashur. Përse nuk dëshiron t’i shikosh?!;* e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- *Rabbi im më ka ndaluar t’i shikoj;* pastaj lexoi ajetin:

“Dhe mos ia ngul sytë bukurisë së kësaj jete me të cilën i bëmë të kënaqen disa prej tyre, e për t’i sprovuar me të.” 20- Ta-Ha: 131.

Mesruku tregon nga Ajsha, r.anha:

“E pyeta Resulallahun, s.a.v.s.:

- *O Resulallah, pse nuk kërkon nga Allahu të të ushqejë? Qaja duke e parë sa ishte i uritur, e ai m’u përgjigj:*

- *O Ajsha, pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, sikur të kërkoja nga Rabbi im që kodrat t’i shndërrojë në ar për mua, Ai do të më dhuronte, çfarëdo të kërkoj në dynja. Por unë për këtë botë zgjodha urinë ndaj ngropjes; varfërinë ndaj pasurisë; pikëllimit ndaj lumturisë së saj. O Ajshe, dynjallëku nuk i ka hije Muhammedit, e as familjes së Muhammedit. O Ajshe, Allahu është i kënaqur me pejgamberët të mëdhenj vetëm përmes durimit të tyre ndaj gjërave të papëqyera të dynjasë dhe refuzimit të tyre ndaj dashurisë së dynjasë. E më pas, Ai është i kënaqur me mua vetëm nëse më obligon siç i ka obliguar edhe ata.*

E më pas lexoi:

“Ti (Muhammed) duro, ashtu sikurse duruan të dërguarit e vendosur (ulul-azmi mine er-resuli)” (46-Ahkaf: 35), dhe tha:

Pasha Allahun, nuk ka tjetër pos t’i jem Atij i dëgjueshëm, dhe sigurisht që, pasha Allahun, do të duroj ashtu siç duruan ata, me gjithë forcën time. E nuk ka forcë tjetër pos me Allahun.”⁸³

Omeri, r.a., tregon se, kur Allahu ju dhuroi njëren prej fitoreve, vajza e tij, Hafsa, i tha:⁸⁴

- *Vesh rroba të bukura kur të vijnë të deleguarit nga vendet e largëta dhe le të përgatisin ushqime të shijshme, e hani, ti dhe kushdo prej tyre që është prezent; e Omeri, r.a., i tha:*

- *O Hafsa, a nuk e di ti që gjendjen e personit më së miri e njeh familja e tij?! Hafsa, r.a., u përgjith:*

- *Po, e di; e Omeri, r.a., iu drejtua me fjalët:*

- *Pashë Allahun, e a nuk e di ti që Resulallahu, s.a.v.s, gjatë pejgamberllëkut të tij veshte këso rroba?! As ai as familja e vet nuk hanin diçka në mëngjes e që në mbrëmje të mos mbesin të uritur, dhe nëse hanin diçka në mbrëmje, ishin të uritur në mëngjes.*

⁸³ Ebu Mensur Dejlemi në veprën ‘*Musned-i Firdevs*’ me zinxhir të transmetuesve të shënuar nga Abdurrahman Sulemi, e hadithin e përcjell Abbad ibn Abbad nga Muxhalidi, ai nga esh-Shabi e ky nga Mesruku, në version më të shkurtë.

⁸⁴ Nuk është gjetur e tëra në një transmetim, por në disa transmetime të ndryshme.

Pashë Allahun, a nuk e di kur një ditë Resulallahut, s.a.v.s., ia shtruan një sofër pak të lartë, e kjo aq shumë e goditi sa iu ndërrua ngjyra e fytyrës. Urdhëroi të largohet sofa dhe ushqimin e lëshoi në tokë. Pashë Allahun, a nuk e di ti se Resulallahu, s.a.v.s., flinte mbi mantelin e vet, duke e bërë dyfish. E kur një herë ia bënë mantelin katër fish, ai fjeti ashtu mbi të, por kur u zgjua, tha:

- Me këtë më penguat të falë namazin e natës. Vetëm dyfishojeni, siç e dyfishonit më parë.

Pashë Allahun, a nuk e di se Resulallahu, s.a.v.s., i la rrobat për t'u larë e atëherë Bilali nisi të thërras ezanin, e Resulallahu, s.a.v.s., nuk kishte rroba tjera që të falë namaz, prandaj ai priti derisa rrobat u thanë që të niset me to në namaz. Pashë Allahun, a nuk e di që një grua nga fisi Benu Zafer ia bëri Resulallahut, s.a.v.s., një fustanellë dhe një këmishë, e kur e përfundoi të parën, ia dërgoi, ende pa e përfunduar të dytën, e Resulallahu, s.a.v.s., me atë një të vetme shkoi në namaz, duke u mbështjell në të, e nuk kishte asgjë tjetër, dy fundet i lidhi rredh qafës dhe ashtu fali namaz..."

Omeri, r.a., vazhdoi të flasë kështu, deri sa Hafsa filloi të qajë. Atëherë edhe ai filloi të qajë. Aq shumë gëlçoi, sa menduan se do t'i dalë shpirti.

Në disa transmetime tregohet se Omeri, r.a., gjithashtu ka thënë: *“Unë i kisha dy shokë, e ata kishin një rrugë që e ndoqën. Nëse dal nga ajo rrugë, unë ndahem prej tyre. Vallahi, do të duroj në dynja si ata, që të jetoj pa brenga, me ata.”*⁸⁵

Said Hudri transmeton se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: **“Pejgamberët para meje janë sprovuar me varfëri. Ata nuk kishin asgjë tjetër pos një veshje prej leshi, e më shumë ishin falënderues ata për këtë, me gjithë insektet në to që i mundonin, se sa ju për dhuratat që i merrni.”**⁸⁶

Ibn Abbas tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: **“Kur Musa, a.s., mbërrijti në lumin ‘Medjen’, gjelbërimi i perimeve që hëngri gati sa ishte i dukshëm në stomakun e tij nga dobësia.”**⁸⁷

Kjo është jeta e preferuar e pejgamberëve. E ata më së miri e kanë njohur Allahun dhe rrugën e shpëtimit në ahiret. Omeri, r.a., transmeton: *“Kur u shpall ajeti:*

“Ata të cilët e ruajnë arin e argjendin e nuk e japin në rrugën e Allahut...” (9-Teube: 34), Resulallahu, s.a.v.s., tha:

⁸⁵ Omeri, r.a., e kishte fjalën për Resulallahun, s.a.v.s., dhe Ebu Bekr Siddik, r.a.. E shënojnë shumë transmetues, e te Ebu Nuajm gjindet në veprën e tij *Hil’jetul-evlija*.

⁸⁶ Hadith sahih, nga Ibn Maxhe.

⁸⁷ Transmeton Ibn Maxhe

- ***Dynjaja është e mallkuar, ari dhe argjendi janë të mallkuar. Ne e pyetëm:***

- *O Resulallah, Allahu na ka ndaluar të grumbullojmë arin e argjendin, pra, çfarë duhet të bëjmë?, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:*

- ***Secili prej jush le të ketë një gjuhë që bën dhikr, zemrër falënderuese dhe merrni një grua që ju ndihmon në punë të ahiretit.***⁸⁸

Huzejfe transmeton se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush i jep përparësi dynjallëkut ndaj ahiretit, Allahu Teala do ta sprovtojë me tri gjëra: brengë që nuk del prej zemrës, varfëri që nuk kalon dhe lakmi të pashuar.”⁸⁹

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Personi nuk mund të arrijë përkryrjen e imanit, deri sa të mos i vijë më mirë të jetë i panjohur se sa i njohur, dhe deri sa nuk i është më e dashur e pakta se sa e shumta.”⁹⁰

Isa, a.s., ka thënë: *“Dynjaja është një urë, kaloni nëpër të e mos u mundoni me riparimin e saj.”* Disa i thanë:

⁸⁸ Taberani në **‘Evsat’** nga Sevban, r.a., dhe Imam Gazali e përmend Omerin, r.a., sepse ai edhe e bëri pyetjen. Shënon edhe Bezzar, nga Ibn Abbas.

⁸⁹ Nuk është gjetur nga Huzejfe. Hadith të këtillë shënon Taberani nga Ibn Mesud, me zinxhir të mirë të transmetuesve (*hasen*).

⁹⁰ Dejlami në veprën **‘Musned-i Firdevs’** shënon hadithin nga Ali ibn Ebu Talh, si mursal.

- *O i dërguar i Allahut, na jap leje të bëjmë një tempull,*
e Isa, a.s., ju tha:

- *Shkoni e ndërtoni shtëpi mbi ujë. Atëherë e pyetën:*

- *Si mund të qëndrojnë ndërtesa mbi ujë?; e Isa, a.s., tha:*

- *E si është i mundur ibadeti me dashuri të dynjallëkut?!*

E Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Rabbi im, i fuqishëm e madhështor, më ofroi që kodrat e Mekes të m’i bëjë nga dukati, e unë i thashë:

- *O Rabbi im, nuk e dua këtë, por le të jem një ditë i uritur, e tjetrën i ngopur. Kur jam i uritur të bëj dua Ty, i përulur, e kur jam i ngopur, të falënderohem e të lavdëroj Ty.*”⁹¹

Në transmetimin e Ibn Abbasit r.a., një ditë Resulallahu s.a.v.s., duke ecur në kodrën Safa, me Xhebrailin a.s., Resulallahu, a.s., i tha:

- *O Xhebrail, pasha Allahun, Ehli Bejti i Muhammedit kanë fjetë mbrëmë, e nuk kishin as një copë dhjathë, a një grusht miell.*

Para e përfunduar Pejgamberi fjalën, u dëgjua një zë i tmerrshëm nga qielli. Resulallahu, s.a.v.s., e pyeti Xhebrailin a.s.:

- *A urdhëroi Allahu që të bëhet kiameti?! Xhebraili iu përgjigj:*

⁹¹ Ahmedî, Tirmidhiu, Taberani, Bejhakiu nga Ebu Uname.

- Jo. Ky është Israfili, a.s.. Zbriti te ti, sapo dëgjoi çfarë the. Atëherë Israfili, a.s., i tha Resulallahut, s.a.v.s.:

- Allahu Teala dëgjoi se çfarë the e më dërgoi me qelësat e thesareve të tokës te ti, e më urdhëroi të të ofroj që kodrat e Tihamit të bëhen smerald, rubinë, ar e argjend për ty, dhe të pyes se a dëshiron të bëhesh peygamber mbret apo peygamber rob? Xhebraili, a.s., i dha isharet që të jetë peygamber rob, e Muhammedi, a.s., tha tri herë:

- Peygamber rob. Peygamber rob. Peygamber rob.⁹²

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur Allahu Teala ia do të mirën robit të Tij, ia largon fytyrën prej dynjallëkut, ia shton dëshirën për ahiret dhe ia tregon të metat e nefsit të tij.”⁹³

Resulallahu. s.a.v.s., i tha një personi:

- Ktheje fytyrën nga dynjallëku, të do Allahu. Mos shiko në duart e njerëzve, se të dojnë njerëzit.⁹⁴

Dhe ka thënë:

“Kush dëshiron që Allahu Teala t’i dhurojë dituri pa mësuar, dhe udhëzim pa udhëzues, le të largohet nga dynjallëku.”⁹⁵

⁹² Hadithin është përmendur në version më të shkurtë.

⁹³ Ebu Mensur Dejlemi në ‘Musned-i Firdevs’ pa fjalët “dëshirë për ahiret” e me shtojcën “i dhuron ta kuptojë fenë.” Zinxhiri i transmetuesve është i dobët (daif).

⁹⁴ Hadithi tashmë është përmendur.

Me një hadith ka thënë:

“Kush e dëshiron xhenetin, ai ngutet të bëjë vepra të mira. Kush i frikësohet xhehenemit, ai braktisë dëshirat e epshit. Kush e pret vdekjen, i braktisë kënaqësitë. Kush është zahid ndaj dynjasë, lehtë i kalon vështirësitë.”⁹⁶

Transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., dhe Isa, a.s., kanë thënë:

“Katër gjëra arrihen vetëm me vështirësi: heshtja, dhe ky është fillimi i ibadetit, përulësia, dhikri i shumtë dhe pasuria e pakët.”⁹⁷

Është e pamundur të përmenden të gjitha transmetimet që lavdërojnë përbuzjen e dynjasë dhe dashurinë ndaj saj. Pejgamberët u dërguan që njerëzit t'i largojnë nga kjo botë, e t'i drejtojnë kah ahireti, prandaj shumica e bisedave të tyre me njerëzit ka të bëjë me këtë temë. Mendoj se mjaftojnë këto që i përmendëm. Vetëm prej Allahut kërkohet ndihmë.

Sa për transmetimet nga gjeneratat e para të myslimanëve dhe dijetarëve për zuhdin, do të përmendim se thuhet:

⁹⁵ Hadithi nuk është gjetur.

⁹⁶ Ibn Hibban në **‘Dhuafa’** nga Ali ibn Ebu Talib r.a..

⁹⁷ Taberani dhe Hakimi nga Enesi, r.a.. Tashmë është përmendur.

“La ilahe ilallah, do të largojë nga rob zemërimin e Allahut Teala, deri sa nuk i luten Allahut Teala që t’ju dhurojë atë që mendojnë se ju mungon nga dynjallëku”;

e në një transmetim tjetër thuhet:

“Kur thonë ‘la ilahe ilallah,’ ndërsa preferojnë dynjallëkun, Allahu Teala ju thotë:

- Po gënjeni! Nuk jeni të sinqertë në këtë që thoni!”

Tregohet se njëri prej as’habëve ka thënë: *“I studiuam të gjitha veprat, e për ahiretin nuk gjetëm asgjë më të mirë se sa largimin nga dynjallëku.”*

Gjithashtu, njëri prej as’habëve i tha njërit prej taibinëve më të vjetër: *“Ju bëni më shumë ibadet dhe angazhoheni më shumë se as’habët e Pejgamberit, a.s., por prapë ata janë më të mirë se ju.”*

- E si ashtu?; e pyeti, e as’habi u përgjigj:

- Ata ishin zahidë më të mëdhenj se ju.

Omeri, r.a., ka thënë: *“Zuhdi në dynja është rehati për zemrën dhe trupin.”*

Bilal ibn Sa’d ka thënë: *“Edhe pse Allahu na ftoi të largohemi nga dynjallëku, ne megjithatë kemi mall për dynjanë. Kjo na mjafton si gjynah.”*

Një person i tha Sufjan Sevrisë:

- *Kam dëshirë të takoj një dijetar zahid; e Sevriu i tha:*

- *I mjeri ti! Nuk ka të tillë.*

Vehb inb Munebih ka thënë: *“Xhenneti i ka tetë dyer, e kur xhenetlitë të nisen të hyjnë në to, portierët do të thonë:*

- *Pasha fuqinë e Rabbit tonë, askush nuk do të futet para zahidëve dhe ashikëve.”*

Jusuf b. Esbat ka thënë: *“Tri veti i kërkoj nga Allahu: të vdes e të mos kem asnjë dërhëm, të vdes pa asnjë borxh, të shkoj në ahiret pa mish në kockat e mia.”*

Të gjitha këto që i kërkoi Jusuf b. Esbat, Allahu ia dhuroi.

E njëri nga halifet Abbasit ju dërgoi disa fakihëve dhurata, dhe ata i pranuan. Fudajl ibn Ijadit ia dërgoi dhjetë mijë dërhëmë, por ky nuk i mori. I biri i tha:

- *Fakihët tjerë i pranuan, pse ti jo? Ke nevojë. Fudajli filloi të qajë, e tha:*

- *A e dini kujt i ngjasojmë unë dhe ju? Atij popullit që e kishte një lopë dhe e donin shumë. Kur lopa u vjetrua, e therrën që të përfitojnë nga lëkura e saj. Edhe ju; dëshironi të më therrni mua tash kur u plaka. Oj familja ime, më mirë e keni të vdisni në uri se ta therrni Fudajlin.”*

Ubejd b. Umejra ka thënë: *“Isa, a.s., i biri i Mejremes, vishte rroba nga leshi dhe ushqej me bimë. Nuk pati fëmijë që ti vdes, as shtëpi që ti rrënohet, as nuk grumbulloi që të ketë për nesër. Ku e zinte nata, aty flinte.”*

Ebu Hazimit, gruaja i tha:

- *Dimri është afruar. Duhet të sigurojmë ushqim, veshmbathje e dru!*; e Ebu Hazim i tha:

- *Po, e gjithë kjo është e nevojshme. Por mos harro se e nevojshme është gjithashtu edhe të përgatitemi për vdekje, e më pas të ngjallemi, e më pas të qëndrojmë para Allahut Teala, e pastaj – xhenneti ose xhehenemi.*

I thanë Hasan Basriut:

- *Përse nuk i lanë rrobat shpesh?*; e Hasani tha:

- *Kam punë më të rëndësishme e më urgjente.*

Ibrahim b. Ed’hem ka thënë: *“Zemrat i kemi të mbuluara me tri perde, dhe rob i nuk do të arrijë bindje (jekin) deri sa nuk i ngritë ato perde: gëzim kur fiton diçka, pikëllim kur humb diçka dhe lumturi kur dikush e lavdëron. Nëse gëzohesh kur fiton diçka, do të thotë që je lakmitar. Nëse pikëllohesh kur humb diçka, do të thotë që je i pakënaqur, e i pakënaquri do të dënohet. Dhe nëse të bën të lumtur kur dikush të lavdëron, kjo do të thotë që ke vetpëlqim, e vetpëlqimi i shkatërron veprat.”*

Ibn Mesud ka thënë: *“Dy reqate namaz të zahidit është më e vlefshme se sa ibadeti që e bën me vështirësi gjatë jetës ai që nuk është zahid.”*

Dikush nga gjenerata e parë e myslimanëve (selef) ka thënë: *“Mirësia e Allahut ndaj nesh është që na ka përjashtuar nga shumica e mirësive të Tij.”* Thuaj se ka genë duke menduar në fjalët e Resulallahut, s.a.v.s.:

“Allahu Teala ia ka ndaluar robët besimtarë dynjallëkun sepse Ai e do robët e Vet, njëjtë si ju kur të sëmurit tuaj i ndaloni ushqim e pije të caktuar, nga frika për të mirën e tij”⁹⁸,

prandaj kur ky selefi e kuptoi këtë, e kuptoi që mirësitë e ndaluara që sigurojnë shëndet janë më të mira se sa dhuratat që dërgojnë në sëmundje. [Prandaj kur kuptohet kjo, dihet që mirësitë e ndaluara që sigurojnë shëndet janë më të mira se sa dhuratat që dërgojnë në sëmundje.]

Sufjan Sevri e kishte zakon të thoshte: *“Dynjaja nuk është vendi i drejtësisë, është vend i devijimit, nuk është vend i qetësisë, është vend i shqetësimit. Ai që e njeh dynjanë, as nuk gëzohet me bollëkun e saj e as nuk mërzhitet për vështirësitë e saj.”*

⁹⁸ Hadithi tashmë është përmendur.

Sehl et- Tusteri ka thënë: *“Vepra e abidit nuk do të jetë e singertë nëse nuk e ka mbështjellë me katër gjëra: me uri, me rroba të thjeshtq, me varfëri dhe me përuje.”*

Hasan Basriu ka thënë: *“Kam takuar njerëz që nuk gëzoheshin kur dynjallëku ju vinte, as nuk shqetësoheshin kur ju largohej. Ari dhe argjendi në sytë e tyre ishte i më i pavlerë se dheu. Edhe kur jetonin gjatë, nuk kishin as rroba të palosura, as tenxhere për të zier. Ata nuk shtronin diçka mes tyre e dheut, e as nuk urdhëruan familjarët t’i bëjnë ndonjë gjellë sipas qejfit të tyre. Kur bëhej nata ngriteshin në këmbë, vendosin ballin në tokë, në faqe ju rridhnin lotë, dhe e lusnin Rabbin e tyre t’i lirojë nga prangat e neftsit. Kur bënin ndonjë vepër të mirë, e largonin lavdërimin nga vetja e Allahun Teala e lusnin që t’a pranojë atë vepër. Kur bënin ndonjë vepër jo të mirë, i kaplonte pikëllimi dhe e lusnin Allahun Teala për falje. Vazhdimisht kështu vepronin. As në këso gjendje ata nuk mund të mbroheshin nga gjynahet, prandaj vazhdimisht kërkonin shpëtim në faljen e Allahut, (magfired), rizaja e Tij qoftë me ta.*

GRADAT E ZUHDIT

Zuhdi, si i tillë, ndahet në tri gradë, përshtatshëm dallimeve në fuqinë e tij:

Grada e parë

është grada më e ulët, kur njeriu lufton për t'u larguar nga dynjallëku por megjithatë ka mall për të, zemra i anon kah dynjaja dhe nefsi i shprehë interesim për të. Kësaj i thuhet *mutezehhid*⁹⁹. Për atë që me përpjekje arrin në gradën e zuhdit, një gjendje e këtillë paraqet fillimin e zuhdit. *Mutezehhidi* së pari e pastron nefsin e më pas nxjerr nga zemra gjërat që i dëshiron, por zahidi së pari i nxjerr nga zemra ato gjëra që i dëshiron dhe më pastaj pastrohet me ibadet. Pra, ky është dallimi mes zahidit dhe mutezehhidit. Zahidi, tashmë nuk ka nevojë të bëjë sabër për ato çfarë ka braktisur. E mutezehhidi është në rrezik prej kësaj, meqenëse nefsi edhe më tutje mundet ta sundojë dhe epshet e tërheqin kah dynjallëku e kënaqja me të, qoftë kjo tërheqje e dobët apo më e fortë.

Grada e dytë

është gjendja kur personi e braktisë dynjallëkun nga neveria që ndjenë prej saj. Sikur njeriu heq dorë nga një dërhëm me qëllim që të fitojë dy, kjo nuk i vjen e vështirë, edhe nëse i duhet të presë.

⁹⁹ shumë i lidhur për fe; shumë fetar; thellësisht fetar.

Nuk ka kurrfarë dyshimi që ky zahid është i vetëdijshëm për zuhdin e tij, dhe e ruan me kujdes, si tregtari që është i vetëdijshëm për atë që e shet, dhe asaj i përkushtohet. Shumë lehtë mund të ndodhë që një zahidi të këtillë të fillojë t'i pëlqejë vetja, të mahnitet me veten dhe zuhdin e vet, mendon se ka braktisë diçka të vlefshme për diçka edhe më të vlefshme. Kjo gjendje gjithashtu është mangësi.

Grada e tretë

është grada më e lartë e zuhdit, kur braktisë gjithë dynjallëkun, bile edhe zuhdin, sepse nuk mendon që po braktisë diçka. Ai e ka kuptuar se dynjallëku është asgjë. Personi që e braktisë gurin dhe merr xhevahirin, nuk e sheh xhevahirin si kompensim për gurin dhe nuk mendon se ka braktisë diçka. Guri karshi xhevahirit edhe ka ndonjë vlerë, e dynjallëku karshi Allahut Teala, kurrfare. Kjo është përkryerje në zuhhd, e sebeb i bëhet përkryerja e marifetit. Zahidi i tillë është i sigurt që nuk kthehet përsëri kah dynjallëku, njejtë si personi që e jep gurin në këmbim të xhevahirit e nuk është pishman për këtë. Ebu Jezid Bistami e pyeti Musa Abdurrahmanin:

- *Për çfarë do të flasësh?* e Ebu Musa u përgjigj:

- *Për zuhdin!* Bistamiu e pyeti:

- *Për çfarë zuhdi?*, e Ebu Musa tha:

- *Ndaj dynjallëkut!* Bistamiu bëri me dorë, e tha:

- *Mendova se po flet për diçka, e dynjallëku është asgjë.*

Çfarë ka aty që të braktiset?

Sipas evlijave, ai që e braktisë dynjallëkun për ahiret është sikur personi që ia hedh një kafshatë qenit në derën e mbretit që e pengon të hyjë te mbreti, e qeni merret me atë kafshatë, e ky hyn dhe arrin afërsi me mbretin, e më pas emri i njihet në të gjithë mbretërinë. A nuk e ke të qartë? Ky, për gjithë atë arritje të tij, ndihmën për afrim mbretit e pa në hudhjen e një kafshate qenit! Edhe shejtani është një qen në derën e Allahut që i pengon njerëzit të hyjnë, ani që dyert janë të hapura, e perdet e ngritura.

Dynjaja është si ajo copë buke. Nëse hahet, i ndjehet pak shija gjatë përtypjes, por i humb para gëlltitjes. Çfarë ka mbetë, arrin në stomak, e atje shndërrohet në pisllek që duhet larguar. Ai që e braktisë këtë “copë buke” për rizanë e Allahut, si mund të interesohet përsëri për të? Tërë pasuria e dynjasë në krahasim me ahiretin është më pak se një kafshatë. Në fakt, as që mund të ketë krahasim në mes të diçkaje që ka afat me atë që nuk ka fund. Dynjaja mbaron shpejt. Edhe nëse jeton njëmijë vjet, pa brenga, prapë nuk mund as të krahasohet me begatitë e bekimeve të përjetshme. Prandaj zahidi nuk kthehet kah ajo që e ka braktisur. Nëse kthehet, do të thotë që edhe më tutje mbështetet në të, e që është frut i mangësisë në njohje. Pikërisht mangësia e njohjes është shkaktar i mangësisë në zuhd.

I shpjeguam gradat e zuhdit dhe dallimet mes tyre. Këto grada dallojnë edhe në vetvete, për shembull, durimi i zahidit në kohë të mira në krahasim me durimin në vështirësi është i ndryshëm. Edhe gradat e papëlqyshmërisë së zuhdit dallojnë. Edhe sipas arsyes pse personi braktisë diçka janë tri grada të zuhdit:

Grada e parë,

është kur arsyeja pse personi braktisë diçka është shpëtimi nga Zjarri dhe vuajtjet tjera, siç janë shpëtimi nga sprovat e varrit, llogaridhënies së vështirë, rreziqeve në urën e Siratit, dhe gjithçkaje tjetër që e pret robin, shpëtim nga të gjitha tmerret tjera për të cilat flasin transmetimet. Është thënë se kur njeriu do të japë llogari, aq shumë djersitet sa të ngopen puke pirë njëqind deve të etura. Ky është zuhdi i frikacakëve. Pasi shpëtimi nga dhimbja është i mundur vetëm me zhdukje, këta sikur janë të gatshëm të zhduken.

Grada e dytë,

është kur robi braktisë diçka për të fituar shpërblimin e Allahut, bereqetet e Tij dhe kënaqësitë e premtuara në xhennet – hyritë, pallatet dhe të tjera. Ky është zuhdi i atyre që shpresojnë në rahmetin e Allahut. Ata nuk e braktisin dynjallëkun duke u mjaftuar me skamje dhe me shpëtim, por e dëshirojnë jetën e përhershme me begati të përhershme, të cilat nuk kanë fund.

Grada e tretë,

është shkalla më e lartë. Kjo arrihet kur për robin dëshirë e vetme është Allahu dhe takimi me Të. Qëllim nuk është as shpëtimi nga dhimbja e shqetësimi, as arritja e kënaqësive, por qëllim të vetëm ka të jetë zahid për rizanë e Allahut. Ky është muvahidi i vërtetë, që nuk kërkon asgjë tjetër përveç Allahut. Kush kërkon diçka tjetër përveç Allahut, ai lidhet për atë që e kërkon. Të kërkosësh dikë tjetër përveç Allahut është një shirk i fshehtë. Ky është zuhdi i të dashuruarve (*zuhdul-muhibbin*). Këta janë arifët e vërtetë, sepse arifi nuk e do askënd përveç Allahut, ai e do atë që e ka njohur. Sikur një person që e do edhe arin edhe argjendin por e di që nuk mund t'i ketë të dyja; ai do të braktisë argjendin dhe do të preferojë arin. Kush e di kënaqësinë e shikimit në bukurinë e fytyrës së Allahut dhe e kupton se nuk është e mundur ta bashkojë atë kënaqësi me shikimin në hyritë, pallatat dhe pemët, ai preferon të shikojë bukurinë e Allahut duke hequr dorë nga gjithçka tjetër.

Assesi mos mendo se banorëve të xhenetit, pas shikimit në bukurinë (xhemal) e fytyrës së Allahut Teala, në zemra t'ju mbeten kënaqësitë e hyrive e pallateve. Karshi shikimit në bukurinë e Allahut (xhemal), kënaqësitë e xhenetit mbeshin si loja me një zog në krahasim me sundimin e gjithë botës.

Sipas arifëve, ata që braktisin bukurinë e Allahut Teala (*xhema*) dhe kërkojnë kënaqësitë e xhenetit janë si fëmijët që preferojnë të braktisin fronin mbretëror e të luajnë me zog. Ai fëmijë nuk e njeh pozitën mbretërore, prandaj preferon kënaqësinë e zogut.

Në këtë temë është thënë shumë; janë mbi njëqind mendime rreth kësaj, por ne nuk kemi për qëllim të transmetojmë mendime. Ne do të theksojmë vetëm një fjali, që përfshin të gjitha hollësitë, e që kështu të kuptohet se ajo që thuhet nuk e përfshin tërë çështjen.

Sipas kësaj themi se: ajo që braktiset me zuhd është e përmbledhur, por ka edhe detaje. Detajet kanë grada, siç ka grada edhe përmbledhja;

Grada e parë,

e përmbledhjes që duhet braktisur është të braktisësh gjithçka përveç Allahut, madje edhe veten.

Grada e dytë,

e përmbledhjes është të braktisë gjithçka që i jep kënaqësi nefsit, e që përfshin të gjitha epshet si zemërimi, mendjemadhësia, dashuria për pushtet, pasuria, pozita, etj.

Grada e tretë,

e përmbledhjes është të braktisë pasurinë dhe nderin, si edhe shkaqet që i sigurojnë ato, sepse rreth këtyre dyjave mbledhen të gjitha kënaqësitë tjera të nefsit.

Grada e katërt,

e përmbledhjes është braktisja e dijes, fuqisë, dukatëve, argjendit dhe pozitës. Sepse pa marrë parasysh sa ka lloje të mallrave, të gjitha ato përfshihen në ari, argjend dhe pozita. Dhe edhe pse ka shumë sebepe për t'i siguruar këto, dituria dhe fuqia i përfshijnë të gjitha ato sebepe. Me dituri dhe fuqi tregohen dituria dhe fuqia që synojnë të përfitojnë zemra. Sepse posti dhe pozita do të thotë të mbizotërosh zemrat dhe t'i marrësh nën komandën tënde. Edhe pasuri do të thotë të kesh pronë dhe ajo të jetë nën vullnetin tënd.

Ekziston frika se, edhe nëse hyjmë në më shumë hollësi, shumica e gjërave që duhet të braktisen akoma do të mbeten të papërfshira. Allahu Teala, në një ajet i përmend shtatë gjëra që duhet braktisur:

“Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të mirave, ndaj grave, fëmijëve, pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, por tek Allahu është e ardhmja më e mirë” 3-Ali Imran: 14,

e në ajet tjetër, pesë:

“Ju njerëz dijeni se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve...” 57-Hadid: 20,

e në një ajet tjetër i përmbledhë në dy:

“Vërtet, jeta e kësaj bote është vetëm lojë e dëfrim...”

47-Muhammed: 36,

e në një ajet tjetër të gjitha t’i përmbledhë në një:

**“E kush iu frikësua paraqitjes para Rabb-it të vet dhe e ka frenuar veten nga dëshirat e këqija (*heva*),
xhenneti është vendi i tij.”** 79-Naziat, 40, 41

Termi *heva*¹⁰⁰ i përmendur në këtë ajet përfshin të gjitha kënaqësitë e nefsit në dynja. Prandaj duhet larguar nga të gjitha. Kur i kupton dallimet në detaje si edhe dallimet e përmbledhura, e kupton se aty nuk ka kundërshti. Dallimet nganjëherë lindin te hollësitë, e nganjëherë te përmbledhja. Shkurtimisht, zuhd është braktisja e të gjitha dëshirave të nefsit.

Nëse personi braktisë dëshirat e nefsit, ka braktisë edhe gjithçka tjetër nga dynjallëku, prandaj edhe dëshira për jetë të gjatë do t’i pakësohet, pa kurrfarë dyshimi.

¹⁰⁰ **Heva**: dëshirë; kërkesë; zell; dëshirat e dëmshme dhe mëkatore të nefsit; dëshirat e këqija të nefsit; dëshirat boshe.

Njeriu dëshiron të qëndrojë në dynja që të kënaqet, dhe dëshiron që përgjithmonë të kënaqet me qëndrim në këtë dynja. Ai që dëshiron diçka, ai edhe dëshiron që ajo të vazhdojë. E të dëshirosh të jetosh nuk është asgjë më shumë sesa të duash vazhdimin e gjërave që ekzistojnë ose janë të mundshme në këtë jetë. Kur largohet prej tyre ai nuk e do as dynjanë. Prandaj, kur Allahu e bëri luftën të detyrueshme për ta, ata thanë:

" O Rabbi ynë, pse na e bëre obligim luftën? Sikur të na e kishe shtyrë deri në një afat të afërt!",

në çka Allahu Teala tha:

"Kënaqësitë e kësaj jete janë të vogla." 4-Nisa: 77,
demek, ju doni të qëndroni në botë për kënaqësinë e botës. Në këtë situatë, gjendja e të zahidëve dhe e hipokritëve u bë e qartë.

Sa për zahidët që e duan Allahun, ata luftuan në rrugën e Allahut të lidhur me njëri-tjetrin si gurë të qemerit, duke pritur një prej dy të mirave. Kur thirren në luftë, ata e nuhasin erë e xhenetit dhe sulmojnë në luftë si i eturi drejt ujit. Qëllimi i tyre është ta çojnë Islamin drejt fitores ose të bëhen shehidë. Ai prej tyre që vdiste në shtrat, vuante pse nuk është bërë shehid.

Njeri prej tyre është Halid ibn Velid r.a., të cilit kur iu afrua vdekja, sa ishte në shtrat, thoshte:

“Sa herë isha para rrezikut dhe turresha drejt radhëve të armikut duke dëshiruar aq shumë të bëhem shehid, e më shiko tash, po vdes me kokën në jastëk.”

Kur vdiq, në trup ia numëruan tetëqind shenja, si pasojë e plagëve të marra në lufta. Ja, kjo është gjendja e besimtarëve besnikë, Allahu Teala qoftë i kënaqur me të gjithë ata!

Nga ana tjetër, hipokritët lëshuan fushëbetejën nga frika e vdekjes. Atyre ju është thënë:

“S’ka dyshim se vdekja prej së cilës po ikni, ka për t’ju zënë...” 62-Xhuma: 8

Me dhënie përparësi jetës ndaj gradës së shehidit ndërrohet ajo që është e mirë me atë që është e keqe, e:

“Të tillët janë që e ndërruan të vërtetën (besimin) me të pavërtetën (mosbesimin), pra tregtia e tyre nuk pati fitim dhe ata nuk qenë të vetëdijshëm (në punën e tyre).”

2-Bekare: 16

Sa i përket të singertëve, Allahu e bleu jetën dhe pasurinë e tyre në këmbim të xhenetit. E kur ata të shohin se kanë heqë dorë nga kënaqësitë, për njëzet apo tridhjetë vite, për të përfituar kënaqësi të përhershme, do të gëzohen për këtë tregti.

Ja, ky është shpjegimi i arsyes pse personi braktisë diçka. Nëse e ke kuptuar këtë, e ke kuptuar që definicionet e zuhdit për të cilat teologët (*mutekellimun*) flasin, kanë të bëjnë vetëm me një pjesë të tij; teologu flet vetëm për atë që vet e ka përjetuar, ose për gjendjen e bashkëbiseduesit të vet.

Bishri, r.a., ka thënë:

“Zuhd në dynja është largimi prej njerëzve.” Kjo ka të bëjë vetëm me zuhdin në lidhje me pozitë.

Kasim el-Xhui ka thënë:

“Zuhd në dynja është zuhdi në lidhje me stomakun, prandaj nëse mund ta mbizotërosh stomakun tënd, je zahid” Këtu flitet për zuhdin e ndërlidhur me një prej epsheve. E pasha Allahun, pikërisht ky epsh është burim edhe për epshe tjera.

Fudajl b. Ijad ka thënë:

“Zuhd është mjaftueshmëria (kanaat).” Kjo ka të bëjë me zuhdin në lidhje me pronën.

Sufjan Sevri ka thënë:

“Zuhd është pakësimi i dëshirave. Kjo përfshin të gjitha epshet, sepse kush anon kah epshet, ai dëshiron jetë të gjatë, dhe pason mashtrimet. E ai që ka më pak dëshira, do të thotë se i ka braktisë epshet.”

Uvejs Karani ka thënë: *“Nëse zahidi kërkon, zuhdi e braktisë.”* Me këtë, Uvejsi, nuk ka dhënë definicion të zuhdit, por ka shprehur mbështetjen absolute në Allahun Teala (*tevekkul*), si kusht për zuhdin.

Uvejsi, gjithashtu ka thënë: *“Zuhd është braktisja e kërkimit, dhe mjaftueshmëria me atë që e ka.”* Kjo ka të bëjë me furnizimin (risk).

Kur disa dijetarë të hadithit thonë: *“Dynja është veprimi me mendje dhe logjikë ndërsa zuhd është dituria dhe përshtatja sunnetit”*; nëse mendojnë në gjykimet e gabuara të mendjes për të fituar një pozitë në botë, kjo është e vërtetë. Kjo gjithashtu është shenjë edhe për disa nga sebePET e pozitës. Sepse ka disa dituri nga të cilat nuk ka kurrfarë dobie në ahiret, e njerëzit aq shumë i kanë degëzuar, sa njeriu harxhon gjithë jetën e tij duke u marrë vetëm me një prej tyre. Për zahidin, kushti i parë është ta braktisë teprimin.

Hasan Basri ka thënë: *“Zahid është ai që, kur e takon dikë, thotë: ‘ky është më i mirë se unë’.”* Me këtë, Hasan Basriu na tregon se zuhdi është përulësi dhe e thekson refuzimin e pozitës dhe vetpëlqimit, që është një formë e zuhdit.

Dikush ka thënë: *“Zuhd është kërkim i hallallit.”* E tash, çfarë definicioni është ky nëse krahasohet me definicionin e Uvejsit, i cili ka thënë se zuhd është braktisja e kërkimit? Nuk ka aspak dyshim se Uvejsi nuk kishte për qëllim që të braktiset kërkimi i hallallit.

Jusuf ibn Esbat Shejbani thoshte: *“Kush i duron shqetësimet, braktisë epshet dhe ushqehet me kafshatë hallall, ai e ka gjetur esencën e zuhdit.”*

Për zuhdin është thënë më shumë se sa që ne transmetuam, por nuk po shoh arsye që tani t’i përmendim të gjitha. Kush dëshiron ta kuptojë të vërtetën (hakikat) e gjërave nga fjalët e njerëzve, do ta shohë se fjalët janë të ndryshme dhe vetëm do të hutohet. Por, kur kërkon që e vërteta t’i zbulohet në shpirtin e vet, që ta njohë atë përmes *mushahedes* së zemrës së vet, jo përmes asaj që e dëgjon nga të tjerët, ai i mbështetet fuqishëm të vërtetës.

Ai do ta njohë mangësinë e atyre, por edhe mangësitë në prezantimin e njohjes së plotë, sepse në qëndrimet e tyre janë kufizuar në nevojën lidhur me të cilën edhe kanë thënë diçka për zuhdin. Qëndrimet e tyre nuk janë të mangëta për shkak të mangësive të basiretit të tyre, por thjeshtë kanë folë vetëm për atë që në atë moment ka qenë nevoja të flitet. Prandaj edhe shpjegimet e tyre janë të kufizuara në atë kohë, në nevojën konkrete të atij rasti.

E nevojat dallojnë, prandaj padyshim që dallojnë edhe shpjegimet. Gjithashtu, arsyet për mangësi qëndrojnë edhe në informim të pamjaftueshëm për gjendjen momentale që e ka kapluar robin. E gjendjet janë të ndryshme, prandaj edhe shpjegimet janë të ndryshme. Përndryshe, e vërteta (*hak*) është një, dhe nuk ka mundësi as të mendohet se këtu ka mosmarrëveshje.

Fjalët e Sulejman Daranit i përmbledhin të gjitha këto qëndrime, edhe mos qoftë kjo në detaje:

“Për zuhdin kemi dëgjuar shumë fjalë. Për ne, zuhd është braktisja e gjithçkaje që largon prej Allahut Teala.”

Në një rast tjetër, duke shpjeguar pak më shumë, ka thënë: *“Kush martohet, udhëton për të siguruar jetesën ose shkruan hadithe, ai është i prirur kah dynjaja”*. Pra, të gjitha këto i ka pranuar si të kundërta me zuhdin dhe lexoi ajetin:

“Përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu.”
(26-Shuara: 89), e më pas tha: *“Kjo është zemra në të cilën nuk ka asgjë tjetër përpos Allahut Teala. Ata braktësn dynjallëkun që t’i zbrazin zemrat e veta nga brenga për të dhe t’i drejtohen ahiretit.*

Pra, këto janë pjesët e zuhdit në lidhje me gjërat që duhet të braktisen. E sipas rëndësisë, zuhdi ndahet në obligim (*farz*), vepër shpëtimtare (*selamet*) dhe vullnetare (*nafile*), siç e ka përshkruar Ibrahim Ed’hem.

Zuhd farz është largimi nga harami, zuhd selamet është largimi edhe nga gjërat e dyshimta, e zuhd nafile është largimi edhe nga hallalli. Kemi folë detajisht për gradat e takvasë (frika prej Allahut Teala) në *Librin për hallallin dhe haramin*. Edhe kjo është zuhd, siç e thotë Malik ibn Enes kur u pyet:

- *Çfarë është zuhdi?*, e ai u përgjigj:

- *Është takva.*

E në lidhje me gjërat e fshehura të cilat personi i braktisë, zuhdi nuk ka fund, sepse nuk kanë fund gjërat që i përfiton njeriu (nefsi) me të menduar. Vetëm dijetarët të vërtetë e dinë dyfytërsisë e fshehtësisë. Por, lëri ndjenjat e fshehura, as zuhdi i dukshëm nuk ka fund.

Bile, edhe gjendjet e jashtme kanë gradat e veta të zuhdit, të cilat nuk kanë fund. Një nga gradat më të larta të kësaj është zuhdi i Isasë, a.s., kur e vendosi kokën në gur dhe deshi të flejë, e më pas e largoi edhe gurin, vetëm pse i erdh shejtani e i tha: *“E dëshirove dynjallëkun.”*

Tregohet se Jahja b. Zekerija a.s., veshte rroba të vrazhda, që i shkaktonin plagë në trup, vetëm që të heqë dorë nga kënaqja në rroba të rehatshme e të mos zhytet në mirësitë e dynjasë. Nëna e tij një herë e luti që të veshë xhybe nga leshi, në vend të rrobave prej thesit, dhe Jahja, a.s., ashtu bëri. Atëherë Allahu Teala i shpalli:

- ***Jahja, i dhe përparësi dynjallëkut.*** Jahja, a.s., filloi të qajë, e hoqi xhyben dhe iu kthye asaj që kishte veshur më herët.

Ahmed b. Hanbel, ka thënë: *“Zuhd është zuhdi i Uveysit, r.a.. Vishej thjeshtë e ulej në një shportë të bërë nga kallami.”*

Isa, a.s., u ul në hijen e murit të dikujt. Pronari i murit erdhi dhe e largoi nga hija, e ai tha:

- *Nuk je ti ai që më çoi. Allahu më çoi, Ai, i Cili nuk është i kënaqur që unë të mbes nën hijen e murit tënd.*

Po kuptohet që ka aq shumë grada të zuhdit sa që nuk mund të numërohen, qoftë zuhd i dukshëm, apo i fshehtë. Grada më e vogël është braktisja e gjërave që janë të rrezikshme dhe të dyshimta. Bile disa kanë thënë: *“Zuhd është braktisja e hallallit, jo e asaj që është e rrezikshme ose e dyshimtë.”*

Por, kjo nuk përket në asnjë gradë të zuhdit. Disa thonë që tani në dynja nuk ka mbetur asgjë nga prona hallall prandaj zuhdi tashmë as nuk është i mundur.

Ti mund të thuash: *Nëse është e saktë se zuhd do të thotë braktisja e gjithçkaje përveç Allahut, si atëherë të kuptohet ushqimi, pija, veshja, shoqërimi dhe komunikimi me njerëz? Këto janë angazhim me diçka tjetër, përveç Allahut.*

Pra dije se, braktisja e dynjallëkut për Allahun do të thotë që zemra të kthehet drejt Allahut përmes dhikrit dhe meditimit, e kjo është e mundur vetëm duke jetuar. Ndërsa të jetosh është e mundur vetëm duke përmbushur nevojat e domosdoshme të nefsit. Sigurimi i nevojave të domosdoshme për jetën nuk është angazhim me diçka tjetër përveç Allahut. Ajo që duhet për të arritur qëllimin llogaritet pjesë e atij qëllimi; personi i angazhuar me nevojat e devesë rrugës për në haxh, nuk do të thotë se ai është larguar nga rruga e haxhit.

Edhe trupi yt në rrugën e Allahut duhet të jetë si deveja në rrugë për haxh; siç kujdesesh për devenë gjatë rrugës së haxhit për të t'dërguar në Qabe, edhe në rrugën e Allahut duhet të kujdesesh për trupin për të arritë në cak. Nuk ke nevojë ta ushqesh devenë tënde që ajo të kënaqet, përkundrazi, qëllim e ke që ta mbrosh devenë nga gjërat që mund ta shkatërrojnë plotësisht, që ajo të jetë në gjendje të të dërgojë te caku i dëshiruar. Kjo assesi nuk e kundërshton zuhdin, aq më shumë, është kusht i zuhdit.

Nëse ti thua: *Por unë marr kënaqësi prej ushqimit kur jam i uritur*, dije se kjo nuk të bën dëm nëse qëllimi yt nuk është ajo kënaqësi. Personi që pi ujë të ftohtë ndonjëherë atë ujë e konsideron të shijshëm, por qëllimi i tij është ta shuajë etjen. Çdokush që siguron nevojat e veta merr kënaqësi nga kjo, por kënaqësia nuk është qëllim; qëllim është sigurimi i nevojave. Për këtë, zemra nuk drejtohet kah ajo kënaqësi. Për shembull, kur dikush çohet të falë namazin e natës, atij zemra i merr kënaqësi edhe nga ajri i natës e cicërimat e zogjve, por meqenëse qëllim është ibadeti i natës, kjo kënaqësi nuk do ta dëmtojë. Prapë se prapë, disa nga të devotshmit zgjedhnin një vend të mbyllur, në mënyrë që një kënaqësi e tillë të mos ndërhyjë në ibadetin e tyre.

Për këtë arsye Davud Tai kishte një enë të hapur sipër, e në të mbante ujin për pije dhe kurrë nuk e largonte nga dielli. Pinte ujë të nxehtë, e thoshte: *“Kush ndjenë kënaqësi duke pirë ujë të ftohtë, do ta ketë të vështirë ndarjen nga dynjallëku.”*

Kjo është frika e atyre që janë të kujdesshëm, e nga të gjithë kërkohet të mos braktisin kujdesin. Edhe pse kjo është e vështirë, kohëzgjatja është shumë e shkurtër, në krahasim me bekimet e përjetshme. Kjo nuk ishte e vështirë për arifët, për ata që nefsin e vet e edukuan me sheriat, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata.

SHPJEGIM I DETAJUAR I ZUHDIT TE NEVOJAT E JETESËS

Dije se njerëzit ndahen në ata që merren me gjërat e tepërta në jetë dhe në atë që merren me të domosdoshen. Në gjëra të tepërta për shembull, llogariten kuajt e bukur, sepse shumica e njerëzve i mbanë ata që të kënaqen duke i kalëruar, derisa mund edhe të ecin. Të domosdoshme janë ushqimi dhe pija. Ne nuk jemi në gjendje të përmendim në detaje të gjitha gjërat e tepërta në jetë, ato nuk kanë fund. Do të kufizohemi në gjërat e domosdoshme. Edhe gjërat e domosdoshme mund të bëhen të tepërta, varësisht sasisë, llojit dhe kohës, prandaj e kemi me rëndësi të sqarojmë aspektin e zuhdit që ndërlidhet me to.

Gjëra të domosdoshme janë gjashtë: ushqimi, pija, banimi dhe shtëpia, martesë, pasuria dhe reputacioni, të cilat kërkohen për arsye të ndryshme. Në *Librin për dyfytyrësi (Kitabul-rija)* e kemi shpjeguar kuptimin e reputacionit (*xhah*), arsyen që dërgon në dashuri ndaj krijesave, dhe mënyrën e mbrojtjes nga kjo. Tani le të përpiqemi t'i shpjegojmë vetëm domosdoshmërinë e këtyre gjashtë gjërave:

Ushqimi

Domosdoshmëria e parë është ushqimi. Njeriu duhet të sigurojë ushqim të lejuar (hallall), aq sa i mjafton që të ecë drejt. Por, që zuhdi i tij të jetë i plotë, edhe kjo ka një kufi, e që ndërlidhet me vet jetgjatësinë, në rastin kur sigurimi i ushqimit për vetëm një ditë nuk e kënaq. Bollëku në ushqim ndërlidhet edhe me kohën e konsumimit, e shpëtimi nga kjo arrihet vetëm me shkurtimin e dëshirës për jetë të gjatë.

Këtu grada më e lartë e zuhdit është të hajë aq sa i nevojitet që të shuajë urinë, kur përballet me rrezikun e vdekjes ose sëmundjes. Ata që janë në këtë gjendje, nëse gjejnë ushqim në mëngjes nuk mendojnë për mbrëmjen dhe nëse gjejnë ushqim në mbrëmje nuk mendojnë për mëngjesin. Kjo është grada më e lartë e zuhdit. Grada e dytë është që personi të sigurojë ushqim për një muaj, ose për katërdhjetë ditë. Grada e tretë është që personi të sigurojë ushqim për një vit. Kjo është grada e zahidëve të dobët, e kush siguron ushqim për më shumë se një vit, është pa vend ta quajmë atë zahid. Sepse, shpresa për të jetuar më gjatë se një vit është dëshirë e pabazuar. Prandaj është e paimagjinueshme që një person i tillë të jetë zahid.

Që të jetë zahid, ai nuk duhet të ketë përfitime tjera e as të dëshirojë të lypë. Si Davud-i Tai. Ai i trashëgoi njëzet dukatë, e i harxhoi për njëzet vite. Kjo nuk është në kundërshti me esencën e zuhdit, por për ata që e pranojnë tevekkulin si një kusht të zuhdit, mund të jetë.

Nga ana tjetër, bollëku në ushqim ka të bëjë me sasinë. Sasia më e vogël e racionit është që për njëzet e katër orë të konsumohet gjysmë *ratl*¹⁰¹ ushqim. Sasi mesatare është një *ratl*, e sasia më e madhe është një *mudd*, të cilën Allahu Teala e ka caktuar si sasi me të cilën duhet ushqyer fukaratë miskinë, dhe si keffaret për betimin dhe agjërimin.

Përtej kësaj është zgjerimi i stomakut dhe angazhimi me të. Atij që nuk i mjafton një mudd, ai nuk ka nasib në zuhd për shkak të stomakut.

Sa për llojin e ushqimit, grada më e ulët është të hahet gjithçka që llogaritet ushqim, qoftë edhe bukë nga krundet. Grada e dytë është të hajë bukë nga elbi dhe misri, e grada e tretë është të hajë bukë nga gruri i pa situr. Nëse është i situr dhe bëhet miell i bardhë, kjo veç kalon në ëmbëlsi e kjo jo që nuk është grada më e lartë e zuhdit, por edhe del prej kufijve të tij.

¹⁰¹ Një *ratl*, në Egjipt është 449,28 gramë, në Siri 3,202 kilogramë e në Bejrut e Haleb 2,566 kilogramë.

Sa për mëlmesat (*udm*), më e pakta është kripa, perimet ose uthulla, gradë e mesme është vaj ulliri, ndërsa grada e tretë është mish, çfarëdo lloji, e mund të hahet një ose dy herë në javë. Nëse ha mish çdo ditë ose më shumë se dy herë në javë, del nga kufijtë e zuhdit, e personi që ashtu ushqehet, nuk llogaritet zahid, për shkak të stomakut të tij.

Sa për kohën e ushqimit, grada më e ulët është të hajë një herë në njëzet e katër orë, pra, agjëron me një iftar. Grada e mesme është kur agjëron, por në iftar pi ujë e nuk ha ushqim, ose ha ushqim por nuk pi ujë. Grada e tretë është një iftar në tri ditë ose në javë, e mund të zgjasë edhe më shumë. Për mënyrën e pakësimit të ushqimit dhe parandalimin e grykësisë kemi folë në pjesën RUB’U’L-MUHLIKAT.

Duhet të shikohet gjendja e Resulallahut, s.a.v.s., dhe as’habëve, r.a., se çfarë ishte zuhdi i tyre në lidhje me të ushqyerit dhe braktisjen e mëlmesave. Ajshe, r.anha, ka treguar: *“Bëheshin edhe katërdhjetë netë pa u ndezë në shtëpinë e Resulallahut, s.a.v.s., as qiri, as zjarr.”*

- *Pra, si jetonit?*; pyeti dikush, e Ajshe, r.anha, tha:

- *Me hurme e ujë.*

Të jetuarit e tyre vetëm me hurme e ujë do të thotë braktisje e mishit, çorbës dhe mëlmesave.¹⁰²

¹⁰² Ibn Maxhe nga Ajshe, r.anha.

Hasan Basriu ka thënë: *“Resulallahu, s.a.v.s., udhëtonte mbi gomar, veshte rroba të leshta, arnonte sandalet, i lëpinte gishtat e vet dhe hante në tokë. Thoshte:*

- Unë jam rob, ha si rob, ulem si rob.”¹⁰³

Isa, a.s., popullit të vet i tha: *“Po ju them të vërtetën; kush dëshiron xhenetin-firdevs, për të janë buka e elbit dhe gjumi në mbeturina, me qentë.”*

Fudajli ka thënë: *“Resulallahu, s.a.v.s., prej se mbërrijti në Medine, nuk hëngri bukë gruri, tri ditë me radhë.”*¹⁰⁴

Isa, a.s., ka thënë: *“O bijtë e Izraelit! Pini ujë të pastër, hani perime të egra nga shkretëtira dhe bukë elbi! Largohuni nga buka e grurit; sepse nuk jeni në gjendje të jeni mirënjohës për të”.*

Tashmë i kemi përmendur veprimet e pejgamberëve, a.s., dhe të gjeneratës së parë të myslimanëve lidhur me ushqimin dhe pijet, në pjesën RUB’U’L-MUHLIKAT, prandaj nuk do të përsërisim.

Kur Resulallahu, s.a.v.s., erdhi në Kuba, banorët atje i sollën një gotë qumësht të përzier me mjaltë. Resulallahu, s.a.v.s., e lëshoi gotën nga dora, e tha:

¹⁰³ Hadithin e tregon Ajshe, r.anha, dhe tashmë është përmendur.

¹⁰⁴ Hadithi tashmë është përmendur.

“Nuk po them se është haram, por po e lë nga përlësia ndaj Allahut Teala.”¹⁰⁵

Në një ditë të nxehtë vere, Omerit, r.a., i ofruan një gotë ujë të ftohtë me mjaltë, e ai tha:

- Largojeni këtë nga unë, të mos jap llogari edhe për këtë!

Jahja ibn Muadh Razi ka thënë: *“Për zahidin e singertë ushqim është çfarëdo që gjen, rroba i ka çfarëdo që ia fshehë avretin, e shtëpinë e ka kudo që të jetë. Kjo botë për të është burg, shtrat e ka varrin, shoqërimi i tij është vetmimi (halvet), mendimi i tij është nxjerrje e mësimi, të folurit e tij është me Kur’an, Rabbin e vet e ka bashkëbisedues të afërt, e dhikri është miku i tij. Zuhdin e ka bashkudhëtar, pikëllimin e ka famë, turpërimin e ka tipar dallues, uria është mëlmesë e tij, të folurit e tij është urtësi, shtrati i tij është dheu, ushqimi i tij është devotshmëria, heshtja është fitimi, durimi është përkrahje për të, mbështetja e plotë Allahut Teala (tevvikul) i mjafton atij, mendjen e ka udhëzues, ibadetin e ka zanat, e xhennetin qëllim final, nëse dëshiron Allahu.”*

¹⁰⁵ Hadithi tashmë është përmendur.

Veshja

Domosdoshmëria e dytë është veshja. Më e pakta e saj është veshja që mbulon vendin e avratit dhe mbron personin nga nxehtësia dhe të ftohtit, e kjo është një veshje që mbulon të gjithë trupin (këmishë e gjatë). E mesme (e kësaj) është këmishë, kapelë ose shami, dhe sandale. E teprim në zuhd është shallvare dhe faculetë. Gjithçka që e kalon këtë sasi, i kalon kufijtë e zuhdit. Kusht i zuhdit është që, kur e pastron rrobën, pret në shtëpi derisa të thahet, për shkak se nuk ka tjetër. Nëse i ka dy këmisha, dy shallvare ose dy faculeta, tejkalon tërë kufirin e modestis për nga sasia.

Sa për llojin, më e pakta është veshja prej pëlhure të trashë, mesatare është veshja prej leshit të vrazhdë, e teprim është veshja prej pambuku të trashë.

Sa për kohën, më e gjata është që mund t'i bartë për një vit, e më e shkurta është që mund të qëndrojë për një ditë. Bile, disa për t'u mbuluar, janë mundu të bëjnë veshje prej gjetheve të pemës. E mesme është veshja që mund të zgjasë rreth një muaj.

Nëse kërkohet një veshje që do të zgjasë më shumë se një vit, kjo është në kundërshtim me zuhdin dhe është synim i kotë.

Por nësë blen pëlhurë të trashë dhe të fortë, që është shumë e qëndrueshme, kjo nuk do ta dëmtojë. Kush ka më shumë se kaq, tepricën duhet ta japë për sadaka. Nëse e mbanë, nuk është zahid, por është i dashuruar pas dynjasë. Resulallahu, s.a.v.s., dhe as'habët, r.a., duhet të merren shembull se si ata i braktisën rrobat e tepërta. Ebu Berde tregon: *“Ajsha, r.anha, na tregoi një palë veshje, të sipërme e të poshtme, që ishin të trasha dhe të vrazhda, dhe tha:*

- Resulallahu, s.a.v.s., e ka dorëzuar shpirtin e tij në këto dy rroba!

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Allahu Teala e do personin që nuk i jep rëndësi se çfarë rroba veshë.”¹⁰⁶

Amr b. Esved Ansi ka thënë: *“Kurrë nuk veshi rroba të shtrenjta, kurrë natën nuk flej mbi dyshek, kurrë nuk hipi në kalë revan dhe kurrë nuk e mbushi barkun me ushqim.”*

Omeri, r.a., ka thënë: *“Kush dëshiron ta shohë kostumin e dhëndërisë së Resulallahut, s.a.v.s., le ta shikojë Amr ibn Esvedin.”*

Në transmetim thuhet:

¹⁰⁶ Dejlami në ‘Musned-i Firdevs’ nga Jakub ibn Utbe ibn Mugire, e ai nga Ebu Hurejre. Shënon edhe Ibn Nexhxhar në veprën *Tarih*.

“Kushdo që vesh rroba të zbukurara, Allahu Teala nuk e shikon derisa t’i heqë ato rroba, edhe nëse është i dashuri i Allahut Teala.”¹⁰⁷

Resulallahu, s.a.v.s., bleu një kostum për katër dërhëmë. Edhe vlara e dy rrobave të tij ishte dhjetë dërhëmë, *izarin* e kishte të gjatë katër *zira* e gjysëm.

Resulallahu, s.a.v.s., kishte blerë shallvare për tre dërhëmë. Kishte një lloj veshje të bardhë nga leshi, që përbëhej nga dy pjesë, e sipërme dhe e poshtme, e që quhej ‘*hule*’. Kishte edhe dy ‘*burde*’ (pulovër) nga Jemeni. Është shënuar se këmisha e Resulallahut, s.a.v.s., ishte si këmisha e ndonjë zezaku.

Një ditë, Resulallahu, s.a.v.s., veshi një palë rroba nga mëndafshi, qëndisur me argjend, vlara e të cilave ishte dyqind dërhëmë. As’habët e tij, r.a., i preknin rrobat, dhe pyesnin me habi:

- *O Resulallah, a prej xhennetit të erdhi kjo?!*

Rrobat i kishte dhuratë nga Mukavkisi, mbret i Aleksandrisë. Pastaj Resulallahu, s.a.v.s., i hoqi ato rroba dhe ia dërgoi një mushriku, e më pas e ndaloi për meshkujt veshjen e mëndafshit dhe atllasin (pëlhurë e mëndafshtë).

¹⁰⁷ Ibn Maxhe, nga ebu Dherr, me zinxhir të mirë (*xhejjid*).

Thuajse i kishte veshur për të theksuar ndalesën e tyre siç e vendosi një herë unazën nga ari në gisht, e më pas e hoqi, dhe ia ndaloi atë besimtarit, dhe ashtu siç i tha Ajshes, r.anha, për Beriren:

- Kushtëzoje familjen e saj që ty të të takojë e drejta e mbrojtjes së saj.¹⁰⁸

Më pas Resulallahu, s.a.v.s., u ngrit në minber dhe i ndaloi këso veprimesh, siç e lejoi martesën e *mut'a*, e më pas e ndaloi, që të theksojë rëndësinë e martesës.

Resulallahu, s.a.v.s., po falte namaz, e veshur kishte një xhybe të qëndisur. Kur dha selam, tha:

“Dërgojani Ebu Xhehmit, sepse më pengoi në namaz, e më sillni nga ai xhyben e leshtë të paqëndisur.”¹⁰⁹

Një herë Resulallahu s.a.v.s., kërkoi t'i vendosin rrip të ri në sandale, e më vonë gjatë namazit e shikoi si duket rripi, e pas kësaj kërkoi që ta heqin e t'i vendosin prapë rripin e vjetër.¹¹⁰

¹⁰⁸ Berira ishte e mbrojtur prej ensarëve, dhe një kohë i shërbeu Ajshes, r.anha.

¹⁰⁹ Hadithi tashmë është përmendur në *librin* 'Fshehtësit e namazit'

¹¹⁰ Hadithi është përmendur..

Një ditë Resulallahu, s.a.v.s., vendosi në gisht unazë të arit. Sa ishte në minber shikoi në të, dhe e hodhi, dhe tha:

“Ma tërhoqi vëmendjen. Shihja herë atë, herë juve.”¹¹¹

Një herë, Resulallahu, s.a.v.s., veshi sandale të reja dhe po i pëlqente pamja e tyre. Më pas ra në sexhde, e tha:

“Më mahniti bukuria e tyre, prandaj u përula para Rabbit tim, nga frika se do të më urrejë për këtë”, e pastaj i zbathi dhe ia dhuroi fukarasë së parë që e takoi.¹¹²

Sehl b. Sad ka treguar se i kishte qepur Resulallahut s.a.v.s., një xhybe prej leshit të enmarit dhe i kishte bërë astarin nga bezi i zi. Pasi e veshi, Resulallahu s.a.v.s., tha:

- *Shikoni sa i bukur dhe sa i butë.*

Në atë çast, njëri nga beduinët u ngrit dhe tha:

- *O Resulallah (s.a.v.s.), ma fal mua atë xhybe.* E kur është kërkuar diçka prej Resulallahut s.a.v.s., ai nuk refuzonte kurrë. Menjëherë e zhveshi xhyben dhe ia dhuroi dhe porositi një të re. Deri sa ishte duke iu qepur xhybeja Resulallahu s.a.v.s., kaloi në botën e përjetshme.¹¹³

¹¹¹ Hadithi tashmë është përmendur.

¹¹² Hadithi tashmë është përmendur.

¹¹³ Ebu Davud dhe Taberani, nga Sehl ibn Sa'd. Por pjesa “porositi një të re” nuk është në këtë transmetim.

Xhabiri ka treguar: “Resulallahu. s.a.v.s., hyri te Fatimeja, r.anha, e cila po bluante miell, e veshur kishte një fustan të bërë me lesh deveje. Kur e pa, Resulallahu, s.a.v.s., filloi të qajë, e tha:

- Oj Fatime, shijo dhimbjen e kësaj bote, që të fitosh mirësitë e përjetësisë.

Atëherë Allahu Teala shpalli ajetin:

“E Rabbi yt do të të japë ty, e ti do të kënaqesh!”

(93-Duha: 5)”¹¹⁴

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Më njoftuan nga Mela-i A’la se në ummetin tim është një grup i hairit që, para të tjerëve buzëqeshin, nga rahmeti i Allahut, por fshehtas qajnë, nga frika e dënimit prej Tij. Nuk i ngarkojnë të tjerët, por e ngarkojnë veten. Bartin rroba të vjetra dhe pasojnë zahidët. Trupat i kanë në tokë, e zemrat te Arshi.”¹¹⁵

Ja, kjo ishte mënyra e veshjes së Resulallahut, s.a.v.s.. Ummetin e vet e porositi që ta pasojnë, duke thënë:

“Ai që më do, le të veprojë sipas sunnetit tim.”¹¹⁶

¹¹⁴ Shënon Ebu Bekr ibn Lal, në veprën ‘Mekarim-ul-Ahlak,’

¹¹⁵ Shënojnë Hakimi dhe Bejheki.

¹¹⁶ Hadithi është përmendur në Librin ‘Rregullat e jetës martesore’.

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Pasoni sunnetin tim dhe sunnetin e halifëve të drejtë që vijnë pas meje dhe përqafoni këto me të gjithë forcën tuaj.”¹¹⁷

Allahu Teala ka thënë:

“Thuaj (o Muhammed!): *Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t'ju dojë..*” 3-Ali Imran: 31

Resulallahu, s.a.v.s., e porositi Ajshe, r.anha:

“Nëse dëshiron të takohesh me mua, mos u shoqëro me gratë e të pasurve, e rrobat mos i hudh deri sa të vjetërohen.”¹¹⁸

Alia, r.a., në rrobat e Omerit, r.a., numëroi dymbëdhjetë arnime, disa nga lëkura.

Alia r.a., sa ishte halife, bleu rroba për tre dërhëmë. I preu dy mëngët deri te kyçi i dorës e vetëm pastaj i veshi, edhe pse ishte halife, duke thënë: *“E falënderoj Allahun Teala që më zbukuroi me këto rroba të bukura.”*

Sufjan Sevri dhe disa të tjerë, kanë thënë: *“Vesh rroba që s'bien në sy mes dijetarëve por që as nuk do të jenë arsye të të përçmojnë të padijshmit.”*

¹¹⁷ Ebu Davudi, Tirmidhiu, që e cilëson sahih, dhe Ibn Maxhe, nga Irbad ibn Sarij.

¹¹⁸ Tirmidhiu, dhe e vlerëson si hadith garib, dhe Hakimi, që e cilëson si hadith të besueshëm (*sahih*), nga Ajshe, r.anha.

Sufjan Sevri gjithashtu ka thënë: *“Nëse një i varfër kalon para meje deri sa jam në namaz, do ta lëshoja. Por nëse kalon dikush nga njerëzit e dynjallëkut, e me rroba të shtrenjta, nuk do të më vinte mirë, dhe nuk do ta lëshoja.”*

Dikush ka thënë: *“Vlera e rrobave dhe sandalave të Sufjan Sevrisë ishte një dërhëm e katër danikë.”*

Ibn Shubruma ka thënë: *“Më e mira e veshjes është ajo që më shërben, dhe më e keqja e veshjes është ajo që unë i shërbej asaj.”*

Dikush nga gjenerata e parë e myslimanëve ka thënë: *“Vesh rroba me të cilat mund të përzihehesh mes popullit, e mos i vesh ato me të cilat të del zëri, e të shikojnë.”*

Sulejman Darani ka thënë: *“Ka tri lloje rrobash: rrobat për rizanë e Allahut, e kjo është ajo që i mbulon pjesët e turpshme të trupit (avret); rrobat për kënaqësinë e vet, e që janë rrobat e buta, dhe rrobat për njerëzit, e ato janë pëlhura tërheqëse e me shkëlqim.”*

Dikush ka thënë: *“Ai që ka veshje të hollë, edhe fenë e ka të hollë!”*

Vlera e rrobave të dijetarëve taibinë ishte mes njëzet dhe tridhjetë derhemë. Elita (*havas*) mes tyre veshte vetëm dy pjesë, që përbëhej nga një këmishë dhe një izar, e nganjëherë, me një qoshe të këmishës e mbulonin edhe kokën.

Dikush nga gjenerata e parë e myslimanëve (*selef*) ka thënë: *“Fillimi i ibadetit është veshja.”*

E në një transmetim thuhet:

“Veshja e rrobave të thjeshta (pa vlerë) është nga besimi (iman).”

Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet:

“Për një person që nuk vesh rroba të zbukuruara me qëllim që kështu të tregojë përvulje ndaj Allahut Teala, ani se mund t’i ketë ato, Allahu Teala kujdeset që ai person të veshë rrobat më të bukura, të qëndisura me perla të xhenetit.”

Allahu Teala i shpalli njërit prej pejgamberëve të Tij:

“Thuaju miqve të mi: Le të mos i veshin rrobat që i veshin armiqtë e mi. Le të mos hyjnë atje ku hyjnë armiq të e mi! Përndryshe edhe ju bëheni armiq të Mi, njëjtë si ata.”

Rafi ibn Hadixh e pa Bishr ibn Mervan duke mbajtë vaiz në minberin e xhamisë në Kufa, dhe tha: *“O xhemat, shikoni emirin (sundimtarin) tuaj! Ju mban vaiz, e ka veshë rroba të pabesimtarëve.”* Ibn Mervan kishte veshur rroba të holla.

Abdullah ibn Amir ibn Rebia shkoi te Ebu Dherr, veshur me rroba të reja, e filloi të flasë për zuhd. Ebu Dherr ia vendosi shuplakën në gojë, dhe e ndaloi. Ibn Amir u zemërua, dhe u ankua te Omeri, r.a., e Omeri i tha:

- Ti ia solle këtë situatë vetes. Si flet për zuhd në prani të Ebu Dherit, veshur me këso rroba!

Alia, r.a., ka thënë: *“Allahu Teala e mori fjalën nga imamët e udhëzimit për të zbritur në nivelin më të ulët të njerëzve. Në këtë mënyrë edhe të pasurit ju përshtaten atyre e edhe të varfrit nuk fyhen nga varfëria e vet!”*

Kur e qortuan Alinë r.a., për veshjen e tij të vrazhdë, ai tha: *“Kjo veshje është modeste dhe e përshtatshme që myslimanët të më përshtaten.”*

Resulallahu, s.a.v.s., e ndaloi kënaqjen e nefsit, duke thënë:

“Allahu Teala ka robë të tillë që nuk zhyten në kënaqësi, zbukurime dhe argëtime.”¹¹⁹

¹¹⁹ Ahmed, nga Muadhi, e tashmë është përmendur.

E panë Fedala ibn Ubejd sa ishte guvernator në Egjipt, i arnuar e këmbëzbathur, e dikush i tha:

- *Ti je guvernator, e kështu të dukesh?!; e ai u përgjigj:*

- *Resulallahu, s.a.v.s., na ka ndaluar të stolisemi, e na ka urdhëruar që nganjëherë të ecim zbathur.*

Alia, r.a., i tha Omerit, r.a.:

- *Nëse dëshiron të marrësh pjesë në shoqërinë e dy shokëve tu (Resulallaut s.a.v.s., dhe Ebu Bekrit) vish këmishë të arnuar, lëre jakën e këmishës të jetë e ulët, sandalat të jenë të vjetra, dhe mos ha shumë.*

Omeri, r.a., ka thënë: *“Vishuni me modesti, dhe ruajuni mirë nga mënyra e veshjes së të huajve – të pasurve nga Persia e Kajseri!”*

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Ata që kënaqen me ushqim të llojlojshëm dhe flasin me arrogancë janë më të këqijnjtë e ummetit tim”¹²⁰, dhe

“Veshja e besimtarit është deri te gjysma e pjesës nën gju, e nuk ka të keqe të jetë e gjatë deri te zogu i këmbës. Nëse lëshohet më poshtë e i shkon zvarrë për tokë, ai është në xhehenem. Në ditën e Gjykimit Allahu Teala nuk do ta shikojë atë që veshjen e vet e tërhjekë zvarrë për tokë nga mendjemadhësia.”¹²¹

¹²⁰ Taberani nga Ebu Uname.

¹²¹ Maliki, Ebu Davud, Nesai dhe Ibn Hibban nga Ebu Seid.

Sulejman Darani ka treguar se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Askush nga ummeti im, përveç hipokritëve dhe budallenjve, nuk vesh gëzof.”

Evzai ka thënë: *“Të veshen rroba të leshta gjatë udhëtimit, është sunnet. E të veshen në shtëpi, është bidat.”*

Muhammed ibn Vasi erdhi te Kutejbe ibn Muslim, veshur me xhybe të leshtë. Kutejbe i tha:

- *Çfarë është ajo që të detyroi të veshësh këtë pallto shajaku?* Ibn Vasi heshti, e Kutejbe përsëri iu drejtua:

- *Po të pyes diçka, e nuk po më përgjigjesh?!*

Atëherë Ibn Vasi tha:

- *Nuk dua të them “Arsye është zuhdi”, e me këtë ta lavdëroj veten, e as nuk dua të them “Arsye është varfëria”, e me këtë t’i ankohem Rabbit tim. Për këtë arsye e zgjodha heshtjen.*

Ebu Sulejmani Darani ka thënë: *“Kur Allahu Teala e zgjodhi Ibrahimin, a.s., për mik të singertë (halil), i shpalli:*

- ***Fshehi pjesët e tua të turpshme (avret) edhe nga toka!*** Ibrahim i a.s., kishte një palë rroba. Por ai mbante dy palë shallvare në mënyrë që të mos shihej kur ishte vetëm. Kur e lante njërin, i veshte tjerat, që në secilin moment vendet e turpshme t’i ketë të fshehura.”

E pyetën Selman Farisinë:

- *Pse nuk veshë rroba të bukura?*; e Selmani u përgjigj:

- *Çka i duhet robit të veshë rroba të bukura? Kur të shpëtojë nga Zjarri, pasha Allahun, do të ketë vetëm një palë rroba, që kurrë nuk do t'i vjetrohen.*

Tregohet se Omer ibn Abdulaziz kishte xhybe dhe tesha nga lëkura. I veshte vetëm natën, kur ngritej për namaz. Hasan Basri i tha Ferkad b. Jakub es-Sebhiut:

- *A mendon se je më i mirë se njerëzit tjerë për shkak të rrobave tua? Unë jam informuar se kjo është veshja e shumicës së banorëve të xhehenemit.*

Jahja ibn Mein ka treguar: “*E pashë Ebu Muavi Esvedin si e mori copa të vjetra rrobash nga bërllogu, i lau, i shkurtoj, dhe i veshi. Unë i thashë:*

- *Mund të veshësh më mirë se kjo; e ai tha:*

- *Fatkeqësitë që i godasin në dynja, nuk do t'i dëmtojnë ata. Allahu do t'ju kompenzojë secilën vështirësi me xhennet.* Jahja ibn Main e tregonte këtë, e qante.

Banimi

E treta që është e domosdoshme është shtëpia. Zuhdi edhe këtu i ka tri gradë.

Grada më e lartë është që personi të mos dëshirojë ndonjë vend të caktuar për banim, por të mjaftohet me hapësirat e xhamive, siç vepronin *as'habus-suffa*.

Grada e dytë është të kërkojë një vend për të jetuar; ndonjë kallamishte apo diçka të ngjashme. E grada më e ulët e zuhdit për këtë çështje është nëse kërkon që ta blejë, ose ta marrë me qira, një shtëpi të ndërtuar. Nëse hapësira e vendit ku jeton i mjafton për nevojat e veta, dhe nëse aty nuk ka ndonjë zbukurim të veçantë – posedimi i një shtëpie të këtillë është në kufijtë e gradës më të ulët të zuhdit. E nëse dëshiron ta zgjerojë hapësirën, t'i suvatojë muret, ta ngrisë tavanin përmbi gjashtë krahë, atëherë del plotësisht jashtë kufirit të zuhdit.

Dallimet mes materialeve të ndryshme nga të cilat shtëpia është ndërtuar; a është nga llaçi, kallami, balta apo tullat, dallimi në gjerësi apo ngushtim, pastaj dallimi në lartësi, dhe krahasuar në kohë të ndryshme, dallon përshtatshëm statusit të personit – a është pronar i atij vendbanimi, apo vetëm është strehuar aty, apo e ka marrë me qira. Për secilën prej këtyre gjendjeve ka edhe kufij të caktuar të zuhdit.

Shkurtimisht, ajo që kërkohet për plotësimin e nevojave, nuk duhet t'i kalojë kufijtë e nevojave të domosdoshme, e nevoja të domosdoshme janë ato që i shërbejnë fesë, e ndihmojnë atë. Gjithçka që tejkalon këtë është në kundërshtim me fenë. Qëllimi i shtëpisë është që njeriu të mbrohet nga i ftohti, nxehtësia, shiu, nga shikimet e të huajve dhe rreziku.

Po dihet grada më e ulët e zuhdit në këtë çështje, e gjithçka përtej kësaj është teprim, e secili teprim sigurisht që është dynjallëk. Ai që e kërkon tepricën dhe mundohet në atë drejtim, është shumë larg nga kategoria e zuhdit. Thuhet se gjurma e parë e dëshirës për jetë të gjatë pas vdekjes së Resulallahut, s.a.v.s., te njerëzit u lajmërua në qepjen e rrobave dhe ndërtimet e forta. Në një transmetim thuhet:

“Do të vijë koha kur njerëzit do t'i qëndisin rrobat e tyre, ashtu siç janë të qëndisur gëzofët nga Jemeni.”¹²²

Resulallahu, s.a.v.s., i urdhëroi Ibn Abbasit, r.a., që ta rrënojë çardakun që e ndërtoi të lartë.¹²³ Një ditë, Resulallahu, s.a.v.s., po kalonte pranë një ndërtese me kupollë të lartë. Resulallahu, s.a.v.s., pyeti:

¹²² Sejjid Murteda thotë se hadithin e shënon Ebu Talib Mekki në veprën *Kutul-kulub*.

¹²³ Taberani, nga Ebu el-Alija. Është hadith *munkati*.

- E kujt është kjo?

- E filanit; thanë ata.

Kur ai person erdhi në prani të Resulallahut, s.a.v.s., ai ia ktheu shpinën, që më parë nuk kishte ndodhur. Personi i pyeti as'habët për këtë, e ata i treguan. Personi shkoi dhe e rrënoi atë kupollë. Pas një kohe Resulallahu, s.a.v.s., prapë kaloi pranë të njëjtës shtëpi, por nuk e pa kupollën, pyeti se çfarë kishte ndodhur, e as'habët i treguar. Resulallahu, s.a.v.s., bëri dua për atë as'hab.

Hasan Basriu ka thënë: *“Resulallahu, s.a.v.s., vdiq, e kurrë nuk ka vendosur një çërpik mbi tjetrin, as një kallam mbi tjetrin.”*

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur Allahu ia dëshiron të keqen robit, bën që ai ta shkapërderdh pasurinë e tij në ujë dhe baltë.”¹²⁴

Abdullah ibn Omer, r.a., ka treguar: *“Një ditë po riparonim një kasolle prej kallamit. Resulallahu, s.a.v.s., erdhi, dhe na pyeti:*

- Çfarë po bëni? Ne i thamë:

- Po e riparojmë këtë kasolle prej kallamit. E Resulallahu, s.a.v.s., na tha:

- Mendoj se keni punë më të rëndësishme se kjo.”¹²⁵

¹²⁴ Ebu Davud, nga Ajshe, r.anha, me zinxhir të mirë të transmetuesve (xhejjid).

¹²⁵ Ebu Davud, Tirmidhi, që e cilëson si hadith sahih, dhe Ibn Maxhe.

Nuhi, a.s., e ndërttoi për vete një kasolle nga kallami e dikush i tha se është dashur ta bëjë me çërpiqë e Nuhi, a.s., tha: *“Edhe kjo është shumë, për atë që do të vdes”*.

Hasan Basriu ka treguar: *“Shkuam te Safvan ibn Muhajriza. Banonte në një kasolle nga kallami, që lëkundej e tëra. Dikush e pyeti përse nuk e rregullon, e ai tha:*

- Sa njerëz deri tash kanë vdekur, e kjo ende qëndron.

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush ndërton më shumë se sa i duhet, i thuhet ‘Merre këtë tepricë në shpinë’.”¹²⁶

Në transmetim tjetër thuhet:

“Për secilin harxhim rob i do të shpërblehet, përpos harxhimit të tij në ujë dhe baltë!”¹²⁷

Në Kuran-i Kerim, Allahu Teala thotë:

“Atë vend të përjetshëm (xhennetin) ua kemi përcaktuar atyre që nuk duan as mendjemadhësi e as ngatërresë në tokë” 28-Kasas: 83

Në ajet *‘fesad’* (ngatërresë) thuhet se janë qeveritarët dhe ndërtimet e larta. Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

¹²⁶ Taberani nga Ibn Mesud.

¹²⁷ Ibn Maxhe nga Habbab ibn Erett, me disa zinxhirë të transmetimit.

“Secila ndërtesë, në Ditën e gjykimit do të jetë vështirësi për pronarin e vet, përpos ndërtesës që mbron nga nxehtësia dhe të ftohtit.”¹²⁸

Një person u ankua se e ka shtëpinë e vogël, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- *Zgjeraja vetes vendin në qiell.* ¹²⁹; pra, në xhennet.

Omeri r.a., pa një ndërtesë të madhe nga qerpiçët dhe gëlqerja, rrugës për në Sham. Bëri tekbir, e pastaj tha: *“Nuk kam menduar se në këtë ummet do të ketë dikush që do të ndërtojë sikur Hamani për Faraonin.”*

Po mendonte në fjalët e faraonit:

“...e ti, o Haman (ministër i Faraonit), m’i pjek qerpiçët dhe ma ndërto godinën e lartë që të ngritem te zoti i Musait..” 28-Kasas: 38, pra e kishte fjalën për qerpiçët.

Thuhet: *“Faraoni është i pari të cilit ju bënë ndërtesat nga gëlqereja e qerpiçët, e i pari që e bëri këtë ishte Hamani. Pastaj u përhap në pushtetarët e tjerë.”*

¹²⁸ Ebu Davud nga Enesi, r.a., me zinxhirë të mirë të transmetuesve (xhejjid).

¹²⁹ Ebu Davud në veprën e tij *el-Merasilu*, nga El-Jese ibnul-Mugira.

Njëri nga selefët, kur e pa një xhami në një qytet, tha:
“Herën e parë kur e kam parë këtë xhami, ka qenë e ndërtuar nga gjethet dhe degët e palmës. Më pas e pashë me mure, që ishin shumë të ulëta. Tash po e shoh të ndërtuar nga qerpiçët. Ata që e ndërtuan nga degët dhe gjethet e palmës janë më të mirë se ata që e ndërtuan me mure të ulëta. E ata janë më të mirë se këta që e ndërtuan nga qerpiçët.”

Nga selefët kishte të atillë që disa herë gjatë jetës së tyre e rrënonin dhe ndërtonin shtëpinë e tyre, sepse i bënë nga materiali shumë i dobët. Bile, mes tyre kishte edhe të atillë që, kur shkonin në haxh ose në luftë, i rrënonin shtëpitë e veta, ose ia falnin dikujt, e kur ktheheshin, ndërtonin kasolle të re. Zakon e kishin që kasollet e veta t’i bëjnë nga barishtet dhe lëkura. Ky ishte zakoni i arabëve, bile ende ka shtëpia të tilla nga ana e Jemenit. Kur qëndron në këmbë, tavanin mund ta prekësh me dorë.

Hasan Basriu ka thënë: *“Kur shkoja ta vizitoja shtëpinë Resulallahur s.a.v.s., dora ime e prekte tavanin.”*

Amr ibn Dinar ka thënë: *“Kur njeriu ndërtonte një shtëpi më të lartë se gjashtë krahë¹³⁰, një melek i thotë:
- Ku po shkon, o më i madhi prej gjynahqarëve?!”*

¹³⁰ Një “krah” është përafërsisht 0.8 metra

Sufjan Sevri e ndaloi të shikohet ndërtesa e suvatuar duke thënë: *“Nëse nuk e shikoni, pronari nuk do ta dekoronte ashtu.”*

Fudajl ibn Ijad ka thënë: *“Nuk habitem pse dikush ndërton, e në fund e braktisë. Habitem që të tjerët e shohin këtë, e nuk marrin mësim.”*

Ibn Mesud ka thënë: *“Do të vijë një fis që do ta ngrisë baltën e do ta ulë fenë, do të hipin në kuaj të huaj, do të bëjnë ndërtesa madhështore, do të falin namaz të kthyer kah kibra, por do të vdesin në një fe tjetër.”*

Gjësendet shtëpiake

E katërta janë sendet shtëpiake. Edhe në këtë çështje zuhdi i ka gradat e veta. Grada më e lartë është si gjendja e Isasë, a.s., Ai nuk posedonte asgjë tjetër përveç një krehër dhe një gotë. Një herë e pa një person se si e krehte mjekrrën me gishta, prandaj edhe Isa, a.s., e hodhi krehërin e vet. Më pas e pa një tjetër si pi ujë të lumit me pëllëmbën e vet, prandaj e hodhi edhe gotën. Asgjë nuk i mbeti. Sendet kërkohen për një qëllim e kur qëllimi të jetë arritur në ndonjë mënyrë tjetër, ato bëhen telash në dynja dhe gjynah në ahiret. Njeriu duhet të jetë i kënaqur me minimumin e asaj që domosdo i duhet. Shembull: njeriu duhet të jetë i kënaqur kur mund të përdorë enë prej balte, bile nuk duhet dhënë rëndësi nëse një pjesë është e thyer, sepse qëllimi arrihet edhe me enë të thyer.

Grada e mesme e zuhdit në lidhje me sendet e nevojshme është që personi të ketë saktë aq sende të nevojshme sa edhe i duhen. Kjo në vetvete është e drejtë, por personi duhet ta përdorë vetëm një send për qëllime të ndryshme. Kjo është si rasti kur personi e ka një çanak nga i cili edhe ha edhe pi, e edhe e ruan ushqimin në të. Selefite pëlqenin të vepronin kështu; ta përdorin një send për disa qëllime.

Grada më e ultë e zuhdit në lidhje me sendet e nevojshme është që njeriu të ketë nga një send për secilën nevojë të domosdoshme, por të jenë sendet më të lira të mundshme. Nëse e shton numrin e sendeve, apo vlerën e tyre, del jashtë kornizave të zuhdit dhe rreshtohet me personat që posedojnë me teprcë. Në këtë çështje, duhet të shikohet jeta e Muhammedit, s.a.v.s., dhe as'habëve të tij. Ajsha, r.anha, ka thënë: *“Dysheku mbi të cilin mbështetej Resulallahu, s.a.v.s., ishte një jastëk i bërë prej lëkure, mbushur me fije palme.”*¹³¹

Transmetohet se Omeri, r.a., hyri te Resulallahu, s.a.v.s., që po flinte mbi hasër, e kur ia pa gjurmët e hasrës në trup, sytë iu mbushën me lot. Resulallahu, s.a.v.s., i tha:

- **O Omer, çfarë të përloti?**; e Omeri, r.a., tha:

- *M'u kujtuan Kisra dhe Kajser, dhe pronat e sulltanati i tyre. Pastaj mendova për ty, e ti je i dashuri i Allahut (habibullah), dhe i dërguari i Tij (resulu), dhe flen mbi këtë hasër. Resulallahu, s.a.v.s., i tha:*

- **O Omer a nuk je i kënaqur (razi) që dynjallëku të jetë për ta e ahireti për ne?**; e Omeri, r.a., u përgjigj:

- *Po, o i Dërguari i Allahut! jam i kënaqur (razi); e Resulallahu, s.a.v.s., tha:*

- **Kjo kështu është.**¹³²

¹³¹ Ebu Davudi, Tirmidhiu, që e vlerëson si hadith me zinxhir të besueshëm, dhe Ibn Maxhe.

¹³² Buhari dhe Muslimi, e tashmë është përmendur.

Një person hyri në shtëpinë e Ebu Dherrit r.a.. Shikoi dhathtas e majtas, por nuk pa asgjë prej sendeve shtëpiake, e tha:

- *O Ebu Dherr, nuk po shoh asgjë në shtëpinë tënde.* Ebu Dherr i tha:

- *Të gjitha i dërgova në shtëpinë tjetër (ahiret).*

- *Duhet të kesh disa sende sa je këtu;* u habit ai personi, e Ebu Dherr i tha:

- *Nuk lejon Pronari i vërtetë i shtëpisë.*

Kur Umejr ibn Seid, guvernator i Humusit erdhi te Omeri, r.a., Omeri r.a., e pyeti:

- *Çfarë ke me vete, prej dynjallëkut??;* e Umejr iu përgjigj:

- *E kam një bostun, në të mbështetem, me të i mbys gjarpërinjtë, nëse i takoj. E kam edhe çantën e shpinës, aty e mbaj ushqimin tim. E kam edhe një enë druri, prej saj ha, e në të edhe e laj kokën e rrobat. E kam edhe një ibrik, me të e barti ujin, për pije e abdes. Më shumë se kaq është e panevojshme.* Omeri, r.a., në këtë i tha:

- *Të vërtetën e ke thënë, Allahu të bekoftë.*

Resulallahu, s.a.v.s., po kthehej nga një udhëtim dhe shkoi te Fatimeja, r.anha, kur pa në derë një perde, e në duart e saj dy hallhalle të argjendit, e u kthye mbrapa. Erdhi Ebu Radi dhe e gjeti Fatimenë, r.anha, duke qarë.

Ajo i tregoi se po qanë për shkak se Resulallahu, s.a.v.s., u kthye dhe nuk hyri. Ebu Rafi e pyeti Resulallahun, s.a.v.s., për arsyen, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- *Arsye ishin perdet dhe dy hallhallet.*

Fatimeja, r.anha, menjëherë ia dërgoi Resulallahut, s.a.v.s., ato përmes Bilallit, e i tha:

- *I japë këto të dyja për sadaka, shpenzoni ku të dëshironi!*; e Resulallahu, s.a.v.s., i tha Bilallit:

- *Shko e shiti këto, e paratë dhuroja as'habi suffive.*

Bilalli i shiti ato për dy dërhëmë e gjysmë, dhe shumë ju dha atyre. Resulallahu, s.a.v.s., shkoi te Fatimeja, r.anha, e i tha:

- *Vajza ime, shumë mirë ke vepruar.*¹³³

Resulallahu, s.a.v.s., pa në dyert e Ajshe, r.anha, perde. I hoqi ato, e tha:

- *Sa herë që i shoh, ma kujtojnë dynjallëkun. Falja filan familjes.*¹³⁴

Një natë, Ajshe r.anha, i shtroi një dyshek të ri Resulallahut s.a.v.s., e Resulallahu, s.a.v.s., ishte mësuar të flejë në stof leshi palosur në dysh.

¹³³ Hadithi nuk është gjetur në version të këtillë. Ebu Davud dhe Ibn Maxhe shënojnë nga Sefine dhe Nesai nga Sevbani, të dy me zinxhir të mirë (xhejjid).

¹³⁴ Tirmidhi, në veprën *el-Kubra*. Nesai e vlerëson si transmetim me zinxhir të mirë të transmetuesve (hasen).

Gjithë natën Resulallahu, s.a.v.s., u rrotullua në shtrojë. Kur u bë mëngjes, tha:

- Ma kthe shtratin tim të vjetër dhe largoje këtë prej meje. Ma prishi gjumin e natës. ¹³⁵

Një natë ia dhuruan Resulallahut, s.a.v.s., pesë ose gjashtë dinarë, e ai, a.s., nuk mundi të flejë deri sa i shpëndau të gjitha. Ajshe, r.anha, më pas ka treguar: *“Pasi i dha ato para, fjeti. Madje e dëgjova duke marrë frymë në gjumë”*; dhe ka shtuar:

- Nuk mund të flinte sepse, nëse vdes e ata dinarë me të, si do ta takonte Rabbin e vet?

Hasan Basriu ka thënë: *“I kam takuar shtatëdhjetë as’habë, e asnjëri nuk kishte diçka më shumë se një palë rroba. Për gjumë shtriheshin në tokë, e mbuloheshin me ato rroba.”*

¹³⁵ Ibn Hibban në veprën *Kitabu ahlak-in-Nebijji*, a.s., nga Ajshe, r.anha.

Martesa

E pesta e rëndësishme është martesë. Disa kanë thënë se martesë, bile edhe me disa gra, nuk ndikon në zuhd. Një prej tyre ishte edhe Sehl ibn Abdullah Tusteri, i cili ka thënë: *“Unë i dua gratë zahide, e si të mos martohem me ato?!”*

Me këtë qëndrim pajtohet edhe Ibn Ujejne, i cili thotë: *“Zahidi më i spikatur në mesin e as’habëve ka qenë Alia, r.a., e ai i ka pasë katër gra e më shumë se dhjetë skllave.”*

Por, më e drejtë është ajo që e thotë Ebu Sulejman Darani, Allahu e mëshiroftë: *“Grua, pronë, fëmijë, çfarëdo qoftë ajo që të largon nga Allahu është fatkeqësi për ju.”*

Gruaja mund ta largojë vëmendjen e njeriut nga Allahu. Beqaria, për disa gjendje është më e mirë, siç kemi folur për këtë në *Librin për rregullat e jetës martesore*. Por, martesë është më e mirë për mbrojtjen nga epshi dhe për këtë bëhet edhe obligim (*vaxhib*), prandaj si mund të jetë zuhd braktisja e saj? Nëse personi nuk i ekspozohet rrezikut as në beqari as me martesë, por megjithatë heq dorë nga martesë si masë mbrojtëse që zemra mos t’i jepet pas grave, pas intimitetit me to, e frikësohet se kjo do ta largonte nga dhikri i Allahut Teala, atëherë braktisja e martesës është për zuhd.

Nëse personi e kupton se gratë nuk do ta largojnë nga dhikri i Allahut Teala, por nuk martohet me qëllim që të privohet nga kënaqësia e marrëdhënies intime, kjo nuk llogaritet për zuhd. Lindja e fëmijës ka për qëllim sigurimin e pasardhësve, e shumësia e pjestarëve të ummetit të Resulallahut, s.a.v.s., është vepër e mirë. Kënaqësia që përjetohet me këtë qëllim nuk e dëmton zuhdin. Sepse qëllimi i tij nuk është vetëm kënaqësia.

Ky është si shembulli i personit i cili braktis ushqimin dhe ujin që të ruhet nga kënaqësia prej tyre. Ky assesi nuk është zuhd, sepse privimi nga buka e uji është shkatërrim i trupit të njeriut. Ashtu edhe beqaria për arsye të ngjashme paraqet ndërprerje të pasardhësve.

Nuk është e lejuar që personi të heq dorë nga martesë vetëm për shkak të kënaqjes në martesë, nëse nuk ka ndonjë frikë tjetër. Nuk ka kurrfarë dyshimi se në këtë ka menduar Sehl et-Tuseri. Prandaj edhe Resulallahu, s.a.v.s., është martuar.

Personi të cilin gruaja nuk e largon nga dhikri, mund të martohet me një ose më shumë. Por kjo gjendje nuk është e mundur të mendohet për askënd tjetër përpos pejgamberëve, a.s., dhe evliave. Shumicën e njerëzve, gratë i preokupojnë. Prandaj, nëse dikë gruaja do ta largojë nga dhikri, ai duhet të heq dorë nga martesë.

E nëse kjo nuk do ta largojë nga dhikri por megjithatë ka frikë se kjo mund të ndodhë nëse martohet me më shumë gra, ose me një grua shumë të bukur, atëherë le të martohet vetëm me një, që nuk është shumë e bukur. Dhe le ta ruajë mirë zemrën në lidhje me këtë.

Ebu Sulejman Darani ka thënë: *“Zuhdi në lidhje me gratë është që personi të zgjedhë një grua pa reputacion ose jetime krahas gruas së bukur e fisnike.”*

Imam Xhunejdi ka thënë: *“Për muridin fillestar më së miri është të mos e preokupojë zemrën me tri gjëra, përndryshe, i ndryshon gjendja; me tregti, me kërkim të haditheve dhe me martesë. Bile, mua as nuk më pëlqen të lexoj e të shkruaj.”*

Kur personit i bëhet e qartë se kënaqësia e martesës është si kënaqësia e ushqimit, se të dyja e pengojnë dhikrin, ai e kupton se kujdesi është i nevojshëm, edhe në martesë edhe në ushqim.

Prona dhe pozita

E gjashta e rëndësishme është mjet me të cilat arrihet në pesë gjërat e mëparshme, e këto janë prona dhe pozita. Pozitë do të thotë dëshira që të të përfitohen zemrat, për të kërkuar ndihmë në punë dhe respek. Kushdo që nuk mund të sigurojë të gjitha nevojat e veta, dëshiron të ketë një vend në zemrën e atyre që do t'i shërbejnë dhe kërkon të respektohet. Sepse nëse ai nuk respektohet, nuk i bëhet shërbimi. Pra, të kesh vlerë në zemrat e të tjerëve është pozitë. Kjo ka një pikë fillestare, por fundi mund ta zvarritë njeriun deri në xhehenem. Kush sillet rreth prushit, lehtë mund të bjerë në prush. Njeriu ka nevojë të zë një vend në zemra ose për të fituar ndonjë dobi, ose për të larguar ndonjë dëm, ose për të shpëtuar nga ndonjë padrejtësi.

Sa i përket dobisë, pasuria i bën njerëzit të jenë të pavarur. Sepse edhe nëse nuk ke ndonjë vlerë në zemrat e të tjerëve, shumica të shërbejnë kur paguhen. Por shërbimet falas kanë nevojë për një pozicion tëndin në zemrat e tyre.

Kur bëhet fjalë për largimin e ndonjë dëmi, njeriut i duhet pozita nëse jeton në qytet ku drejtësia nuk është e plotë, ose nëse jeton mes fqinjëve që i bëjnë keq, e nuk është në gjendje t'i kundërvihet të keqes së tyre në tjetër mënyrë përpos duke i bërë vetes vend në zemrat e tyre ose në zemrën e sundimtarit.

Nuk mund të përcaktohet saktësisht sa duhet të jetë nevoja për këtë, sidomos nëse ndërhyjnë frika dhe mendimet për pasoja të këqija. Për këtë, ata që ndjekin pozitën janë në rrugën e shkatërrimit. E zahidi aspak nuk mundohet të ketë vend në zemrën e tjetrit. Sepse preokupimi i zahidit me fe dhe ibadet edhe nëse është në mesin e pabesimtarëve ndikon në zemrat e tyre në një mënyrë që e mbron veten edhe nga shqetësimet e tyre, e lëre më mes myslimanëve.

Është gënjeshtër dhe mashtrim të mendosh se mund të arrihet pozita pa u lodhë e pa e fituar. Sepse ai që ndjekë pozitën nuk mund shpëtojë nga shqetësimi në atë gjendje. Atëherë, në vend që të durojë vuajtjen me të cilën do të përballlet për përfitimin e ndonjë pozite, më mirë e ka të mos kërkojë pozitë. Prandaj nuk lejohet të kërkohet pozitë në zemrat e të tjerëve. Sepse e pakta tërheqë në teprim. Dëmi i kësaj është më i tmerrshëm se dëmi i alkoolit. Prandaj njeriu duhet të largohet edhe nga e pakta edhe nga teprimi në arritje të pozitës.

Sa i përket pasurisë, ajo është e domosdoshme për jetesë, e këtu sigurisht që mendoj në pasurinë e mjaftueshme.

Personi që punon, duhet të jetë i kënaqur sapo të fitojë për t'i plotësuar nevojat e veta të përditshme.

Disa zahidë, kur i fitonin dy dërhëmë, do të ngritnin shportën e do të largoheshin. Ky është kusht i zuhdit. E nëse fiton më shumë se sa që i duhet për një vit, ai del bile edhe nga grada më e ulët e zuhdit. Por, nëse fiton më shumë se sa që i duhet për një vit për shkak që nuk ka bindje dhe tevekkul të fortë – atëherë merr nga kjo pasuri, me kusht që pjesën e cila i tejkalon nevojat e tij për një vit e ndanë për sadaka – atëherë nuk del prej zuhdit, pos që llogaritet ndër zahidët e dobët. Nëse tevekkuli kushtëzohet në zuhd siç e ka kushtëzuar Uvejs Karani, atëherë ky person nuk llogaritet zahid.

Kur thamë se del prej zuhdit, me këtë menduam që personi i tillë në ahiret nuk do të arrijë gradat e lavdëruara (*mekamat mahmuda*) të premtuara për zahidët. Në këtë, vetmitari e ka situatën më të lehtë se ai që ka familje.

Ebu Sulejman Darani ka thënë: *“Personi nuk duhet ta detyrojë familjen në zuhd, por duhet ta ftojë në zuhd. Nëse ata pranojnë - mirë, në të kundërtën, ata duhet lënë të qetë, e ai vazhdon në zuhd.”*

Kuptimi i kësaj është, detyroje veten në zuhd, jo tjetrin. Zahidi nuk duhet ta detyrojë në këtë të gjithë familjen. Megjithatë, nuk ju përshtatet atyre në çështje që tejkalojnë kufijtë e normales.

Këtë çështje duhet të mësojë nga Pejgamberi, s.a.v.s., sepse Pejgamberi s.a.v.s., kur pa që perdja ishte varur në derën e Fatimes r.anha, dhe në duart e saj pa dy hallhalle të argjendit, u kthye. Për shkak se ato nuk ishin nevoja, ishin zbukurime.

Do të thotë që pasuria dhe pozita që janë nevoja e njeriut, nuk janë pengesë. Por, teprimi përtej asaj që është e nevojshme, ky teprim është një helm vdekjeprurës. E sasia e mjaftueshme është një ilaç i dobishëm. Mes tyre ka shkallë të dyshimta. Gjithçka që është mbi dhe afër sasisë së domosdoshmërisë, edhe pse nuk është ilaç, dëmi i kësaj është i vogël. Gjithçka që është më shumë se e domosdoshme, edhe pse nuk është helm vdekjeprurës, është i dëmshëm, Është e ndaluar të pihet helm, e ilaçi të pihet është farz. Gjithçka mes tyre është e dyshimtë.

Kush ruhet, ruhet për vete, e kush gabon, gabon për vete. Kush ia do të mirën fesë së vet, e kështu braktisë atë që i është e dyshimtë dhe pranon atë që nuk e ka të dyshimtë, është kthyer kah nevoja e tij më e domosdoshme. Padyshim, ai është në grupin e atyre që janë shpëtuar. Kush kufizohet vetëm në të domosdoshmen dhe të rëndësishmen, nuk mund të konsiderohet që është i lidhur për këtë dynja, sepse kaq dynjallëk është kusht për fetë.

Këtë e tregon ngjarja që transmetohet për Ibrahimin a.s., kur i duhej diçka e shkoi te një mik i tij t'i kërkojë, e ky nuk i ndihmoi. Ibrahim i a.s., u kthye i mërzitur, e Allahu Teala i shpalli:

- Po të kërkoje nga Ai që është vërtetë Miku yt i Singertë, Ai do të kishte dhënë!; e Ibrahim i a.s., tha:

- Rabbi im, ishte dynjallëk që kërkoja. Unë e njoha përbuzjen Tënde ndaj dynjasë, e u frikësova që prej Teje të kërkoj diçka të kësaj bote; e Allahu Teala i shpalli:

- Nevoja nuk është dynjallëk.

Pra, sasia e nevojshme e dynjallëkut është pjesë e fesë. Gjithçka përtej kësaj është shkatërrim në ahiret. Bile edhe në dynja është kështu.

Ai që e njeh gjendjen e të pasurve i di vështirësitë dhe telashet me të cilat ata përballen në fitimin e pasurisë dhe mbajtjen e saj. Kulmi i lumturisë së tyre është që atë pasuri t'ua dorëzojnë trashëgimtarëve, të cilët të shumtën e rasteve bëhen armiq të tij, e harxhojnë këtë pasuri në kryengritje e ai bëhet ndihmësi i atyre. Për këtë arsye ata që mblodhën dynjallëkun u krahasuan me krimbin e mëndafshit.

Krimbi i mëndafshit vazhdimisht përgatit mëndafsh për vete, e pastaj dëshiron të dalë nga aty, por nuk mund të dalë pa u mbytur.

Ai vdes në mëndafshin që vet e thur, ndërsa përfiton dikush tjetër. Njëjtë është me atë që ndjek epshet e dynjasë. Zemra e tij lidhet me zinxhirë dëshirash, lidhet nga pasuria, pozita, familja, fëmijët, armiqësia e armiqve, gënjeshttrat e miqve dhe kënaqësitë e dynjasë.

Në atë situatë, edhe nëse e kupton se është në gabim, ai nuk mund të ndahet nga ky dynjallëk. Ai e sheh se zemra e tij është e lidhur fort me të dhe se nuk është në gjendje t'i shkëpus ato lidhje. Por kur vjen meleku i vdekjes, ai e shëkput nga të gjitha. Do të mbesin zinxhirët në zemër të lidhur për dynjanë, e dynjaja tashmë e ka braktisë e ka mbetë mbrapa tij, mirëpo edhe e tërheqë kah vetja. E kthetrat e vdekjes e tërheqin në ahiret. Gjendja më e vështirë në kohën e vdekjes është ndarja në dysh, sikur me sharrë. Njëra anë e tij e tërheq në botë, ana tjetër e tërheq në ahiret. Dhimbja e kësaj përhapet gradualisht nëpër gjithë trupin, e nga trupi mbërrinë në zemër. E ti mendo për dhimbjen që nis në zemër.

Kjo është vuajtja e parë me të cilën do të përballët ia që nuk mund ta arrijë A'la-i illijjin. Tash paramendo dhimbjen e vuajtes që nuk do ta arrijë lartësinë më të lartë, që do të ketë perde mes tij dhe Allahut dhe kur zjarri i xhehenimit ta kaplojë. Sepse zjarri i xhehenimit i kaplon vetëm ata që janë të privuar nga shikimi në bukurinë e Allahut Teala:

“Jo, jo, atë ditë, me të vërtetë, ata do të jenë të penguar që ta shohin Rabbin e tyre, pastaj, me siguri, do të hyjnë në Zjarrin e Xhehenemit.” 83- Mutaaffifun: 15, 16

Zjarrin e xhehenemit e la pas dhimbjes. Edhe po të mos kishte zjarr të xhehenemit, dhimbja do t'i mjaftonte. E kur kësaj i shtohet edhe zjarri, mjerë ai për vete.

E lusim Allahun Teala që ta kuptojmë mirë atë që i është frymëzuar në zemër Resulallahut, s.a.v.s., kur i është thënë:

“Këdo që ta duash, sigurisht do të ndahesh nga ai.”¹³⁶

Për ngjashmërinë me krimbin e mëndafshit, poeti tha:
*Si krimbi i mëndafshit vazhdimisht punon
dhe në brenga mes thurjeve, jetën e harxhon.*

Kur evliave (miqve të Allahut) ju zbulua se rob i shkatërrohet nga puna e vet dhe nga ndjekja e kërkesave të nefsit njëjtë si krimbi i mëndafshit që e shkatëron veten, ata e refuzuan dynjallëkun në atë masë sa Hasan Basriu tha: *“Unë kam parë shtatëdhjetë njerëz që morën pjesë në betejën e Bedrit. Iknin nga hallalli ashtu si ju ikni nga harami;*

e në version tjetër thuhet:

¹³⁶ Hadithi tashmë është përmendur

“...ata në telashe ishin më të lumtur se ju sot në rehati dhe bollëk. Po t’i shihnit ata, do të thonit se ata janë të çmendur, e po t’i shihnin ata më të mirët ndër ju, do të thonin që këta nuk kanë kurrfarë shpërblimi në ahiret, e sikur të shihnin më të këqijtë ndër ju do të thonin se këta as nuk besojnë në Ditën e llogarisë.”

Njërit prej tyre iu ofrua pasuri hallall, e ai nuk e pranoi, por tha: *Frikësohem të mos e prishi zemrën!*

Një person me zemër natyrisht që duhet të ketë frikë nga prishja e saj. E për gjendjen e atyre që zemrat ua ka mbytur dashuria e dynjasë, Allahu Teala thotë:

“Ata që nuk presin takimin me Ne, që janë të kënaqur me jetën e dynjasë dhe kanë gjetur prehje në të dhe që janë të pakujdesshëm ndaj argumenteve Tona.”

10-Junus: 7.

Allahu Teala gjithashtu thotë:

“Dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, se puna e tij ka mbaruar.” 18-Kehf: 28,

dhe me një ajet tjetër:

Largohu prej atij që ia ka kthyer shpinën Kur'anit dhe që dëshiron vetëm jetën e dynjasë!

Ajo është e tërë dituria që kanë arritur...”

53-Nexhm: 29, 30

Krejt kjo buron nga pakujdesia dhe injoranca. Prandaj, kur një person i tha Isasë, a.s.:

- *Më merr me vete në udhëtimin tënd.* Isa, a.s., i tha:
- *Braktise pasurinë tënde, unë të marr me vete.* Ky tha:
- *Unë nuk mund ta bëj këtë;* e Isa, a.s., i tha:
- *Të pasurit hyjnë në xhenet me vështirësi;*

Disa kanë thënë se nuk ka një ditë që lind Dielli, e katër melekë të mos thërrasin në qiell me katër zëra, dy në lindje, e dy në perëndim. Njëri melek në lindje thotë:

- *O ti që kërkon të mirën, eja në mirësi, dhe o ti që kërkon të keqen, ndalu;* e tjetri melek në lindje thotë:

- *O Allah, shtoja pasurinë atij që jep, dhe shkatërroja pasurinë atij që nuk jep.* Në perëndim, njëri melek thotë:

- *Përgadituni për vdekjen e ndërtoni për t'i rrënuar!;*
e tjetri melek thotë:

- *Hani e kënaquni, do të keni llogaridhënie të gjatë!*

SHENJAT E ZUHDIT

Dije, zakonisht mendohet që zahidë janë ata që braktisën dynjallëkun, por jo. Për ata që duan të lavdërohen me zuhd është e lehtë ta braktisin pasurinë dhe të preferojnë jetën e vështirë. Sa ka murgjë të cilët pak ushqehen, qëndrojnë në qeli pa dritare dhe dyer. Ajo që i bën ata të lumtur është që njerëzit e njohin gjendjen e tyre dhe i lavdërojnë. Kjo nuk tregon domosdo për zuhdin e tyre. Zuhdi duhet të bashkojë braktisjen e pasurisë dhe braktisjen e reputacionit. Aq më shumë, disa e quajtnë veten zahidë, e bartnin mantelë leshi, por të kualitetit më të lartë, dhe rroba të buta përfundi. Ibrahim Havvas për këta njerëz ka thënë: *“Ka disa njerëz të cilët prezantohen si zahidë. Veshin rroba të kualitetit të lartë, dhe me to dalin para njerëzve, që ata t’ju japin më shumë rroba të tilla. Ata nuk janë të kënaqur që njerëzit t’i shohin si e shohin fukaranë e të jenë të përbuzur dhe t’ju jepet ajo që i jepet fukarasë. Ata thonë që i nënshtrohen diturisë dhe që janë në rrugën e sunnetit dhe thonë si shumë gjëra ju arrijnë por këta nuk interesohen, e i marrin për të tjerët. Ata i thonë këto fjalë kur ju kërkohet e vërteta. Këta janë që me fe, e ‘hanë’ dynjanë. Ata kurrë nuk i kushtuan vëmendje pastrimit të zemrave të tyre, e as përmirësimit të ahlakut të tyre. Cilësitë e tyre të vërteta lexohen te ata, dhe plotësisht i mbizotërojnë, e ata këtë e quajnë “gjendje të veçantë”. Ata anojnë kah dynjallëku e i ndjekin epshet e veta.”*

Prandaj njohja e zuhdit është e vështirë. Bile, gjendja e zuhdit është e vështirë edhe për vet zahidin. Zahidit nuk i mbetet tjetër, pos që mirë të ketë kujdes për tri shenja:

Shenja e parë është të mos gëzohet për atë që e posedon, e as të mos mërzitet për atë që e humbë, siç thotë Allahu Teala:

“Të mos dëshpëroheni tepër për atë që ju ka kaluar, e as të mos gëzoheni tepër me atë që Ai ju ka dhënë; Allahu nuk e do arrogantin dhe atë që lavdërohet” 57-Hadid: 23

Shenja e dytë është kur e ka krejt të njëjtë a e qorton ose lavdëron. E para, qortimi, është shenjë e zuhdit në lidhje me pasurinë, ndërsa e dyta, lavdërimi, është shenjë e zuhdit në lidhje me reputacionin.

Shenja e tretë është kur personi është i afërt me Allahun Teala, dhe që plotësisht e ka mbizotëruar kënaqësia e zbatimit të urdhrave të Allahut Teala (*taat*). Zemra kurrë nuk është pa kënaqësinë e dashurisë; ose dashuri ndaj dynjasë, ose dashuri ndaj Allahut Teala. Këto dyja në zemër janë si uji e ajri në gotë; nëse ka ujë, nuk ka ajër, e nëse nuk ka ujë, ka ajër, por të dyja bashkë nuk mund të jenë. Ai që është i afërt me Allahun Teala, atij nuk i intereson asgjë tjetër. E pyetën dikë:

- *Ku, sipas teje, shpien zuhdi?*; në çka ai tha:

- *Te afërsia me Allahun Teala.*

Afërsia me dynjallëkun dhe afërsia me Allahun Teala nuk munden bashkë. Dikush nga arifët ka thënë: *“Kur imani ngjitet për të jashtmen e zemrës, njeriu e do edhe dynjallëkun edhe ahiretin bashkë, dhe vepron sipas të dyjave. E kur imani depërton në thellësinë e zemrës dhe ngjitet për të, atëherë njeriu e urren dynjallëkun dhe më as nuk e shikon, e as nuk vepron për të.”*

Prandaj Ademi a.s., në dua ka thënë: *“O Allah, të lus për iman që ngjitet për zemrën time.”*

Ebu Sulejman Darani ka thënë: *“Kush merret me veten (nefs), nuk merret me njerëzit. Kjo është grada e besimtarëve të cilët veprojnë (amel) – i zbatojnë urdhrat e fesë (mekamul-amilin). E kush merret me Rabbin e vet, nuk do të merret me nefsin e vet. Kjo është grada e arifëve (mekamul-arifin)”.*

Zahidi duhet të jetë në një nga këto dy grada. Grada e parë i është të merret me veten, e atëherë do t'i jetë i njëjtë lavdërimi me qortimin, pasuria apo varfëria. Nëse mbanë pjesë më të vogël të pasurisë, kjo nuk do të thotë gjithsesi që e ka humbur plotësisht zuhdin e tij.

Ibn Ebu Havari ka thënë:

“E pyeta shejh Ebu Sulejman Daranin:

- A ka qenë zahid Davud Tai?, e ai m'u përgjigj:

- Po, ka qenë. Atëherë i thashë:

- Kam dëgjuar se Davud Tai i ka trashëguar njëzet dinarë nga i ati, e i ka harxhuar për njëzet vite. E si pra ka qenë zahid kur i ka mbajtur ata dinarë?

Ebu Sulejmani më tha:

- Qëllimi im ishte se ai e ka kuptuar hakikatin e zuhdit. E zuhdi nuk ka fund sepse cilësitë e nefsit janë të shumta, ndërsa zuhdi është i plotë vetëm nëse njeriu heq dorë nga të gjitha ato cilësi.”

Kështu, secili që heq dorë nga dynjallëku, edhe pse ka mundësi ta përfitojë, hyn në kategori të zuhdit, përshtatshëm vlerës së asaj prej të cilës heq dorë. Kulmi është kur braktis gjithçka përpos Allahut Teala, bile edhe gurin që i shërben si jastëk, siç ka vepruar hazreti Isa, a.s.. Dëshira jonë nga Allahu Teala është që të na shpërblejë me zuhd, edhe nëse është pak. Sepse njerëzit sikur ne nuk është e mundur të arrijnë në pikën përfundimtare të zuhdit. Megjithëkëtë, për as një moment nuk humbet shpresa nga mirësitë e Allahut.

Derisa i vështrojmë mirësitë e mrekullueshme të Allahut Teala, e kuptojmë që askush nuk arrin ta lavdërojë ashtu siç meriton Ai.

Prandaj, na duhet që secilën dua ta kuptojmë me respekt të plotë, gjithmonë duke kujtuar mirësinë e Allahut, e cila tejkalon secilën ide tonën për përsosuri.

Për shkak që zahidi është afër me Allahun, për të janë të njëjta varfëria dhe pasuria, fama dhe përlujta, lavdërimi dhe qortimi.

Nga këto tri shenja të zuhdit degëzohen shenja tjera të panumërta, për shembull që personi të heq dorë nga dynjallëku dhe që dynjallëku aspak të mos e interesojë. Kishte edhe njerëz që e shpjegonin zuhdin në një mënyrë tjetër. Për shembull:

Jahja b. Muadh ka thënë: *“Zuhd është të japësh atë që e posedon.”*

Ibn Hafif Shirazi ka thënë: *“Zuhd është rehatia pas dhënijes së diçkaje që e posedon;*
dhe ka thënë: *“Zuhd është largimi i plotë i nefsit tënd nga dynjallëku.”*

Ebu Sulejman Darani ka thënë: *“Leshi (suf) është një nga shenjat e zuhdit, por njeriu nuk duhet të veshë rroba leshi me vlerë tri dërhëmë e në zemër t’i dëshirojë ato për pesë dërhëmë.”*

Ahmed Hanbeli dhe Sufjan Sevri, kanë thënë: *“Shenjë e zuhdit është të shkurtosh ambicien.”*

Serijj Sekati ka thënë: *“Jeta e zahidit nuk do të jetë e mirë nëse nuk merret me veten (nefs), e jeta e arifit nuk do të jetë e mirë nëse merret me veten.”*

Nasr Abazi thotë: *“Zahidi është i çuditshëm në dynjallëk, e arifi është i çuditshëm në ahiret.”*

Jahja b. Muadh ka thënë: *“Janë tri shenja të zuhdit: veprimi pa prituri ndonjë shpërblim, fjala pa përgjigje dhe madhështia, pa qenë kryesori”;*

e gjithashtu ka thënë: *“Personi që është zahid për Allahun ka erë të uthullës dhe hardallit, sepse e përçmon dynjanë. Arifi, aromë miski dhe anberi. Sepse zemra e tij është e mbushur me merifetullah.*

Një person e pyeti Jahja b. Muadhin:

- *Kur do të hyj unë në odat e tevekkulit, ta veshë hërkën e zuhdit e të ulem me zahidët?;* e Jahja iu përgjigj:

- *Kur të qëndrosh i uritur për tri ditë duke kundërshtuar dëshirat e nefsit dhe nuk shqetësohesh, atëherë mund të ulesh me ta. Deri sa nuk e mbërrinë këtë gradë, ulja bashkë me zahidët është vetëm padituri, sepse nuk jam i sigurt se edhe më tutje do ta ruash atë gjendje.*

Ibn Muadh gjithashtu ka thënë: *“Dynjallëku është si nuse. Ai që e kërkon, edhe e zbukuron. Por zahidi që e largon fytyrën nga dynjaja, ia nxinë asaj ytyrën, ia shkulë flokët dhe ia grisë rrobat. E arifi angazhohet me Allahun Teala, as që kthehet kah dynjaja.”*

Sejri Sekati ka thënë: *“Unë i bëra të gjitha kërkesat e zuhdit dhe arrita atë që doja. Por zuhdin ndaj njerëzve nuk e arrita.”*

Fudajl ibn Ijad ka thënë: *“Allahu Teala i ka dhënë të gjitha të këqijat në formën e një shtëpie, e çelësi i saj është dashuria për dynjallëkun. Allahu Teala i ka dhënë edhe të gjitha të mirat në formën e një shtëpie, e çelësi i kësaj shtëpie është zuhdi ndaj dynjallëkut.”*

Ja, këtë deshëm ta themi për realitetin e zuhdit dhe rregullat që ndërlidhen me të. Zuhdi plotësohet vetëm me *tevekkul*, prandaj ne tani, me lejen e Allahut, do të shpjegojmë tevekkulin.

PËRMBAJTJA

PËR VARFËRINË	6
HAKIKATI I VARFËRISË DHE GJENDJET E TË VARFËRIT	6
FAZILETI I VARFËRISË	19
VLERA E LARTË (FAZILET) E FUKARASË	38
PËRPARËSIA E FUKARASË NDAJ TË PASURIT	44
EDEBI I FUKARASË NË VARFËRI	63
DETYRA E FUKARASË KUR I DHUROHET DIÇKA, E NUK KA KËRKUAR ...	68
NDALIMI I LYPJES PA NEVOJË TË DOMOSDOSHME DHE SJELLJET E FUKARASË KUR ËSHTË I OBLIGUAR NË KËTË	81
PASURIA QË E BËN LYPJEN HARAM	97
GJENDJA E LYPËSIT	102
PËR ZUHDIN	107
HAKIKATI I ZUHDIT	107
FAZILETI I ZUHDIT	120
GRADAT E ZUHDIT	141
SHPJEGIM I DETAJUAR I ZUHDIT TE NEVOJAT E JETESËS	159
Ushqimi	160
Veshja	165
Banimi	178
Gjësendet shtëpiake	185
Martesa	190
Prona dhe pozita	193
SHENJAT E ZUHDIT	202

